



STRUKTURA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

RAPORTI
VJETOR
2023

PROKURORIA E
POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR



TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	Hyrje.....	2
	Problematikat të cilat duhen adresuar.....	7
	Zbatimi i Rekomandimeve të Bashkimit Europian.....	9
	Zbatimi i Rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë.....	9
	Zbatimi i rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër korrupsionit dhe kriminalitetit:.....	17
SITUATA E KRIMINALITETIT	Situata e kriminalitetit.....	23
	Krimi i organizuar dhe terrorizmi.....	23
	Harta e tregjeve kriminale.....	25
	Aktivitetet kryesore kriminale.....	26
	Tregjet kriminale ndërkombëtare.....	30
	Terrorizmi.....	33
	Korrupsioni.....	33
ANALIZA KRAHASIMORE E EFEKTIVITETIT	Masat e sigurimit për personat e regjistruar.....	37
	Efektivitetit në hetim.....	38
	Efektiviteti në gjykim.....	39
	Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të veprave penale.....	43
	Qasja proaktive.....	47
ANALIZA E VOLUMIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË POSAÇME PËR VITIN 2023	Volumi i punës në hetim.....	49
	Ekzekutimi i vendimeve penale.....	55
	Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta.....	56
	Bërthama Komanduese.....	65
	Sektori i Ekspertizës.....	67
	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit.....	67
	Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës.....	73
	Koordinatori për mediat dhe e drejta e informimit.....	74
	Dokumentacioni i klasifikuar dhe i paklasifikuar.....	75
	Drejtoria e Burimeve Njerëzore.....	77
	Byroja Kombëtare e Hetimit.....	81
	Treguesit e buxhetit për vitin 2023 dhe plani i shpenzimeve për vitin e ardhshëm drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar.....	83

TABELA E AKRONIMEVE

SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
Prokuroria e Posaçme	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
GJKKO	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GJAKKO	Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
OPGJ	Oficer i Policisë Gjyqësore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
OFL	Operacioni Forca e Ligjit
DTI	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
PSHSH	Policia e Shtetit Shqiptar
SPH	Skadrat e Përbashkëta Hetimore
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit
AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
AKSIK	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
BE	Bashkimi Europian
FATF	Financial Action Task Force
MONEYVAL	Committee of Experts on the Evaluation of Anti-Money Laundering Measures and the Financing of Terrorism
ICRG	International Country Risk Guide
PP/FT	Pastrimi i parave/ Financim i terrorizmit
KBLKPP	Komiteti i Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave
EU4FOCAL	Fighting organised crime in Albania
EU4LEA	European Union for Law Enforcement in Albania
EU4FAST	EU Support to Strengthen the Fight against Migrant Smuggling and Trafficking in Human Beings in the Western Balkans
Eurojust	European Union Agency for Criminal Justice Cooperation
Interpol	The International Criminal Police Organization
Europol	European Serious and Organised Crime Centre
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program
OPDAT	Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training
FBI	Federal Bureau of Investigation
DIA (EUROPOL)	Defense Intelligence Agency
ILEA – Budapest	International Law Enforcement Academy in Budapest
CEPOL	ILEA - Budapest
CISA	Cybersecurity and Infrastructure Security Agency
IPA 2019	Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor 2019
JIT	Joint Investigation Teams
WBCJ	Western Balkan Criminal Justice
MATRA	European Cooperation Embassy Program
OJF	Organizatë jofitimprurëse

HYRJE

Mbështetur në nenin 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Prokuroria e Posaçme është organ kushtetues i pavarur i cili ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë për veprat penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Prokuroria e Posaçme së bashku me Njësinë e Posaçme Hetimore të saj (Byroja Kombëtare e Hetimit) formojnë Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të titulluar (“SPAK”).

Bazuar në përcaktimet e nenit 15/2, shkronja "d", të ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të ndryshuar dhe neneve 103, 104 dhe 105 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Prokuroria e Posaçme ka përgatitur “Raportin mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme gjatë vitit 2023”.

Për vitin 2023, veprimtaria e SPAK ka njohur një rritje cilësore, e cila është mirëpritur nga shoqëria shqiptare dhe komuniteti ndërkombëtar. Në konkluzionet e **Këshillit Evropian** për Zgjerimin, të miratuara në 12 dhjetor 2023, cilësohet se, “**Këshilli vlerëson pozitivisht rezultatet konkrete të arritura nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe ka një bashkëpunim të mirë e të vazhdueshëm me agjencitë ligjzbatuese të BE-së dhe të shteteve anëtare**”. Progres Raporti i publikuar në 8 nëntor 2023 nënvizon gjithashtu se, “**Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) ka arritur rezultate të mëtjshme dhe ka kryer hetime për disa çështje të nivelit të lartë.**” Në lidhje me luftën kundër krimin të organizuar cilëson se “**Shqipëria vazhdon të ketë një nivel të mirë bashkëpunimi me shtetet anëtare të BE-së, Europolin dhe Eurojust-in dhe ka marrë pjesë në një sërë operacionesh ndërkombëtare të zbatimit të ligjit. Është bërë njëfarë progresi në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të lidhura me krimin e organizuar, i cili duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen**”.

Për shkak të arritjeve të SPAK, **Transparency International e ka klasifikuar Shqipërinë në Indeksin Global të Korrupsionit për vitin 2023 më pozitivisht krahasuar me vlerësimin e kryer në të njëjtin Indeks të vitit paraardhës.** Sipas një sërë sondazhesh profesionale të shoqërisë civile të kryera në vitin 2023, **rreth 69% e shqiptarëve besojnë se, SPAK është një institucion i pavarur, misioni i të cilit është lufta kundër korrupsionit, funksion të cilin e kryen jashtë ndikimeve politike.**

SPAK ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm për nxjerrjen e Shqipërisë nga lista “gri” e FATF në tetor të vitit 2023, ku një nga arsyet e këtij vendimi shumë pozitiv ka të bëjë me punën e SPAK në “.. rritjen e numrit dhe përmirësimin të sofistikimit të hetimeve dhe konfiskimeve të pastrimit të parave..”.


SPAK ka arritur që tashmë të krijojë një besueshmëri me institucionet partnere në nivel rajonal dhe më gjerë. Ndër të tjera, gjatë këtij viti për tu shënuar është edhe **nënshkrimi i Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet SPAK dhe Prokurorit Publik Evropian më datë 29.06.2023.** Prokuroria e Posaçme, gjithashtu **ka vendosur kontakte të drejtpërdrejta edhe me shtete të Amerikës Latine** të cilat do të rrisin ndjeshëm forcimin e bashkëpunimit në hetimin e veprave penale në kuadër të krimin të organizuar.

Brenda një kohe mjaft të shkurtër (korrik-dhjetor 2023) Prokuroria e Posaçme ka adresuar Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimet e Këshillit të Ministrave. Janë marrë masa në lidhje me forcimin e etikës në punë duke miratuar akte nënligjore konkrete. Për plotësimin e kornizës strategjike institucionale, janë ndërmarrë veprime dhe miratuar akte nënligjore dhe një sërë dokumentesh strategjike, si dhe është në proces puna për përfundimin e disa akteve të tjera, brenda një afati kohor sa më të shpejtë. Gjithashtu, është duke u përgatitur vlerësimi i riskut të brendshëm, lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në lidhje me sfidat institucionale është hartuar dhe është në fazën e konsultimit me ekspertë ndërkombëtar edhe Plani Strategjik Institucional.

Është vijuar me fuqizimin e Sektorit të Ekspertizës sidomos në ekspertimin e provave digjitale në pajisjen dhe përditësimin e laboratorit ekzistues me programet e fjalës së fundit. Është forcuar Sektori i Hetuesve Financiarë nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve njerëzore kryesisht në hetimet financiare dhe pasurore me veprime komplekse brenda dhe jashtë vendit ku përfshihen edhe veprimet me kriptovaluta. Po punohet gjithashtu edhe për nxjerrjen e një udhëzimi të përgjithshëm specifik për hetimin financiar i cili po asistohet nga ekspertë ndërkombëtarë.

Prokuroria e Posaçme i ka dhënë një rëndësi të veçantë luftës kundër pastrimit të produkteve të veprave penale duke ndjekur qasjen e shoqërimit të hetimeve penale edhe me hetimet pasurore. **Strategjia e ndjekur për masat e përdorura kundër produkteve të veprave penale është shtrirë në tre dimensione: 1) konfiskimi i produkteve të veprës penale; 2) konfiskimi i vlerës ekuivalente; dhe 3) masat e sekuestrimit dhe konfiskimit me anë të ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, (ligji anti-mafia).**


Kjo qasje ka dhënë rezultate mjaft pozitive në të cilat, vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara së bashku, nga vlerësimi i kryer për vitin 2023 përlllogarit në vlerën prej 41 milion Euro, nga të cilat, 54% e zënë pasuritë e konfiskuara në vlerën 22.5 milion Euro (440 milionë lekë + 18 milionë Euro) dhe 46% e zënë pasuritë e sekuestruara në vlerën 1.9 miliard lekë (19 milion euro).



Përgjatë periudhës kohore 2021-2023, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar një numër relativisht të lartë të procedimeve penale të reja me një tendencë në ngritje. **Nga viti 2023 dallohet një rritje në masën 16% në krahasim me vitin paraardhës.** Duhet cilësuar se, kategoria e çështjeve të

hetuara nga SPAK konsiderohet shumë komplekse të cilat kërkojnë një numër të lartë veprimesh hetimore, ku përmbajta e dosjes hetimore së disa prej tyre **mund të arrijë mesatarisht në 100 fashikuj hetimor për çështje.**

Nga ana tjetër, ka një përmirësim të dukshëm edhe në qasjen proaktive të hetimeve të ndërmarra nga Prokuroria e Posaçme në të cilën janë përdorur të gjitha teknikat e posaçme të hetimit. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar hetimeve të nisura kryesisht, interceptimit të pajisjeve fundore, kërkesave për ndihmë juridike të dërguara agjensive ligjzbatuese jashtë vendit dhe ngritja e skuadrave të përbashkëta hetimore. **Krahasimisht me vitin 2022, ka një rritje të konsiderueshme të hetimeve të nisura kryesisht me 139%, ndërkohë që ka një rritje prej 91% të interceptimit të pajisjeve fundore dhe një rritje me 95% të kërkesave për ndihmë juridike nga jashtë vendit. Vetëm gjatë vitit 2023 janë ngritur 10 skuadra të reja të përbashkëta hetimore, ndërkohë që hetimet vijojnë ende me 25 skuadra të përbashkëta hetimore të ngritura në periudhën paraardhëse.**




Nga ana tjetër qasje proaktive ka dhënë rezultate pozitive edhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. **Kështu për çështjet e regjistruara për veprat penale në kuadër të krimit të organizuar, evidentohet një rritje në masën 8% dhe një rritje në masën 10% për çështjet e dërguara në gjykatë me kërkesë për gjykim krahasuar me vitin 2022. Ka gjithashtu një rritje prej 20% për çështjet e regjistruara për veprat penale në kuadër të korrupsionit dhe veprat e tjera penale krahasuar me vitin paraardhës.**

Duhet nënvizuar se, bashkëpunimi i institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është shqetësues. Nisur nga numri i referimeve të veprave penale nga institucionet publike, duke përjashtuar policinë e shtetit, ky numër është mjaft i ulët për vitin 2023 me vetëm 12 raste të referuara. **Referimet nga këto institucione kanë një tendencë të fortë rënie, e cila shkon deri në 40% krahasuar me vitin 2022.**

Në lidhje me politikën penale të ndjekur me llojin e kërkesave të masave të sigurimit rezulton se Prokuroria e Posaçme ka mbajtur të njëjtën qasje përgjatë tre viteve të fundit. Për sa i përket masës “arrest me burg”, vihet re një tendencë në rënie me 3% krahasuar me vitin

2022. Kjo masë sigurimi zë rreth 49% të totalit të masave të sigurimit të kërkuara për vitin 2023.

Në lidhje me efektivitetin në gjykim, duhet cilësuar se, Prokuroria e Posaçme ka pasur një raport të lartë në marrjen e vendimeve të fajësisë në të tre shkallët e gjyqësorit. Kështu **vendimet e fajësisë në shkallën e parë të Gjykatës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) kanë pësuar një rritje prej 53% krahasuar me vitin 2022** dhe një tendencë e njëjtë rritje është vënë re në Gjykatën e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJAKKO), si dhe në Gjykatën e Lartë.



Nga pikëpamja e analizave të brendshme, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka thirrur rregullisht 17 mbledhje të prokurorëve me një rend të përcaktuar dite. Ndërkohë është ndërmarrë një proces analize i punës së çdo prokurori dhe hetuesi, me qëllim evidentimin e ngarkesës si dhe të çështjeve prioritare, për të cilat janë dhënë dhe rekomandimet përkatëse për çdo prokuror. Për këtë qëllim gjatë vitit 2023 **janë organizuar analiza me secilin prokuror dhe grupin e hetuesve përkatës.** Janë organizuar gjithashtu analiza të përgjithshme dhe tematike me Sektorin e Ekspertizës dhe Sektorin e Hetimit Financiar. Janë mbajtur analiza për çështje specifike të karakterit organizativ.

Prokuroria e Posaçme ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me BKH-në, duke shkëmbyer ndër të tjera, mendime në formë të shkruar dhe takime të përbashkëta pune. Gjatë vitit 2023, është dhënë kontribut mbi hartimin e “Projekt-rregulloren për përcaktimin e procedurave të rekrutimit të oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore”; “Projekt-rregulloren e brendshme të BKH-së”; “Projekt-rregulloren e sistemit të vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore”; “Mbi marrëveshjen me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për aksesin e hetuesve të BKH-së në sistemet e DPD” dhe “Projekt-rregulloren e përdorimit të postës dhe komunikimit elektronik”.

Aktualisht është në proces finalizimi “Rregullorja për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të Hetimit”, gjithashtu është në proces diskutimi me ekspertët ndërkombëtar “Procesi i rekrutimit të shërbimeve të policisë gjyqësore” pranë BKH-së, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Vendimit nr. 438 datë 19.07.2023 “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kritereve për trajtimin e punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Po vijohet me rritjen e kapaciteteve njerëzore të hetuesve të BKH-së, me fokus në përdorimin e mjeteve dhe teknikave speciale të hetimit, provave digjitale etj. Në buxhetin e këtij viti është parashikuar një fond i posaçëm për blerjen e mjeteve teknike të cilët do të përdoren gjatë hetimeve.

Në kuadrin e rritjes së efektivitetit nga pikëpamja procedurale dhe administrative, **Drejtuuesi i Prokurorisë së Posaçme ka nxjerrë 528 Urdhra, ndër të cilat: 4 Urdhra të Përbashkëta me Drejtorinë e BKH-së; 2 Udhëzime të Përgjithshme; 2 Udhëzime jo detyruese për çështje**

konkrete; 2 Rregullore të miratuara; dhe 3 Marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara me institucionet publike dhe private në vend.

Në vijim të volumit të punës nga pikëpamja administrative, Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme, i cili merret me verifikimin e plotë të Pasurisë dhe Pastërtisë së kandidatëve për gjyqtar dhe nëpunës civil gjyqësor në gjykatat e posaçme dhe për prokuror dhe personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme **ka përfunduar raportet për 60 (gjashtëdhjetë) kandidatë për personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme dhe gjykatat e posaçme.**

Gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka qenë mjaft bashkëpunuese në marrëdhënie me kërkesat e bëra nga institucionet shtetërore. Nga këto të fundit janë paraqitur gjithsej 1050 kërkesa, për të cilat janë kthyer 856 përgjigje, 5 janë arkivuar dhe 74 të tjera janë dërguar me postë elektronike tek personat e interesuar për të marrë dijeni. Këtu përfshihen mendime dhe përcjellje të dhënash për projekt-akte ligjore dhe nënligjore si dhe për strategji ndërsektoriale në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave etj.

Një vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe forcimit të komunikimit me publikun. Për këtë qëllim po punohet ngushtësisht me ekspertë ndërkombëtarë për përgatitjen e një strategjie komunikimi me publikun duke ndjekur eksperiencat më të mira ndërkombëtare të aplikuara nga agjencitë ligjzbatuese të ngjashme me SPAK. Ky është një ndër dokumentet kryesore strategjik që është planifikuar të mbyllet brenda vitit 2024. **Numri i kërkesave për informacion vijon të jetë i lartë ku për vitin 2023 ka pasur 128 (njëqind e njëzetë e tetë) kërkesa. Janë zhvilluar gjithashtu një sërë konferencash për shtyp në lidhje me forcimin e bashkëpunimeve të SPAK me autoritete gjyqësore të huaja dhe institucionet ndërkombëtare** lidhur me hetime komplekse në kuadrin e ngritjes së skuadrave të përbashkëta hetimore.

Në kuadër të rritjes së transparencës me publikun, janë mbajtur takime periodike me gazetarët e kronikës, jashtë kamerave “off the record”, ku Drejtuesi i Prokurorisë ka diskutuar dhe ju është përgjigjur interesimit të gazetarëve brenda kornizave ligjore, praktikë e cila përbën një risi në komunikimin me publikun. **SPAK ka marrë pjesë edhe në analizat e kryera nga shoqëria civile** për punën dhe efektivitetin e SPAK, si dhe i është përgjigjur ftesave të ardhura nga institucionet e arsimit të lartë, për t’iu përgjigjur interesimit të studenteve ndaj natyrës së punës së SPAK.

Ky Raport vjetor parashtron në seksionet më poshtë, problematikat të cilat duhet të adresohen si dhe analiza dhe të dhëna më të detajuara për aktivitetin e SPAK. Seksioni i parë fokusohet në adresimin e prioriteteve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit evropian të cilat lidhen me funksionin e SPAK, adresimin e Rezolutës të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe adresimin e Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave. Në seksionin e dytë jepet një vështrim i përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit duke përfshirë këtu format, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe tendencat e veprave penale që hetohen nga SPAK. Në seksionin e tretë bëhet një analizë krahasimore e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme, duke nënvizuar të dhënat mbi efektivitetin e punës në hetim dhe gjykim të institucionit përgjatë tre viteve të fundit. Në seksionin e katërt jepen të dhënat e volumit të punës për të gjithë sektorët si dhe elemente të tjera thelbësore të veprimtarisë së institucionit për vitin 2023. Raporti bëhet publik nëpërmjet publikimit

të tij në faqen zyrtare të SPAK. Kopje të raportit i paraqiten gjithashtu Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

PROBLEMATIKAT TË CILAT DUHEN ADRESUAR



Prokuroria e Posaçme, ka paraqitur disa problematika që i ka hasur në punën e saj 4-vjeçare, të cilat përthehen në propozime të mundshme për të kryer ndryshimet e nevojshme ligjore qoftë në ligjin organik nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, apo dhe në ligje të tjera, të cilët do të ndikonin në cilësinë dhe mbarëvajtjen e punës së Prokurorisë së Posaçme.

Problematikat që kanë dalë gjatë veprimtarisë funksionale të Prokurorisë së Posaçme janë si më poshtë:

1. Mungesa e përcaktimit të qartë ligjor në lidhje me statusin e prokurorëve të posaçëm pas përfundimit të mandatit të tyre. Kjo paqartësi ligjore do të cënonte pavarësinë e prokurorëve të posaçëm, por dhe statusin e tyre si magjistrat, mbështetur edhe në parimin e funksionalitetit të sistemit të drejtësisë. Mospërcaktimi i qartë i statusit do të ndikonte edhe në vijimësinë e ruajtjes së standardeve të larta profesionale të hetimit të kërkuara nga SPAK, duke marrë parasysh nivelin e lartë profesional tashmë të akumuluar, si nga përvoja profesionale, por edhe nga trajnimet e shumta të specializuara të përfituara nga prokurorët e posaçëm gjatë mandatit të parë. Nga ana tjetër, do të cënohej gjithashtu dhe vazhdimësia e hetimeve të rëndësishme të kryera nga SPAK. Theksojmë se, në Prokurorinë e Posaçme janë ngritur në detyrë 17 prokurorë deri në fillimin e vitit 2022 (85% e numrit total të prokurorëve sipas organikës). Me përfundimin e mandateve të tyre, plotësimi i këtij numri të lirë vendesh do të kërkojë kohë duke vënë në vështirësi të konsiderueshme funksionimin e SPAK dhe vijimin e hetimeve të dosjeve të rëndësishme të cilat ndiqen penalisht nga prokurorët të cilëve ju përfundon mandati.

2. Mungesa e këshilltarëve ligjor, të cilët janë të domosdoshëm në analizat ligjore të çështjeve, që sipas ligjit duhet të ndiqen nga SPAK në të gjitha shkallët e gjykimit. Referuar kompleksitetit të natyrës së çështjeve që SPAK heton, analiza ligjore e tyre, kërkon detyrimisht përfshirjen e një mendimi të specializuar ligjor nga këshilltarë ligjor me përvojë në veprat penale të cilat janë nën juridiksionin lëndor të SPAK.

3. Adresimi i ngarkesës së shtuar sipas parashikimit të pikës 8, të nenit 179/b, të Kushtetutës, ndaj Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme mbi çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të magjistratëve pas marrjes së kompetencave të Komisionerëve Publikë, me përfundimin e mandatit të tyre në datën 31.12.2024. Nga një analizë e përgjithshme, parashikohet një stok me rreth 30 ankime të Komisionerëve Publikë, të cilat do të duhet të ndiqen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Mbështetur në të dhënat statistikore të numrit të seancave të zhvilluara për një çështje në Kolegjin e Posaçëm të Apelit parashikohet se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, do të duhet të ndjekë rreth 150 seanca gjyqësore, në harkun kohor janar 2025-qershor 2026, numër që mund të rritet në varësi të kompleksitetit të çështjeve.

- 4. Mungesa e referimeve nga institucionet publike** në lidhje me veprat penale në kuadër të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Siç u cilësua edhe me lart, referimet nga institucionet publike në vitin 2023 kanë një rënie prej 40% krahasuar me vitin 2022.
- 5. Shtimi i numrit të hetuesve të BKH-së,** duke pasur parasysh se mbi 75% e hetimeve kryen prej tyre. Kjo lidhet edhe me problematikën e shfaqur në marrëdhëniet e besimit të SPAK me shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, ku në jo pak raste është evidentuar përfshirja e punonjësve të policisë së shtetit në veprime korruptive dhe bashkëpunime me grupet kriminale.
- 6. Numri i konsiderueshëm i procedimeve të mbartura** mbetet problematik. Një ndër arsyt kryesore është mungesa e burimeve njerëzore. Për adresimin e kësaj problematike, përveç analizave të kryera më prokurorët e çështjeve, është komunikuar edhe me projektet e asistencës ndërkombëtare për të përgatitur një strategji të posaçme, për evadimin e këtyre çështjeve.
- 7. Vijon të mbetet problematike statusi i specialistit Ndërlidhës në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta,** i cili trajtohet si nëpunës civil bazuar në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar. Kjo situatë është në kundërshtim me funksionet që duhet të kryejë Specialisti Ndërlidhës sipas ligjit nr. 95/2016, pasi kërkesat për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale dërguar nga/për autoritetet e huaja, si dhe hetimet e përbashkëta, bazohen në Konventa shumëpalëshe, dypalëshe, Kodin e Procedurës Penale, si dhe në ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, të ndryshuar, të cilat kanë si objekt kryerjen e veprimeve procedurale. Sjellim në vemëndje se, në Drejtorinë homologe të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, këto veprime kryhen nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.
- 8. Mungesa e kompetencës për shqyrtimin e kërkesave të autoriteteve të huaja lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja në Shqipëri në ngarkim të shtetasve shqiptarë për veprat penale, për të cilat Prokuroria e Posaçme ka në kompetencë,** sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu edhe paraqitja e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimet e vendimeve penale të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga një shtet i huaj.
- 9. Mungesa e kompetencës lëndore e Gjykatave të Posaçme për shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimit penal për subjektet e posaçme sipas parashikimeve të nenit 135, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.** Aktualisht këto kërkesa shqyrtohen nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm penal.
- 10. Vazhdon dhe mbetet problematike çështja e mosekstradimit të shtetasve shqiptarë të lokalizuar apo arrestuar në Emiratet e Bashkuara Arabe.**

RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE, PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË “PROGRES-RAPORTIT” TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN

Në Progres Raportin për Shqipërinë 2023, Komisioni European vlerëson progresin e Shqipërisë "në një nivel të moderuar përgatitjeje" në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European.

Sipas Screening dhe Progresit Raport 2023, lidhur me luftën kundër korrupsionit vlerësohet se, ka përparime, por mbetet një fushë shqetësimi serioze. KE vlerëson SPAK për hetimet që ka kryer “për një sërë çështjesh të nivelit të lartë”, por në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit dhe masat parandaluese vazhdojnë të kenë një ndikim të kufizuar, veçanërisht në sektorë të cenueshëm. Lidhur me luftën kundër krimit të organizuar vlerësohet se, Shqipëria ka përgatitje me një nivel të mirë e të vazhdueshëm bashkëpunimi me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me agjencitë e BE-së.

- Në lidhje me rekomandimet e BE-së, sipas Screening dhe Progres Raportit ku janë cilësuar 3 rekomandime, menjëherë pas publikimit të Raportit, SPAK mori takim me projektet e asistencës të Bashkimit Evropian për të diskutuar mundësinë e marrjes së masave dhe përgatitjes së akteve nënligjore të nevojshme, si:
 - **Përgatitja e një Udhëzimi të Përgjithshëm mbi hetimin financiar**
SPAK në bashkëpunim me projektin EU4FOCAL ka ngritur një grup punë, të cilët po merren me hartimin e këtij udhëzimi.
 - **Një politikë për prioritizimin e çështjeve dhe uljen e çështjeve të mbartura**
SPAK, në bashkëpunim me projektet e asistencës ndërkombëtare do të përgatisë një strategji të veçantë për këtë aspekt. Në fazën aktuale, po pritet që projektet e asistencës të caktojnë një ekspert, i cili do të ndihmojë në përgatitjen e një strategjie për uljen e çështjeve të mbartura.
 - **Një strategji për komunikimin me publikun**
SPAK është në përgatitje të një strategjie komunikimi, të cilën po e konsulton me ekspertë ndërkombëtarë.

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT DHE REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË LUFTË KUNDËR KRIMINALITETIT

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Gjatë vitit 2023 Prokuroria e Posaçme, në funksion të kryerjes me efektivitet të detyrave të saj kushtetuese dhe ligjore ka vlerësuar dhe zbatuar rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, të dhëna nëpërmjet “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2022”, të miratuar në seancën plenare të datës 06.07.2023. Në këtë rezolutë, janë adresuar edhe rekomandime për të cilat është kërkuar bashkërendim/bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme.

1. Të rrisë përdorimin e teknikave të hetimit dhe numrin e hetimeve proaktive në çështjet e korrupsionit të zyrtarëve të lartë, përfshirë dhe ish-magjistratë, dhe krimit të organizuar me prioritet çështjet me interes të veçantë publik.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

Prokuroria e Posaçme, në kuadër të përmbushjes së misionit të saj themelor, siç është lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përveç vijimit të hetimeve të referuara nga burime të ndryshme si publiku, shoqëria civile, e organe të tjera ligjzbatuese, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë regjistrimit të procedimeve kryesisht. Më konkretisht, gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar si çështje kryesisht 67 procedime penale me 23 persona në hetim, çfarë përbën një tregues pozitiv në rritje të numrit të kësaj kategorie hetimesh, më shumë se dyfishi krahasuar me vitin 2022, ku ishin regjistruar 28 procedime penale me 34 persona në hetim.

- Një tjetër metodë proaktive për ndjekjen e hetimeve penale e cila vijon të intensivkohet dhe rritet, është cilësuar bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet krijimit të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, ku vetëm në vitin 2023 janë krijuar 10 prej tyre ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe shteteve të huaja, në funksion të hetimeve të Prokurorëve të Posaçëm, nga 25 Skuadra të cilat janë aktive në total në Prokurorinë e Posaçme që nga krijimi i saj.
- Po kështu duhet cilësuar se ka pasur një rritje të aplikimit të metodave të hetimit proaktiv, në rastin e përgjimeve telefonike, por është rritur gjithashtu edhe aplikimi i metodave të posaçme të hetimit si: vëzhgime, kontrole, simulime, sekuestro i provave materiale, letërporosi, agjentë të infiltruar etj.
- Gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 186 procedime penale ku janë interceptuar 3335 pajisje fundore (pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim), ku vërehet rritje krahasuar me vitin 2022.
- Në vitin 2023, pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, e kryesojnë çështjet e hetuara për veprën penale të korrupsionit me 109 procedime penale ku janë interceptuar 1436 pajisje fundore, nga 69 procedime penale dhe interceptuar 1023 pajisje fundore, të aplikuara në vitin 2022.
- Ndërkohë për çështjet penale të hetuara në kuadër të grupit të strukturuar kriminal janë përdorur metoda të posaçme hetimore në 77 procedime penale, ku janë interceptuar 1899 pajisje fundore, nga 53 procedime penale janë interceptuar 1154 pajisje fundore, të aplikuara në vitin 2022.
- Gjatë vitit 2023, SPAK ka mirëmbajtur lidhjet për të gjithë sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave ku ka pasur akses më parë dhe gjithashtu ka marrë akses edhe për baza të dhënash të tjera si:
 - Sistemi “ASYCUDA” nga Drejtoria e Përgjithshme me e Doganave;
 - Sistemi “ISSH” nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
 - Sistemi C@ts nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - Sistemi i Fiskalizimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në mënyrë të përmbledhur, krahasimisht me vitin 2022 ka një rritje të hetimeve të nisura kryesisht prej 139%, ndërkohë që ka një rritje prej 91% të interceptimit të pajisjeve fundore si dhe ka një rritje me 95% për kërkesat për ndihmë juridike për jashtë vendit.

2. Të rrisë numrin e hetimeve financiare dhe pasurore, si dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale, që rezultojnë nga veprat penale të kryera në kuadrin e korrupsionit dhe krimit të organizuar brenda dhe jashtë vendit.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

Prokuroria e Posaçme, në vijim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale që rezultojnë nga veprat penale, gjatë vitit 2023 ka arritur të sekuestrojë dhe konfiskojë një portofol të diversifikuar asetesh, si pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare si dhe portofole kriptovalutash. Më konkretisht:

- **Në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009**, Prokuroria e Posaçme, për vitin 2023 ka regjistruar 22 hetime pasurore.
Janë paraqitur në gjykatë 8 kërkesa për sekuestrim, në vlera të hollash, subjektsh tregtare, pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme, ndërkohë që nga gjykata janë marrë 7 vendime sekuestrimi me pranim kërkesë pasuri të cilat vlerësohen rreth 275,553,016 Lekë.
Janë paraqitur në gjykatë 6 kërkesa për konfiskimin e pasurive, nga të cilat, 1 kërkesë e vitit 2022 dhe 5 kërkesa të vitit 2023, ndërkohë që janë dhënë nga gjykata 6 vendime për konfiskimin e pasurive. Nga vlerësimi për 5 vendime për konfiskim pasurie rezultojnë në vlerën rreth 64,341,850 Lekë.
- **Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020**, nga GJKKO janë marrë 16 vendime me objekt konfiskimi. Nga GJAKKO janë dhënë 14 vendime, të cilët kanë lënë në fuqi vendimin e GJKKO.
Pasuritë e konfiskuara sipas Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020, vlerësohen rreth 370,718,221 Lekë.
- **Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, gjatë procesit penal**, nga GHKKO janë marrë 8 vendime me objekt sekuestro preventive, pasuri të cilat vlerësohen rreth 1,711,258,000 Lekë. Nga GJKKO janë marrë 20 vendime me objekt konfiskimi, nëpërmjet të cilëve janë konfiskuar, 4 pasuri të paluajtshme, 11 pasuri të luajtshme, 54 sende me vlerë, vlera monetare rreth 18.350.000 euro dhe 5.800.000 Lekë. Në total vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara së bashku për vitin 2023 përlllogaritet në vlerën prej 41 milion Euro.

3. Të forcojë bashkëpunimin me Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë dhe të vlerësojë referimet nga publiku, media dhe shoqëria civile lidhur me praktikën e mundshme korruptive në radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe OPGJ-ve të të gjitha niveleve si kusht për të garantuar përgjegjshmërinë dhe integritetin profesional dhe etik në sistemin e drejtësisë.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se, gjatë vitit 2023:

- Janë hetuar (të mbartura + të regjistruara) gjithsej 20 procedime penale me 22 persona në hetim/pandehur, ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë, me funksion: 3-ish-Gjyqtarë të Shkallës së Parë, 1-ish-Gjyqtar i Apelit, 1-ish-Prokuror, 5-ish-Kryetarë Bashkie, 1-ish kandidat për Kryetar Bashkie, 2- Kryetar Bashkie, 1-ish-Ministër Finance, 1-ish-Ministër Mbrojtje, 1-ish-Ministër Mjedisi, 1-ish-Ministër Shëndetësie, 1-ish-zv.Ministër Shëndetësie, 1-ish-Kryeministër, 1-ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, 1-ish-Sekretar i

Përgjithshëm Ministrisë së Drejtësisë, 1-ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë.

- Janë regjistruar për herë të parë 8 procedime penale me 18 persona në hetim/pandehur, ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë, me funksion 1-ish-Minister Shëndetësie, 1-ish-zv.Ministër Shëndetësie, 1-ish-Gjyqtar i Apelit, 5-ish-Kryetarë Bashkie, 1-ish-Ministër Finance, 2-Kryetar Bashkie, 1-ish-Kryeministër, 1-ish-Ministër Mjedisi, 1-ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, 1-ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, 1-ish-Sekretar i Përgjithshëm Ministrisë së Drejtësisë, 1-ish kandidat për Kryetar Bashkie dhe 1-ish-Prokuror.
- Janë dërguar në Gjykatë 11 çështje me kërkesë për gjykim me 12 persona të pandehur në cilësinë e ish-zyrtarit të nivelit të lartë, me funksion, 5- ish- Kryetarë Bashkie, 1-ish-Gjyqtar, 1-ish-Ministër Mjedisi, 1-ish-Ministër Finance, 2-Kryetar Bashkie, 1-ish kandidat për Kryetar Bashkie, 1-ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë.
- Janë dënuar 9 zyrtarë të nivelit të lartë nga GJKKO, me funksion, 2- ish-Deputet, 2-ish-Gjyqtarë, 3-ish-Kryetar Bashkie, 1-ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, 1-ish Nënkryetarë Bashkie.
- Është në proces hetimi 1 ish-magjistrat, me funksion ish - gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për shkak të veprave penale për të cilat është shkarkuar nga vetingu.
- Janë dënuar nga GJKKO 2 ish-magjistratë me funksion gjyqtar, ku një prej tyre ka qenë ish-gjyqtar me funksionin e ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.
- Janë në proces gjykimi në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 4 ish-magjistratë, për shkak të veprave penale për të cilat janë shkarkuar nga vetingu.

4. Të vijoje puna për ngritjen e sistemit të administrimit të çështjeve, ku të vlerësohet dhe përfshirja e krijimit të “track rekordit” për procedimet penale të korrupsionit në nivele të larta, kusht i vendosur edhe nga Komisioni Evropian.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

Prokuroria e Posaçme ka vijuar të ndjekë me përparësi ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve i cili do të mbështesë rrjedhën e punës së Prokurorëve dhe Hetuesve të BKH/OPGJ, zyrës së regjistrave dhe protokollit, duke mundësuar përmirësime të rëndësishme të punës së përditshme dhe mbi të gjitha, duke adresuar ndërveprimin konstant të punës së përditshme të prokurorëve, hetuesve të BKH dhe regjistrimit të dokumenteve dhe elementeve të kësaj pune në regjistrat e ndryshëm, me qëllim shmangien e mbivendosjes së punës.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi të menaxhimit të të gjitha çështjeve të trajtuara nga SPAK, mundësinë e krijimit të një regjistri elektronik/bazë të dhënash, i cili mundëson ndjekje dhe administrim më të mirë të çështjeve, ndarje më të mirë të detyrave dhe përgjegjësi midis Prokurorëve, Hetuesve të BKH, zyrës së regjistratit, komunikimin me gjykatën dhe analizimin e këtij informacioni për të nxjerr raporte dhe statistika të sakta dhe në kohë reale. Mbi të gjitha krijon një bazë të dhënash të domosdoshme për përditshmërinë, por edhe vazhdimësinë e punës.

Zhvillimi dhe implementimi i Sistemit të Menaxhimit të çështjeve SPAK/BKH, mundëson përveç të tjerave edhe një administrim dhe menaxhim më të mirë të të gjitha burimeve njerëzore dhe

logjistike.

Sistemi ka një ndërtim modular dhe sipas parashikimeve paraprake në fillim të muajit korrik 2024 do të fillojë faza pilotuese dhe testuese e sistemit, ndërsa brenda vitit pritet të përfundojë komplet sistemi së bashku me modulën e fundit i cili është ai i raporteve dhe statistikave të cilat do të gjenerohen me të dhënat e sistemit deri në atë moment.

5. Të përmbyllë procesin e plotësimit të vendeve vakante në SPAK dhe të vijojë me nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat përmirësojnë efikasitetin e tij.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2023 kanë ushtruar detyrën gjithsej 105 punonjës, nga të cilët 17 (shtatëmbëdhjetë) Prokurorë të emëruar, 1 (një) Prokuror i transferuar, 12 (dymbëdhjetë) Hetues Financiar, 77 (shtatëdhjetë e shtatë) punonjës administrativë dhe 1 (një) punonjës me kontratë.

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2023, janë shpallur dhe zhvilluar procedura të punësimit për 30 pozicione të ndryshme, ku janë punësuar 28 (njëzet e tetë) punonjës, nga të cilët:

- të emëruar me kontratë pune me status Oficeri të policisë gjyqësore janë 12 (dymbëdhjetë) Hetues Financiar;
- të emëruar me kontratë pune janë 6 punonjës (1 (një) Këshilltar Ligjor, Kabineti i Drejtuesit dhe 5 (pesë) punonjës të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse (punonjës pastrimi dhe shoferë);
- të emëruar me procedura sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, janë 10 punonjës, nga të cilët (5 (pesë) punonjës të emëruar me procedurën “pranim në shërbimin civil”, 1 (një) punonjës i emëruar me procedurën “lëvizje paralele” dhe 4 (katër) punonjës të emëruar me procedurën “ngritje në detyrë”);
- në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, pranë Prokurorisë së Posaçme për vitin 2023 ka ushtruar funksionin 1 (një) punonjës me kontratë pune, me kohëzgjatje 6 orë në ditë, me afat 6 muajor.
- në proces të zhvillimit të procedurës, por të pa përfunduara janë 2 (dy) pozicione me status nëpunësi civil, (1 (një) kategoria ekzekutive dhe 1 (një) kategoria e ulët drejtuese).

Në përfundim të vitit 2023, për arsye të lëvizjes së punonjësve ekzistues, si dhe për arsye objektive si rezultat i mungesës së zyrave janë zhvilluar procedura që kanë qenë të domosdoshme, procedurat e mbetura të rekrutimit, për pozicione pjesë e planeve të rekrutimit të vitit 2023, janë planifikuar të zhvillohen gjatë vitit 2024.

Për sa i takon Byrosë Kombëtare të Hetimit, Struktura organizative e BKH-së është miratuar me Urdhrin e Përbashkët nr. 2 datë 12.01.2022, të Drejtorit të BKH-se dhe nr.28 datë 12.01.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme "Për Organizimin e Brendshëm të Byrosë Kombëtare të Hetimit". Në këtë akt janë përcaktuar 130 pozicione pune, nga të cilët, 1 pozicion drejtori, 110 hetues dhe oficer të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe 19 punonjës administrativ.

Përgjatë vitit 2023 është përfunduar procesi i rekrutimit të 6 punonjësve të stafit administrativ (këshilltar, 4 specialist dhe 1 drejtues automjeti). Bazuar në strukturën aktuale, viti 2023 është

mbyllur me 1 vakancë në kabinetin e Drejtorit të BKH-së, 50 vakanca në pozicionet e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe 7 vakanca në stafin administrativ.

6. Të realizojë ndërtimin e një kornize strategjike institucionale që të përmbajë: Planin Strategjik të Institucionit, Strategjinë e Komunikimit (procesi të drejtohet nga Koordinatorin për Marrëdhëniet me Mediat); Strategjinë e Burimeve Njerëzore dhe Planin e Trajnimit të punonjësve sipas kategorive, Strategjinë e TIK-ut dhe Sigurisë Kibernetike. Këto të shoqërohen me plane vjetore veprimi.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2023 ka realizuar me sukses objektivat e saj në përfundimin e kuadrit rregullator të institucionit, duke hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore për mirëfunksionimin e veprimtarisë institucionale, në përmbushje të misionit kryesor të Prokurorisë së Posaçme, siç janë:

- Rregullorja e Sjelljes dhe Standardeve të Etikës, në Prokurorinë e Posaçme.
- Plani i trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive 2023-2026.
- Rregullorja për Përdorimin e Postës dhe Komunikimin Elektronik.
- Është hartuar Strategjia e Burimeve Njerëzore për vitin 2024-2026, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për tu miratuar gjatë vitit 2024.
- Është hartuar Plani Strategjik i Institucionit, i cili është hartuar si dokument dhe është në proces vlerësimi të brendshëm dhe me ekspertë ndërkombëtar, për tu miratuar gjatë vitit 2024.
- Është hartuar Strategjia e TIK-ut dhe Sigurisë Kibernetike, për tu miratuar gjatë vitit 2024.
- Në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtar ka filluar puna për zhvillimin e një Strategjie të Komunikimit me Publikun e cila parashikohet të përfundojë në vitin 2024.
- Është përgatitur një vlerësim i riskut të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si pjesë e analizës së brendshme, i cili është në proces konsultimi të brendshëm.
- Në korrik të vitit 2023 është miratuar nga Këshilli i Ministrave Vendimi nr. 438 datë 19.07.2023 “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për trajtimin e punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

7. Të hartojë një plan vlerësimi për integritetin, që të përmbajë masa konkrete antikorrupsion, masa mbi etikën dhe sjelljen e punonjësve të SPAK-ut. Plani mund të qëndrojë i veçantë apo të integrohet në planin e veprimit të Strategjisë së Burimeve Njerëzore.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

Prokuroria e Posaçme në synim të realizimit të objektivave institucionale, ku plani i integritetit përbën një nga shtyllat kryesore të konsolidimit të institucionit gjatë vitit 2023:

- Miratoi Rregulloren e Sjelljes dhe Standardeve të Etikës, në Prokurorinë e Posaçme.
- Hartoi Rregulloren për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, në Prokurorinë e Posaçme, për tu miratuar gjatë vitit 2024.
- Hartoi Rregulloren për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në Prokurorinë e Posaçme, për tu miratuar gjatë vitit 2024.

- Hartoi Strategjinë e Burimeve Njerëzore për vitin 2024-2026 në Prokurorinë e Posaçme e cila implementon në vetvete politika të përmbushjes së planit të integritetit.

Përgjatë vitit 2023 nga Byroja Kombëtare e Hetimit janë hartuar dy projekt – aktet si më poshtë:

- “Rregullorja e Brendshme të Byrosë Kombëtare të Hetimit” dhe
- “Rregullorja për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të Hetimit”.

Këto projekt - akte janë në fazë konsultimi të brendshëm me Prokurorinë e Posaçme me qëllim finalizimin brenda vitit 2024.

8. Të identifikojë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të organizatave ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe të adresohen ato në përputhje me ligjin dhe praktikën e mirëpranuara ndërkombëtare.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

- Shqipëria në shkurt 2020 u përfshi në listën e vendeve “nën monitorim të shtuar” nga grupi i posaçëm i veprimit financiar (FATF), njohur ndryshe si “lista gri”.
- Në këtë kuadër Shqipëria ndërmoi menjëherë një angazhim të nivelit të lartë shtetëror gjithëpërfshirës për të bashkëpunuar me FATF dhe MONEYVAL për të forcuar efektivitetin e sistemit parandalues të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet dakordësimit të një plani veprimi, ku SPAK ka plotësuar një nga komponentët kryesorë që lidhet me “rritjen e numrit dhe përmirësimit të sofistikimit të hetimeve dhe konfiskimeve të pastrimit të parave..”.
- Në plenaren e FATF në qershor 2023, Shqipëria siguroi ftesën për realizimin e vizitës në vend (on-site), procedurë që i parapriu daljes së vendeve nga “lista gri”. Në datat 28 - 29 Gusht 2023 u zhvillua vizita në vend (on site) e grupit të ekspertëve vlerësues të planit të veprimit me ICRG/FATF ku pati takime (face to face) me përfaqësuesit e SPAK.
- Në seancën plenare të datës 27 tetor 2023, FATF miratoi vendimin për daljen e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si “lista gri”, duke veçuar kontributin e SPAK dhe rezultatet e SPAK në këtë drejtim për IO7 dhe IO8, rezultate pozitive në luftën kundër pastrimit të parave të cilat adresonin problematikat gjerësisht.
- Në kuadër të rekomandimeve të FATF, detyrimeve në kuadër të ratifikimit të Konventës së Varshavës si dhe detyrimeve të Direktivës përkatëse të BE mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, është kryer Vlerësimi Kombëtar i Riskut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (PP/FT) në vendin tonë dhe Plani i Veprimit të këtij vlerësimi, ku SPAK është kontributor në hartimin e Vlerësimit Kombëtar të Riskut, dokument nëpërmjet të cilit synohet marrja e masave të përshtatshme për zbutjen e risqeve të identifikuara.
- Në kuadër të proceseve vazhduese të vlerësimit nga MONEYVAL, në vitin 2025 Shqipëria do të ketë vizitën në vend nga Moneyval në funksion të vlerësimit të Raundit të 6-të të vlerësimit, SPAK është anëtar i Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me vendim të Komitetit KBLKPP, për Hartimin e “Strategjisë Kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030”.

Përgjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme dhe BKH, si struktura kontribuese kanë dhënë kontribut në hartimin, miratimin dhe procesin e monitroit për:

- Progres Raportin Vjetor të Komisionit Evropian;
- Nënkomitetin “Drejtësia Liria dhe Siguria”;
- Raportimet periodike për Kapitullin 23 dhe 24;
- Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 736 datë 13.12.2023;
- Strategjinë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021-2025;
- Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025;
- Pyetësin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara mbi korrupsionin e niveleve të larta etj.

9. Të vijojë me nënshkrimin e marrëveshjeve teknike të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe shteteve të tjera që SPAK e shikon të nevojshme në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale, që lidhen me kompetencat lëndore të SPAK-ut.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2023, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bashkëpunimit me institucionet vendase publike dhe private ka nënshkruar gjithashtu 4 marrëveshje bashkëpunimi si vijon:

- Marrëveshja për Bashkëpunim ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorit Publik Evropian;
- Marrëveshje e shërbimit, e lidhur ndërmjet Prokurorisë së Posaçme, Prokurorisë së Përgjithshme, SHISH, dhe kompanive telefonike Vodafone, dhe ONE;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Posaçme, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për dhënie aksesit në sistemin elektronik Asycuda world;
- Në kushtet e ndryshimeve ligjore të bëra në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009 “*Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale*”, të ndryshuar, në vitin 2023 ka vijuar punën në grupin e përbashkët të punës të ngritur për këtë qëllim me Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme për Hartimin e Udhëzimit të Përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme “*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për formën e kërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale*”.

10. Të uniformizojë standardet e hetimit dhe ndjekjes penale në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.

Në lidhje me këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit nënvizohet se:

Prokuroria e Posaçme, ndjek dhe zbaton me rigorozitet kriteret ligjore të përcaktuara në drejtim të hetimit dhe ndjekjes penale, duke mbajtur parasysh interesin tërësor, rëndësinë dhe impaktin e çështjeve penale, konform ligjit dhe në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Në këtë aspekt, Prokuroria e Posaçme, në vlerësim të hetimeve penale që ka ndjekur gjatë vitit 2023, ka vlerësuar riskun dhe i ka zbatuar masat e sigurimit duke ndjekur parimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Të gjitha masat e sigurimit janë vlerësuar nga GJKKO.

Në lidhje me hetimin e veprave penale në kuadër të luftës kundër korrupsionit, përqindja e masave të sigurimit “ arrest me burg” zënë 32% të masave në total, 18 % zënë masat e sigurimit “arrest shtëpie” , 16 % zënë masat e sigurimit “detyrim paraqitje” dhe 34 % ato pa masë sigurimi.

Në lidhje me hetimet e veprave penale që lidhen me krimin e organizuar, përqindja e masës së sigurimit “ arrest me burg” zë 82 % të masave në total, ndërkohë masa “arrest shtëpie” zë 10 % masave të sigurimit, masa “detyrim paraqitje” zë 5 %, dhe 3 % janë hetuar pa masë sigurimi.

Krahasimisht me vitet paraardhëse, Prokuroria e Posaçme ka ndjekur të njëjtën strategji për vendosjen e masave të sigurimit, duke garantuar kështu standardet e hetimit, të cilat siç vihet re janë shpërndarë në mënyrë proporcionale në llojet e masave të aplikuara, në varësi të tipologjisë së çështjes, rëndësisë dhe rrezikshmërisë së saj.

Duhet cilësuar, që masat e sigurimit personal të arrestit me burg të aplikuara në vitin 2023 mund vijnë në një rritje të lehtë krahasimisht me 2022, përkatësisht me 8 % për korrupsionin dhe 2 % për krimin e organizuar, por rritja është proporcionale me rritjen e numrit të hetimeve dhe personave të regjistruar në hetim dhe rëndësisë që paraqesin çështjet penale.

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMINALITETIT:

1. Në lidhje me rekomandimin “*Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të Prokurorisë së Posaçme, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur, vijimin e rritjes së numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave, si dhe ashpërsimin e politikës së dënimit dhe masave të sigurimit personal për këto vepra penale*”.

Për vitin 2023, Prokuroria e Posaçme ka hetuar në total 750 procedime penale (mbartur + regjistruar), nga të cilat 451 procedime penale janë mbartur nga viti 2022, ndërsa 299 procedime të reja janë regjistruar në vitin 2023. Nga numri total i procedimeve penale prej 750, për 42 procedime është vendosur bashkimi i tyre me procedime të tjera. Pas bashkimit të procedimeve penale, numri total i çështjeve të hetuara nga Prokuroria e Posaçme për këtë vit është 708 procedime, me 575 persona nën hetim, për veprat penale në fushën e korrupsionit, në fushën e krimin të organizuar dhe vepra të tjera penale në kompetencë të saj, siç janë veprat me qëllime terroriste, veprat penale të korrupsionit zgjedhor, etj.

Gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka hetuar gjithsej 447 çështje me 212 persona nën hetim për veprat penale në fushën e korrupsionit. Nga këto janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 38 çështje me 142 të pandehur, nga të cilët 38 persona të pandehur hetuar me masa sigurimi arrest në burg, 6 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “arrest në burg në mungesë”, 22 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, 19 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi në policinë gjyqësore “detyrim për tu paraqitur”, 1 person i pandehur “ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe 56 persona të pandehur janë hetuar dhe dërguar në gjykatë pa caktuar ndaj tyre ndonjë masë sigurimi.

Gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka hetuar gjithsej, 201 çështje (mbartur + regjistruar) për 268 persona nën hetim për veprat penale të krimit të organizuar. Nga këto janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 11 çështje për 109 të pandehur, nga të cilët 90 persona të pandehur hetuar me masa sigurimi “arrest në burg”, 5 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “arrest në burg në mungesë”, 3 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, 10 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “detyrim për tu paraqitur”, 1 person i pandehur “ ndalimi i daljes jashtë shtetit”.

Gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka hetuar 60 vepra penale të tjera në kompetencë të saj siç janë veprat me qëllime terroriste, veprat penale të korrupsionit zgjedhor etj., me 95 persona nën hetim.

2. Në lidhje me rekomandimin “Rritjen e numrit të hetimeve të çështjeve të filluara kryesisht, rekomandim i përsëritur ndër vite (numri i të cilave vijon të jetë i ulët), si dhe vijimin e rritjes së numrit të hetimeve proaktive, përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit, me qëllim vazhdimin e përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së hetimeve, veçanërisht për veprat penale në fushën e korrupsionit referuar kompetencës lëndore”.

Prokuroria e Posaçme nënvizon se, i është kushtuar një rëndësi e veçantë regjistrimit të hetimeve të filluara kryesisht, dhe më konkretisht gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar si çështje kryesisht 67 procedime penale me 23 persona në hetim. Ky tregues ka një rritje të konsiderueshme, me dyfishim të numrit të hetimeve të filluara kryesisht krahasuar me vitin 2022.

- Sa i takon metodave proaktive për ndjekjen e hetimeve penale përmendim se, vijon të intensifikohet dhe rritet bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet krijimit të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, ku vetëm në vitin 2023 janë krijuar 10 prej tyre, nga 25 Skuadra të cilat janë aktive në total në Prokurorinë e Posaçme, që nga krijimi i saj.
- Cilësojmë se, ka pasur rritje të aplikimit të metodave të hetimit proaktiv, në rastin e përgjimeve telefonike, por është rritur gjithashtu edhe aplikimi i metodave të posaçme të hetimit si, vëzhgime, kontrole, simulime, sekuestro i provave materiale, letërporosi, agjentë të infiltruar etj.), ku përgjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 186 procedime penale ku janë interceptuar 3335 pajisje fundore (pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim).

3. Në lidhje me rekomandimin “Marrjen e masave për evidentimin dhe rritjen e numrit të procedimeve për veprat penale në fushën e terrorizimit, përfshirë dhe rastet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare”.

Prokuroria e Posaçme i ka kushtuar një vëmendje të veçantë veprave penale në fushën e terrorizmit. Kështu, gjatë vitit 2023, janë mbartur dhe regjistruar 28 procedime penale me 25 persona në hetim për veprat penale me qëllime terroriste dhe janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 3 procedime penale me 25 persona të pandehur, akuzuar për veprat penale me qëllime terroriste. Ky është një tregues pozitiv, me rritje të rezultateve në krahasim me vitin 2022, ku ishin hetuar 22 procedime penale me 8 persona në hetim për veprat penale me qëllime terroriste dhe u dërguan në gjykatë me kërkesë për gjykim 3 procedime penale me 3 persona të pandehur, akuzuar për veprat penale me qëllime terroriste.

4. Në lidhje me rekomandimin “Rritjen e numrit të hetimeve financiare sistematike dhe hetimit financiar paralel për veprat penale, që gjenerojnë produkte/të ardhura”.

Prokuroria e Posaçme nënvizon se, gama e produkteve të veprave penale të hetuara në kuadrin e pastrimit të parave ka qenë e larmishme, duke përfshirë këtu për herë të parë edhe hetime, që lidhen me kriptovalutat dhe sasi të konsiderueshme parash të depozituara në llogari bankare. Sa i takon procedimeve penale të hetuara në fushën e pastrimit të produkteve penale gjatë vitit 2023, janë hetuar 76 procedime (të mbartura dhe të regjistruara), me 53 persona nën hetim, nga të cilat 2 procedime janë dërguar në gjyq, me 8 persona të dërguar për gjykim, dhe 15 pandehur rezultojnë të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale gjatë 2023.

Në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, Prokuroria e Posaçme, për vitin 2023 ka regjistruar 22 hetime pasurore reja, krahas hetimeve pasurore të mbartura nga vitet e kaluara, si dhe krahas hetimeve pasurore, që bëhen për çdo çështje penale në kuadër të hetimit penal.

Nga vlerësimi i kryer në vitin 2023, të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, vlera e tyre përllëgaritet në shumën prej 41 milion Euro, nga ku 54% e zënë pasuritë e konfiskuara në vlerën 22.5 milion Euro (440 milion lekë + 18 milion Euro) dhe 46% e zënë pasuritë e sekuestruara në vlerën 1.9 miliard Lekë (19 milion Euro).

5. Në lidhje me rekomandimin “Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizimit, të bashkëpunimit me Eurojust, si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore dhe rekomandimin “Shtimin e rasteve të gjurmimit të produkteve të veprave penale/pasurive dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve, përfshirë rastet e tjetërsimit të tyre nga persona të tretë”.

- Siç edhe u nënvizua edhe më lart, puna e SPAK-ut është vlerësuar me nota mjaft pozitive në luftën kundër pastrimit të parave nga Grupit i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG)- Financial Action Task Force (FATF) ku në seancën plenare të datës 27 Tetor 2023, FATF miratoi vendimin për daljen e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si “lista gri”, duke veçuar kontributin e SPAK dhe rezultatet e SPAK për IO7 dhe IO8, si rezultate mjaft pozitive në luftën kundër pastrimit të parave, të cilat adresonin problematikat gjerësisht, si në drejtim të procedimeve penale dhe hetimeve pasurore në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale, sekuestrimeve e konfiskimeve për personat e hetuar dhe personat e tretë të lidhur me to.
- Duhet theksuar fakti që Prokuroria e Posaçme kryen hetim financiar dhe pasuror paralel për të gjitha kategoritë e veprave penale në kompetencë të saj dhe si rezultat i tyre ka pasur sukses në kërkesat dhe vendimet për sekuestrime dhe konfiskime, për të cilat janë evidentuar të dhënat respektive më lart.
- Ka një përmirësim të dukshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadrin e Eurojust, ku mund të nënvizohet se, Shqipëria nëpërmjet SPAK ka treguesit më të lartë në rajon në lidhje me formimin e skuadrave të përbashkëta hetimore me 32 Skuadra të Përbashkëta Hetimore në total të krijuara në vitet 2020-2023, në funksion të hetimeve të Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, ku 10 prej tyre janë krijuar në vitin 2023, nga 25 skuadra që janë aktive që prej fillimit krijimit të Prokurorisë së Posaçme.

- Një tjetër tregues pozitiv për rezultatet e punës së SPAK në rritjen e hetimeve financiare, pasurore, konfiskimeve dhe në intensifikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në drejtim të ndjekjes penale, por edhe në identifikimin si një institucion ligjzbatues serioz, rezulton nga deklarata e të ngarkuarit me punë pranë Ambasadës së SHBA, z. Wisner, në intervistën e tij në media në 11 dhjetor 2023, i cili nënvizoi se: *“SPAK-u ka një meritë të madhe për përpjekjet e tij. Prova është në rezultate. Ne po shohim më shumë dënime, më shumë sekuestrime, më shumë konfiskime, më shumë hetime dhe më shumë bashkëpunim ndërkombëtar për zbatimin e ligjit – që do të thotë se, SPAK po krijon reputacionin si një agjenci ligjzbatuese serioze dhe e besueshme me të cilin vendet e tjera mund të jenë partnerë në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe korrupsionit. Si rezultat, partnerët amerikanë dhe të tjerë ndërkombëtarë po e forcojnë bashkëpunimin me Shqipërinë”*.
- Është rritur ndjeshëm edhe komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe qoftë ato Evropiane, Amerikane, gjithashtu edhe me autoritetet homologe të vendeve të Amerikës Qendrore dhe të Amerikës së Jugut. Është rritur ndjeshëm shkëmbimi informacionit edhe nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit si Eurojust, Interpol, Europol etj. Vazhdon gjithashtu intensiv dhe në rritje komunikimi me oficerët ndërlidhës atashuar pranë Ambasadave të Huaja në Tiranë, i cili ndikon në forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- Gjatë vitit 2023, nga ana e Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta të Prokurorisë së Posaçme, janë trajtuar 48 kërkesa për ndihmë të ndërsjellët juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, në bazë të konventave të Këshillit të Europës dhe Konventave të Kombeve të Bashkuara, si dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare dhe dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë. Nga këto janë ekzekutuar 41 kërkesa për ndihmë juridike.
- Këto kërkesa janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë lidhur me hetime në kuadër të veprave penale kryesisht në fushën e korrupsionit, trafikimeve të lëndës narkotike, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, vjedhje, të kryera në formën e bashkëpunimit asaj të grupit të strukturuar kriminal.
- Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje ku më datë 29.06.2023, është nënshkruar Marrëveshja për bashkëpunim ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorit Publik Evropian.
- Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme bazuar në ligjin nr. 95/2016, *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*, të ndryshuar, në kushtet e ndryshimeve ligjore të bëra në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009 *“Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”*, të ndryshuar, ka vijuar punën në grupin e përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, për Hartimin e Udhëzimit të Përbashkët me këto institucione *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për formën e kërkesës, procedurën dhe përkatësinë e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”*.

- Në kuadër të zhvillimit të ndjekjes penale me fokus luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme ka ndërvepruar me agjenci të ndryshme shtetërore për akses në sistemin e të dhënave për qëllim të hetimeve, si:
 - Sistemi “ASYCUDA” nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
 - Sistemi “ISSH” nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
 - Sistemi C@ts nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - Sistemi i Fiskalizimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

6. Në lidhje me rekomandimin “*Vijimin e bashkëpunimit midis prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme për sa i përket ndarjes së kompetencës lëndore për vepra, me qëllim garantimin e efektivitetit dhe shpejtësisë në hetimin e çështjeve*”.

Në kuadër të ndjekjes penale në zbatim të ligjit dhe respektimin të ndarjes së kompetencës lëndore për veprat penale, gjatë vitit 2023 pranë Prokurorisë së Posaçme kanë ardhur me transferim nga prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, 44 procedime penale me 57 persona në hetim, nga të cilët 28 persona kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”, 6 persona kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg në mungesë”, 10 persona kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”, 9 persona ka qenë me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe 4 persona kanë qenë pa ndonjë masë sigurimi, për të cilat është vendosur pranimi dhe regjistrimi i tyre.

Nga 44 procedimet penale të regjistruara, 12 procedime me 33 persona në hetim janë regjistruar për vepra që lidhen me Krimin e Organizuar dhe 32 procedime me 24 persona në hetim për vepra që lidhen me Korrupsionin dhe vepra të tjera.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, është vendosur shpallja e moskompetencës dhe transferimi i çështjes pranë prokurorive me juridiksion të përgjithshëm për 87 çështje penale me 53 persona në hetim, nga të cilët 13 persona kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”, 1 person ka qenë me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”, 1 person ka qenë me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe 38 persona kanë qenë pa ndonjë masë sigurimi.

Sa ju përket çështjeve të transferuara, evidentohet fakti se, nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, në pjesën dërmuese të tyre janë kryer hetimet e plota, ku janë zbuluar dhe autorët përkatës, është proceduar me kalimin e tyre për kompetencë, për shkak se vepra penale e hetuar apo subjektet përkatës, nuk janë në kompetencën lëndore të kësaj prokurorie.

7. Në lidhje me rekomandimin “*Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave dhe pasurive të sekuestruara, për të siguruar tregues efektivë dhe të matshëm të punës së kryer në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për këto vepra penale*”.

Siç jemi shprehur edhe më lart, Prokuroria e Posaçme ka vijuar të ndjekë me përparësi ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, i cili do të mbështesë rrjedhën e punës së Prokurorëve dhe Hetuesve/OPGJ të BKH, zyrës së regjistrave dhe protokollit, duke mundësuar përmirësime të rëndësishme të punës së përditshme dhe mbi të gjitha, duke adresuar ndërveprimin konstant të punës së përditshme të Prokurorit, Hetuesve/OPGJ të BKH-së dhe regjistrimit të dokumenteve dhe elementeve të kësaj pune në regjistrat e ndryshëm, përmirësim të këtij ndërveprimi duke shmangur mbivendosjen e punës. Kjo mënyrë ndërveprimi nëpërmjet sistemit, do të garantojë nivelin e

nevojshëm të sigurisë dhe sekretit hetimor. Implementimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e punës së përditshme dhe rritjen e transparencës në trajtimin e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në fillim të muajit korrik 2024 do të fillojë faza pilotuese dhe testuese e sistemit, ndërsa brenda vitit pritet të përfundojë komplet sistemi së bashku me modulën e fundit, i cili është ai i raporteve dhe statistikave të cilat do të gjenerohen me të dhënat e sistemit deri në atë moment.

8. Në lidhje me rekomandimin “Vijimin e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe hetimeve pasurore veçanërisht me fokus në format e reja të nxitura nga zhvillimet teknologjike”.

- Për vitin 2023, përveç takimeve koordinuese në kuadër të skuadrave të përbashkëta nga prokurorët janë kryer 22 trajnime/vizita studimore, janë mbajtur 47 Takime/Konferenca/Forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dhe të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2023, 60 hetuesit e BKH-së kanë marrë pjesë në 47 trajnime brenda vendit dhe në 25 trajnime jashtë vendit, organizuar kryesisht nga ICITAP, OPDAT, FBI, ILEA-Budapest, CEPOL, EUROPOL, EU4FOCAL.
- Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimet për Hetimet Kriminale ICITAP, një program i cila ka si synim zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të zbatimit të ligjit, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjatë vitit 2023, ka mbështetur Byronë Kombëtare të Hetimit duke organizuar një sërë trajnimesh të specializuara për përmirësimin e kapaciteteve hetimore, si dhe ka mbështetur të gjithë strukturën e Prokurorisë së Posaçme, me mjete logjistike, pajisje elektronike, software, sisteme informatike etj.

SITUATA E KRIMINALITETIT

Në këtë seksion të raportit jepet një analizë e situatës së kriminalitetit në vend, ku jepen shpjegime mbi llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e aktiviteteve kriminale nën juridiksionin e SPAK. Cilësojmë se, analiza në këtë kapitull është e natyrës kriminologjike dhe ka si qëllim ofrimin e një panorame të krimit të organizuar dhe korrupsionit të zyrtarëve të lartë publik. Si e tillë, kjo analizë është mbështetur jo vetëm në provat e mbledhura në hetime, por dhe në indicet e ndryshme të cilat, paçka se nuk janë konsideruar prova, për qëllim të këtij seksioni, janë shfrytëzuar për të shpjeguar tendencat e figurës së disa prej veprave penale më të rënda të hetuara nga SPAK, gjatë vitit 2023.

KRIMI I ORGANIZUAR DHE TERRORIZMI


Veçoritë e përgjithshme të grupeve kriminale shqiptare

Nga analiza e hetimeve të kryera në vitin 2023, veçoritë më specifike të grupeve kriminale shqiptare janë një **anëtarësi** mesatare e pjesëtarëve të grupit prej 15-25 personash. Grupet kriminale shqiptare janë kryesisht **poli-kriminale**, ku përfshihen kryesisht trafiku i narkotikëve, vrasjet, rrëmbimet, mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit etj. **Dhuna**, e cila është një veçori në zbehje mbetet një karakteristikë tjetër e grupeve kriminale shqiptare. Kryesisht dhuna përdoret nga grupe me strukturë hierarkike, të cilat bazohen në lidhje gjaku dhe familjare, dhe të cilat janë në konflikt për kontroll territori ose konkurrencë për tregje kriminale. Grupet shqiptare të cilat e kanë këtë veçori, janë kryesisht grupe, të cilët kanë aktivitet të konsoliduar në një territor të caktuar, por të cilat kanë gjithashtu shtrirje dhe aktivitet kriminal edhe në tregjet kriminale ndërkombëtare. Në rastet e kryerjes së veprimtarisë në tregjet ndërkombëtare kriminale, grupet shqiptare **bashkëpunojnë edhe me grupe të tjera** për shërbime të cilat nuk mund të mbulohen prej tyre. Vërehet gjithashtu një bashkëpunim i grupeve kriminale edhe me **oficerët e policisë së shtetit të rangjeve të ndryshme në territorin shqiptar, si dhe funksionarë të organeve të drejtësisë**, të cilët kanë luajtur role të ndryshme, duke filluar që nga dekonspirimi i operacioneve policore, njoftimi për personat kundërshtar të vënë në shënjestër nga grupet kriminale, dhënie informacioni për individë të ndryshëm, dhe aktivitetet të tjera në pengimin e drejtësisë.

Një karakteristikë shqetësuese është dhe përfshirja e personave kyç në jetën komunitare, siç janë edhe **Kryetarët e Fshatrave** (kryepleqtë), të cilat janë përfshirë qoftë drejtpërdrejt në aktivitete kriminale ose në mënyrë indirekte duke shpërdoruar detyrën ose duke mos kallëzuar krimin. Shihet një tendencë në rritje e angazhimit të **femrave** në funksione të rëndësishme për grupet kriminale. Disa nga rolet më tipike të evidentuara në organizatat kriminale, të cilat merren me trafikun e narkotikëve, janë ato në administrimin e të ardhurave dhe mbikëqyrja e transferimit fizik dhe nëpërmjet institucioneve bankare të parave. Kryesisht femrat të cilat luajnë këto role, janë bashkëjetuese të krerëve të organizatës dhe konsiderohen si persona shumë të besueshëm të organizatës kriminale. **Format e sofistikuar të vrasjeve**, duke shmangur lënien e gjurmëve janë një tjetër karakteristikë e grupeve kriminale. Tashmë janë evidentuar grupe kriminale të specializuara në vrasjet me pagesë. Vihet re gjithashtu, përdorimi gjithnjë e më në rritje i **formave**

të koduara të komunikimit duke përdorur aplikacione të ndryshme dhe aparate telefonike të specializuara për të tilla komunikime. Kryerja e pagesave, si dhe konvertimi i parave në kriptovaluta është një tjetër veçori e cila është evidentuar gjatë vitit 2023. Duhet cilësuar se ky fenomen është vënë re më së shumti tek grupet kriminale, të cilat kanë kryer transaksione me anë të mashtrimit kompjuterik, nëpërmjet aktiviteteve tregtare të ashtuquajtura “call center”.

Veçoritë e përgjithshme të grupeve kriminale shqiptare




Grupet kriminale që veprojnë në Shqipëri

Struktura e këtyre grupeve varet kryesisht nga lloji i aktivitetit kriminal, kohëzgjatja, zona ku veprojnë dhe shtrirja e tyre në tregjet kriminale ndërkombëtare. Nga hetimet e vitit 2023, vihet re se disa nga grupet kriminale të njohura në vend, tashmë tregojnë sa kanë arritur të sofistikojnë veprimet e tyre, kjo dhe si rezultat i përplasjeve me grupet e tjera rivale. Këto grupe janë poli-kriminale dhe kanë shtrirje edhe në tregjet ndërkombëtare kriminale kryesisht në Amerikën e Jugut, Bashkimin Evropian (BE) dhe Britaninë e Madhe. Prezenca e tyre në Shqipëri, dhe ndikimi në zonat ku ato veprojnë në komunitet vijon të mbetet i konsiderueshëm. Struktura e këtyre grupeve kriminale është hierarkike me ndarje të qarta rolesh, dhe me një numër mesatar anëtarësh prej 10-15 personash. Lidhjet e tyre bazohen në lidhje familjare dhe shoqërore. Pjesa vendimmarrëse bazohet tek lidhjet familjare.

Siç u cilësua më lart, ajo që vihet re në disa raste janë edhe lidhjet e krijuara me përfaqësues të policisë së shtetit qoftë në nivel lokal, por dhe qendror, të cilët kanë ndihmuar grupet kriminale kryesisht në dhënien e informacioneve apo ndjekjen e lëvizjeve të kundërshtarëve të tyre. Një veçori tjetër, është edhe përfshirja e biznesmenëve të fuqishëm kryesisht në nivel lokal të cilët luajnë rolin e ndërmjetësit kyç, ku përveç marrëdhënieve tregtare, ju kanë ofruar këtyre grupeve lidhjet e tyre në policinë e shtetit, organet e drejtësisë dhe administratës publike, kryesisht në dhënien e informacioneve ose kontakteve me të tretët.


Tipologjia e një grupi të strukturuar kriminal



HARTA E TREGJEVE KRIMINALE

Analiza e tregjeve kriminale në Shqipëri tregon një realitet për tu shqetësuar. Nga hetimet e këtij viti, janë evidentuar grupe me aktivitet kriminal në Tiranë, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë, Fier, Shkodër, Elbasan, Kurbin dhe Fushë-Krujë. Në Tiranë dhe qytete të tjera bregdetare, grupet kriminale kryesisht janë të orientuara më shumë drejt pastrimit të parave. Trafiku i narkotikëve është një problem i dukshëm në rrethet e Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Fierit dhe Kurbinit. Në disa qytete si, Durrësi, Shkodra, Laçi dhe Fushë-Kruja, është evidentuar korrupsioni i funksionarëve të drejtësisë. Vrasjet dhe vrasjet e mbetura në tentativë janë vënë re më shumë në qytete si, Durrës, Fushë Krujë, Fier, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan. Këto vepra penale janë tregues i një tendence në rritje të dhunës dhe kriminalitetit në këto zona. Në zonën e Fushë-Krujës, evidentohen gjithashtu raste të blerjes së armëve dhe lëndëve shpërthyesë, por dhe makinave të vjedhura të cilat shërbejnë si mjete për kryerjen e vrasjeve.

Harta e tregjeve kriminale në Shqipëri



AKTIVITETET KRYESORE KRIMINALE

Trafiku i narkotikëve


Veprat penale në kuadër të trafikut të narkotikëve janë ndër aktivitetet kriminale më të përhapura tek grupet kriminale shqiptare. Nga analiza e këtij viti dallohen dy lloj kategorish grupesh kriminale, që ushtrojnë këtë aktivitet kriminal: 1) grupet kriminale të specializuar në trafikun e kokainës dhe 2) grupet kriminale të cilët merren me trafikun e të gjitha drogave kryesore (kokainë, heroinë, marijuanë dhe hashash).

- Grupet kriminale të cilat merren me trafikimin e të gjitha drogave kryesore:** këto grupe janë aktive në tregjet kriminale të Mbretërisë së Bashkuar dhe BE-së, kryesisht Itali, Belgjikë, Holandë, Spanjë, Greqi dhe Gjermani. Vihet re se, këto grupe kriminale kanë një prezencë ose lidhje të fortë në rrethin e Durrësit. Për shkak të portit më të madh në vend, qyteti i Durrësit ka qenë dhe vijon të mbetet një pikë tranziti për drogën, që vjen nga Ballkani Lindor dhe shkon drejt Italisë dhe vendeve të tjera të Evropës Perëndimore. Grupet kriminale të kësaj kategorie trafikojnë sasi të konsiderueshme kokaine dhe marijuane, por më pak sasi heroine. Ajo që duhet nënvizuar është se, cilësia e drogave të trafikuar nga këto grupe kriminale është e një cilësie të lartë, gjë e cila është edhe një avantazh konkurrues i tyre ndaj grupeve kriminale të kombësive të tjera. Duke u nisur nga mesatarja e anëtarësisë së grupeve kriminale shqiptare, këto grupe mund të kategorizohen si grupe me numër të lartë anëtarësh. Mesatarja e anëtarësisë së këtyre grupeve është mbi 20 persona. Këto grupe kriminale dallohen gjithashtu edhe për jetëgjatësinë e aktivitetit të tyre kriminal, i cili nga momenti i fillimit të aktivitetit kriminal deri në arrestimin e tyre mund të shkojë mesatarisht deri në 7 vite. Të tilla grupe kriminale operojnë me një strukturë gjysmë hierarkike, ku

drejtuesi i lejon anëtarëve me role kyçe të organizatës të kenë autonomi në vendimmarrjen brenda funksioneve dhe nën strukturave që ata drejtojnë. Kryesisht drejtuesi, përfaqëson dhe drejton organizatën, kurse anëtarët e tjerë kyç përfshihen në koordinim, transport, trafikim, rekrutim dhe korrupsion të zyrtarëve publik, për të pasur akses në pikat hyrëse dhe pritëse të sasive të narkotikëve dhe për të neutralizuar agjencitë ligjzbatuese. Nga ana tjetër, edhe grupe të tjera kriminale të cilat nuk përfshihen në trafikun e narkotikeve, siç është rasti i “call center” apo i trafikimit të mallrave të kontrabanduara, rezultojnë të jenë shumë të sofistikuara, madje, shumë më të avancuar në teknikat e fshehjes së aktivitetit të tyre kriminal, kjo për vetë natyrën e aktivitetit të tyre, i cili mbështetet në përdorimin e gjerë të teknologjisë.

- **Grupet kriminale të specializuara në trafikun e kokainës:** Grupet kriminale të kësaj kategorie janë kryesisht grupe të përqendruara në Amerikën e Jugut. Më pas, nëpërmjet lidhjeve me grupet kriminale shqiptare, të cilat janë aktive në tregjet kriminale të BE-së, Britanisë së Madhe dhe Ballkanit Perëndimor, në bazë të porosive, ose degëve të tyre në tregjet kriminale të mësipërme, marrin përsipër sigurimin dhe sjelljen e sasive të konsiderueshme të kokainës me shumicë dhe të një cilësie shumë të pastër. Disa nga portet hyrëse të kokainës në tregjet kriminale të BE-së, të cilat janë përdorur nga grupet kriminale shqiptare janë: Gioia Tauro (Itali), Rotterdam (Hollandë), Antwerp (Belgjikë), Algeciras (Spanjë), Pire (Greqi) dhe në rajon (Durrës dhe Tivar). Janë evidentuar edhe rrugë ajrore, siç është rasti i aeroportit të Frankfurtit në Gjermani. Më pas sasitë e kokainës përzihen kryesisht në Belgjikë, Holandë, Gjermani dhe në vendet ku trafikohen për t'u transferuar më pas në tregun e shitjes me pakicë.

Rrugët e trafikimit të kokainës nga Amerika e Jugut



Trafiku i armëve

Trafiku i armëve është një aktivitet tjetër kriminal, i cili shoqëron kryesisht grupet e përfshira në trafikun e narkotikëve dhe që karakterizohet nga përdorimi i lartë i dhunës. Përdorimi i eksplozivit vijon të mbetet një ndër mjetet e përdorura për vrasjet e porositura. Kohëve të fundit vihet re, një tendencë në rritje e grupeve kriminale, që veprojnë jashtë vendit të cilët po porosisin armë zjarri të llojit “pistoletë”. Vihet re gjithashtu, një tendencë e blerjes së lëndëve shpërthyesë në Kosovë.

Vrasjet me pagesë

Një veçori tjetër që spikat në lidhje me rritjen e sofistikimit të grupeve kriminale shqiptare është krijimi i grupeve të specializuara në vrasjet apo aktet e tjera kriminale të porositura nga të tretët. Këto grupe kriminale janë të fokusuara në disa vepra penale tipike si, vrasjet ose plagosjet me pagesë, ushtrim dhune, shkatërrim prone, grabitje me dhunë etj. Organizimi i tyre është në baza shoqërore dhe kryesisht anëtarët e këtyre grupeve kanë një të shkuar kriminale. Për shkak të ruajtjes së lartë të fshehtësisë së vrasjeve me pagesë dhe nevojës për veprime, të cilat kërkojnë zgjidhje momentale të shumta, këto grupe nuk kanë një strukturë hierarkike të qartë, pasi janë grupe të cilat veprojnë në qarqe të ngushta, me 4-7 anëtarë, ku njëri ose dy prej tyre mund të konsiderohen persona kyç. Këta të fundit marrin porositë dhe bëjnë planifikimin e kryerjes së akteve kriminale. Më pas ndahen detyrat dhe kryhen veprimet. Këto grupe janë poli-kriminale dhe përveç marrjes së porosive për vrasje, kryejnë aktivitete të tjera kriminale edhe për llogari të grupit të tyre kriminal. Ndër aktivitetet kriminale më të preferuara pas vrasjeve, janë vjedhjet dhe grabitjet me dhunë të sendeve me vlerë (metale të çmuara), si dhe grabitjet e zyrave të shkëmbimit valutor. Mjetet e krimit sigurohen në tregjet kriminale, p.sh. eksplozivët sigurohen në Kosovë, makina ose motorë të vjedhur, të cilët rezultojnë të tilla në qytete të ndryshme të vendit dhe armët e zjarrit blihen në tregun e zi (p.sh. në Fushë-Krujë, Durrës, Elbasan etj.). Komunikimet midis anëtarëve të grupit në lidhje me aktet kriminale kryhen nëpërmjet platformave të koduara si, SKY/ECC dhe Encrochat.


Kryerja e transaksioneve me anë të mashtrimit kompjuterik

Këto grupe kriminale operojnë nëpërmjet *call center* duke mashtruar shtetas të BE-së, duke i ftuar ata të investojnë në aksione nëpërmjet platformave online si p.sh. Brokerz, Globalix, Stoxmarket, etj. Ata pretendojnë se për të hyrë në zotërim të fitimeve të larta, klientët duhet të paguajnë taksa ose komisione sipas rregullave të Bankës Qendrore Evropiane. Përdorimi i aplikacioneve specifike si p.sh., "AnyDesk" u mundëson grupeve kriminale të kenë akses në kompjuterët e viktimave dhe të marrin kodet e sigurisë së bankave, duke u mundësuar qasje në llogaritë e tyre personale bankare. Një taktikë tjetër mashtrimi përfshin ftesën për të investuar në bursa ndërkombëtare, duke bërë depozita në llogari të bankave në vende të ndryshme të BE-së, duke i zhdukur më pas ato përmes transfertave ose konvertimit në kriptovalutë. Këto grupe kriminale janë mjaft të organizuara dhe përdorin teknologji të avancuar për të mbajtur të fshehtë identitetin e tyre dhe për të shpërndarë të ardhurat kriminale në forma të tjera investimi. Ata operojnë në nivel ndërkombëtar dhe përfitojnë shuma të konsiderueshme monetare duke i mashtruar shtetasit e BE-së dhe duke përfshirë në këto skema individë nga vende si, Shqipëria, Gjermania, Kosova, Franca, Italia, Spanja, dhe Greqia.

Pastrimi i parave

Pastrimi i parave vijon të mbetet një ndër krimet më të përhapura tek grupet kriminale shqiptare. Vihet re se, ka një rritje të përdorimit të shoqërive tregtare, të cilat shërbejnë për të marrë dhe transferuar paratë e fituara nëpërmjet veprimtarive kriminale, duke i shpërndarë ato nëpërmjet investimeve dhe transaksioneve tregtare të rregullta. Investimet në prona të luajtshme (mjete motorike, veshje luksi, ora të markave të shtrenjta, bizhuteri, pajisje kompjuterike etj.) dhe pasuri të paluajtshme mbeten ende ndër format më të preferuara të pastrimit të parave, kryesisht në apartamente, ndërtesa, truall, pemishte, njësi shërbimi etj. qoftë në qytetin e Tiranës, por dhe në zonat turistike bregdetare (Vlorë, Durrës dhe Lezhë). Vihet re dhe një numër i konsiderueshëm i depozitimit të parave, të cilat dyshohen se janë produkte të veprave penale në llogari të ndryshme bankare, që kryesisht janë në emra shoqërisht tregtare ose personave fizik, të afërm të të dyshuarve.

Format e Pastrimit të parave



Pastrimi i parave nga organizatat kriminale ndërkombëtare

Duhet cilësuar se, një nga skemat komplekse të pastrimit të parave është ajo e përdorimit të institucioneve shqiptare bankare, si vend tranziti dhe përdorimi i subjekteve tregtare shqiptare, si “ndërmjetëse” të pastrimit të parave nga organizatat kriminale ndërkombëtare, siç është rasti i mafias Italiane. Përfaqësuesit e bizneseve të ligjshme shqiptare në rolin e “ndërmjetësve” profesionistë kanë ndihmuar në krijimin e aksesit në sistemin bankar shqiptar, i cili do të përdorej për të kryer “shtresëzimin” e transfertave bankare për të kaluar ato më pas në vende të tjera. Rasti

me tipik është ai i një individi, i cili pastronte para për llogari të Cosa Nostra në Itali. Skema e pastrimit të parave konsistonte në kalimin e parave nga fondacioni i themeluar prej tij me qendër në Lihtenshtajn, por me llogari bankare të çelur në Zvicër. Paratë fillimisht u transferuan nga llogaria e fondacionit në llogarinë e tij personale, po në të njëjtën bankë në Zvicër. Prej aty, me lidhjet e krijuara me një shoqëri tregtare në Shqipëri, e cila luante rolin e “ndërmjetësuesit” profesionist, paratë do të vinin fillimisht në llogarinë e tij personale të çelur në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri. Me pas këto para do ti kalonin shoqërisë tregtare shqiptare, që merrej me tregtinë e karburanteve në formë huaje dhe kjo kompani do t’i transferonte në Hong Kong tek një shoqëri tjetër tregtare, që do të shërbente si “garantuese” për kryerjen e transaksioneve fiktive për blerje karburantesh. Për këtë shërbim shoqëria tregtare shqiptare do të përfitonte 16% (afërsisht 3 milion Euro) të vlerës së parave që do të pastroheshin.

Pastrimi i parave prej organizatave kriminale ndërkombëtare



TREGJET KRIMINALE NDËRKOMBËTARE

Amerika e Jugut

Siç edhe u citua më lart, grupet kriminale janë të pozicionuara në Amerikën e Jugut ku më pas, përmes lidhjeve me grupet kriminale shqiptare të aktivizuara në tregjet kriminale të BE-së, Britanisë së Madhe dhe Ballkanit Perëndimor, ato arrijnë të eksportojnë sasi të konsiderueshme të narkotikëve dhe të një cilësie të lartë për grupet shqiptare, por dhe ato të kombësive të tjera. Këto grupe kriminale kanë arritur të pozicionohen mjaft mirë në disa shtete të Amerikës së Jugut dhe me sukses po konkurrojnë edhe organizatat kriminale vendase. Vihet re se, grupet kriminale shqiptare, kanë arritur të korrtojnë dhe të kenë akses në nivele të larta qeverisëse, të korrtojnë segmente të agjencive ligjzbatuese dhe të krijojnë mekanizma mbrojtës efektiv.

Bashkimi Evropian

Grupet kriminale shqiptare janë mjaft aktive në tregjet e trafikut të narkotikëve në BE, kryesisht në trafikun e kokainës, heroinës, marijuanës dhe hashashit, por dhe në tregje të tjera kriminale si, në trafikimin e mallrave të kontrabanduar dhe kryerja e transaksioneve me anë të mashtrimit kompjuterik (call center).

Itali

Grupet kriminale shqiptare janë aktive thuajse në të gjitha rajonet e Italisë, dhe nga hetimet e kryera në bashkëpunim me agjensitë partnere, gjatë vitit 2023 janë evidentuar aktivitete kriminale, të cilat kryheshin në Puglia, Toskana, Lombardi, Piemonte dhe Friuli-Venecia Giulia.

Beneluks

Edhe gjatë vitit 2023, janë evidentuar aktivitete të grupeve kriminale shqiptare në Belgjikë dhe Holandë. Ajo që vihet re është se, këto grupe kanë lidhje ose janë zgjatues të grupeve kriminale shqiptare, të cilët janë rezident në Amerikën e Jugut dhe i përdorin portet e zonës së Beneluksit për të trafikuar më pas kokainën në BE dhe Britaninë e Madhe. Vihet re gjithashtu se, grupet kriminale shqiptare vijnë të jenë aktive edhe në rritjen e plantacioneve me kanabis, kryesisht në Belgjikë, në zonat Saint-Josse-Ten-Noode dhe Antwerp. Në Holandë, grupet kriminale shqiptare janë më aktive në Rotterdam, për shkak edhe të portit më të madh hyrës në Beneluks.

Francë

Sipas hetimeve të përfunduara në vitin 2023, u evidentua një grup kriminal shqiptar me një strukturë të organizuar dhe të sofistikuar, i cili operonte në territorin e Francës dhe Shqipërisë në trafikimin e mallrave të kontrabanduara dhe pastrimin e parave. Struktura e këtij grupi kriminal tregon se, edhe tregjet kriminale në Francë përbejnë interes për grupet kriminale shqiptare. Vihet re se, territori i shtetit francez është shfrytëzuar gjithashtu si një vend strehimi nga drejtues të organizatave kriminale të rëndësishme, të cilët i janë fshehur ndjekjes penale në Shqipëri.

Spanjë

Një vend tjetër i BE-së, ku grupet shqiptare kanë qënë aktive është edhe Spanja. Gjatë vitit 2023, janë evidentuar grupe shqiptare të përfshira kryesisht në trafikun e kanabisit dhe në fushën e kryerjes së transaksioneve me anë të mashtrimit kompjuterik. Spanja ka shërbyer gjithashtu, si një nga pikat kyçe të lëvizjes së kokainës nga Amerika e Jugut për në tregjet kriminale të BE-së. Kryesisht grupet shqiptare garantojnë sjelljen e sasive të kokainës nga Ekuadori në portet e Spanjës, (p.sh. portin e Algeciras), duke e fshehur atë në ngarkesa produktesh të ndryshme (p.sh. frutash ekzotikë, banane, peshk etj.). Spanja është një ndër vendet, ku gjithashtu, grupet kriminale shqiptare, në bashkëpunim edhe me grupe të tjera kriminale, po investojnë në pastrimin e produkteve kriminale.

Gjermani

Grupet kriminale shqiptare janë aktivë në trafikun e narkotikëve dhe kryesisht atë të kokainës. Nënvizohet se, një ndër portat hyrëse të sasisë të kokainës është dhe aeroporti i Frankfurtit. Gjermania përveç importit të kokainës dhe heroinës, vijon të shërbejë edhe si destinacion i

përzierjes së drogave të forta, të cilat trafikohen më pas në të gjithë BE-në. Vihet re gjithashtu se, ndër viktimat kryesore të aktivitetit kriminal të transaksioneve me anë të mashtrimit kompjuterik janë edhe shtetas gjerman.

Vendet skandinave

Një tendencë e rëndësishëm e shtrirjes së aktivitetit të grupeve kriminale shqiptare në BE, janë dhe vendet skandinave. Grupet kriminale shqiptare në këto vende janë poli-kriminale, por më shumë të fokusuara në trafikun e narkotikëve (kokainë dhe marijuanë) duke u vendosur në një prej këtyre shteteve, siç është Danimarka dhe duke e shtrirë aktivitetin e tyre më pas edhe në tregjet kriminale të Norvegjisë dhe Suedisë. Kryesisht, struktura drejtuese e grupeve që operojnë në këto tregje është hierarkike dhe bazohet në lidhjet familjare dhe shoqërore të cilët kanë funksione vendimmarrëse në organizatë dhe mbikëqyrin anëtarët e tjerë me role dytësore.

Britani e Madhe

Grupet kriminale shqiptare kanë një aktivitet të konsiderueshëm, kryesisht në fushën trafikut të kokainës dhe kanabisit në Britaninë e Madhe. Mendohet se, disa nga këto grupe kriminale mund të konsiderohen ndër ato grupe që kanë influencë shumë të rëndësishme në tregun e kokainës në këtë vend. Në vitet e fundit, grupet kriminale shqiptare janë përfshirë edhe në rritjen e kanabisit në të ashtuquajturat “shtëpitë e barit”, ku bëjnë pjesë një numër i konsiderueshëm të rinjsh. Ajo që është vënë re, nga rastet që ka ndjekur Prokuroria e Posaçme, është rritja e përdorimit të dhunës së grupeve kriminale të përfshirë në rritjen e kanabisit, qoftë në rastin e grabitjeve, por dhe në atë të larjes së hesapeve.


Lindje e Mesme

Vihet re, një prirje e grupeve kriminale shqiptare në zgjerimin e hartës së tyre të tregjeve kriminale edhe në Lindjen e Mesme. Kështu, në të paktën një rast, hetimet treguan se grupi kriminal shqiptar kishte siguruar “kokainë”, “heroinë”, “marijuanë” dhe “risinë”, në **Siri, Turqi** dhe vende të tjera të Lindjes së Mesme, për ti trafikuar ato më pas drejt Shqipërisë dhe nga Shqipëria drejt Maqedonisë së Veriut, Greqisë, Italisë e vendeve të tjera të BE-së.

Rajoni

Grupet kriminale shqiptare po përdorin disa porte si pika kyçe hyrëse të kokainës, e cila vjen nga Amerika Latine për të hyrë në rajon dhe për t’u transportuar më pas në BE. Në hetimet e vitit 2023 është evidentuar se, kokaina vjen me kontenier e fshehur në ngarkesa të ndryshme si p.sh. “pleh organik”, e cila transportohet nga Kolumbia nëpërmjet Portit të Pireut, në Greqi, në drejtim të Portit të Tivarit, në Malin e Zi. Ngarkesat futen në Shqipëri nëpërmjet transportit në rrugë tokësore , për t’u marrë më pas nga personat e specializuar të transportit dhe magazinimit të kokainës, për të bërë ekstraktimin e saj, duke ruajtur pastërtinë maksimale. Vihet re se, Porti i Durrësit po përdoret edhe nga grupe kriminale të Maqedonisë së Veriut për trafikimin e sasive të konsiderueshme të kokainës në Itali dhe më pas në shtete të tjera të BE-së. Zhvillimi i linjave të reja të kokainës nëpërmjet Shqipërisë nga grupet kriminale të Maqedonisë së Veriut tregon se, për këtë trafik po përdoren linja që dikur njiheshin si rrugët e trafikut të heroinës.

Tregjet kriminale ndërkombëtare



TERRORIZMI

Duhet cilësuar se, një nga format më të sofistikuar të terrorizmit është evidentuar në vitin 2019. Në këtë tipologji të kryerjes së akteve terroriste janë përfshirë shërbime sekrete të vendeve jo miqësore me Shqipërinë, të cilët kanë rekrutuar një shtetas të tyre rezident në Shqipëri për të kryer një akt terrorist ndaj një komuniteti të mbrojtur nga shteti shqiptar. Ka pasur tendenca të lidhjes midis shërbimeve sekrete, terrorizimit dhe krimit të organizuar. Në vitet e fundit mund të cilësohet se, terrorizmi është ndër aktivitetet kriminale më të rralla, ku gjatë vitit 2023 janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 3 procedime penale. Nga rastet e përfunduara në vitin 2023 janë evidentuar individë, të cilët përdornin rrjetet sociale për të treguar përkrahje të doktrinës së “ISIS” dhe përkrahje për aktet e dhunshme të kryera prej tyre. Këta individë kanë publikuar gjithashtu, shkrime me nxitje e thirrje publike për kryerjen e veprave me qëllim terroriste kundër institucioneve të rëndësishme shtetërore në Shqipëri.

KORRUPSIONI

Nisur nga një vështrim i përgjithshëm i formave të ndryshme të korrupsionit të hetuara nga SPAK gjatë vitit 2023, vërehet se, në kryerjen e veprave penale në kuadër të korrupsionit, subjektet kryejnë veprime të ligjshme në dukje, por të cilat si qëllim kryesor kanë përfitimin e paligjshëm. Veprimet korruptive ndjekin procedura, të cilat thjesht legalizojnë veprimet e përfituesve të fondeve, apo shërbimeve publike, në këmbim të përfitimit të paligjshëm, me qëllim, “institucionalizimin” ose formalizimin e një veprimi korruptiv. Në shumicën e rasteve ky lloj “institucionalizimi”, sidomos kur kemi të bëjmë p.sh. me keqpërdorimin e fondeve publike, është në formë të organizuar dhe i shoqëruar me veprime juridike, të cilat synojnë mbulimin e natyrës së vërtetë të veprimit kriminal. Vihet re, përdorimi gjithnjë e më në rritje i personave juridik, të cilët janë përfitues të këtyre fondeve publike. Këta të fundit bëjnë ndërrime të shpeshta aksionerësh të shoqërive tregtare, apo ndërrim të emrave tregtar të personave juridik, copëzim të transaksioneve, ku jo rrallë herë, këto veprime kryen në llogari të cilat janë regjistruar jashtë vendit

ose në juridiksione “off shore”. Disa nga veprat penale ku tipologjia e kryerjes së tyre del më e qartë janë:

Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike

Vihet re se, në skemën e kësaj vepre penale, kryesisht në ato fonde që lidhen me pushtetin lokal, fituesi është i paracaktuar. Përfituesi kryesisht është një person juridik, administratori i së cilit mund të jetë i afërm i një prej anëtarëve të strukturave të cilat kanë role vendimmarrës në shpalljen e fituesit, duke filluar nga Autoriteti Kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Njësia e Prokurimit Publik apo Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Funksonari i lartë publik, si organizator të skemës korruptive, cakton një të besuar, të cilin e ka emëruar në një post të lartë drejtues në institucionin publik që ai drejton, p.sh., në rolin e “Drejtorit të Ndërmarrjes Publike”. Ky i fundit, për aq sa e lejon kompetenca dhe funksioni, ndan detyrat, ndjek të gjitha veprimet formale dhe jo formale në emër, dhe për llogari të drejtuesit të lartë. Veprimet korruptive mund të nisnin që në fazën fillestare, pra të çeljes së fondit nga autoritetet kontraktore për projektin në fjalë, dhe për të vijuar më pas me akte dhe vendime, të cilat ndiqen nga titullari i autoritetit kontraktor, qoftë në ndryshime plani dhe limiti në buxhetin e institucionit publik, apo në ndikimin e emërimeve të anëtarëve të Njësies së Prokurimit Publik dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Një veçori tjetër që evidentohet gjithashtu, është edhe falsifikimi i dokumentacioneve shoqëruese të të gjithë procesit, që nga çelja deri në ndjekjen e zbatimit të tij.

Veprimet e sofistikuar sipas modelit konçensionar/partneritet publik privat


Vihet re, një sofistikim i kësaj vepre penale kryesisht kur kemi të bëjmë me projekte të rëndësishme publike, të kontraktuara sipas modelit konçensionar/partneritet publik privat. Veprimet karakterizohen nga shkelje të rënda ligjore të detyrimeve, që organet shtetërore kanë për veprimet përgatitore për dhënien e konçensionit, ku përfshihen mospërgatitja në përputhje me ligjin e studimit të plotë të fizibilitetit të konçensionit, mospërlllogaritja e vlerës së kontratës së konçensionit, mospërgatitja e dokumenteve të tenderit lidhur me zhvillimin e procedurës, moskryerja e veprimeve plotësuese të kërkuara nga ministrinë e tjera sipas ligjit, moszbatimi i llojit të duhur të procedurës sipas ligjit, etj. Vihen re, ndërhyrje të drejtpërdrejta të funksionarëve të lartë publik, të cilët negociojnë paraprakisht, qoftë pa u shpallur procedura e tenderit/konçensionit me subjektin juridik, i cili më pas do të shpallet fitues. Këto ndërhyrje vijnë edhe në hapat kyç të procedurave të tenderit, si dhe në ndikimin tek institucionet e tjera zyrtare, në kapërcim të kompetencave që i jep ligji, duke e kthyer garën për fitimin e tenderit në një konkurrim fiktiv. Nga ana tjetër, shihet se shoqëritë konçensionare janë ato të cilat në “hije” dirigjojnë të gjithë procesin duke përgatitur, jo vetëm dokumentet që ju takojnë atyre sipas ligjit, por dhe ato të cilat duhet të përgatiten nga institucionet zyrtare. Skema fiktive për kryerjen e punimeve në shoqërinë konçensionare, kryhet duke përdorur shoqëritë tregtare, të cilat kontrollohen në mënyrë të tërthortë nga funksionarë të lartë shtetëror, për të mbuluar natyrën e vërtetë të skemës korruptive të përfitimeve të këtyre fondeve publike në mënyrë të paligjshme.

Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë

Karakteristikat e vërejtura tek kjo vepër penale nuk lidhen më së shumti me formën e transaksionit (përfitime të parregullta), por me përfshirjen edhe të funksionareve të tjerë publik apo personave

juridik, të cilët luajnë role ndërmjetëse midis dhënësit dhe marrësit. Kryesisht, si ndërmjetës është një funksionar tjetër publik, i cili ka të dhëna mbi kriteret e fondit publik të çelur. Ky i fundit ndërmjetëson me personin juridik fitues të tenderit publik. Të gjithë personat e përfshirë si ndërmjetës veprojnë së pari, për të mbuluar natyrën e vërtetë të veprimit të paligjshëm, dhe së dyti, për përfitim material, por dhe përfitim në formë dhënie aksesi të paligjshëm në fonde të tjera publike.

Skema e korrupsionit të funksionarit të lartë shtetëror



Korrupsioni pasiv i funksionarëve të drejtësisë

Korrupsioni i funksionarëve të drejtësisë në përgjithësi nuk ka rezultuar të jetë shumë i komplikuar. Format më tipike janë, kontaktet që të interesuarit ndjekin për t'u lidhur me funksionarët e drejtësisë, nëpërmjet lidhjeve shoqërore, pra, nëpërmjet të tretëve, për të shmangur lidhjet shkakësore direkte. Më pas secili funksionar keqpërdor pushtetin e tij, për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në dhënien e drejtësisë.

Pastrimi i parave

Ajo që vihet re është se skema e pastrimit të parave është mjaft komplekse, pasi, në rastin e shkeljes së barazisë së tenderëve publik, ka si qëllim, jo vetëm të krijojë një skemë fiktive midis funksionarëve të lartë publik për fshehjen e akteve korruptive, por, mbi të gjitha, ajo shërben edhe si një skemë pastrimi e produkteve të veprave penale. Kështu, funksionari publik fillimisht bie dakord me personat juridik të ndryshëm, të cilët do të përfshihen në skemë për të realizuar anën formale dhe për të përfituar fondet publike në kundërshtim me ligjin. Më pas, këto fonde kalojnë në formë pagesash tek shoqëritë tregtare, të cilat kanë lidhje me funksionarin e lartë publik dhe personat e tjerë të përfshirë në këtë skemë korruptive. Këto fonde, nga llogaritë e kompanive, më

pas transferohen në llogari të tjera brenda dhe jashtë vendit duke u investuar në pasuri të tundshme ose të patundshme. Tendenca është që, paraqitja e skemës së pastrimit të parave të organizohet e atillë që, shumësia e veprimeve ligjore dhe transaksioneve financiare që kryejnë personat juridik përfitues të këtyre fondeve, të duken si veprime të ligjshme. Këto veprime financiare copëzohen në dhjetëra transaksione në formë kryerjesh pagesash tek kompanitë, të cilat nënkontrahohen për të kryer punime të ndryshme sipas specialitetit të tyre. Në fakt, në disa raste, kompanitë e nënkontraktuara janë pjesë e të njëjtës skemë dhe kontrollohen nga të njëjtët individ, që kanë organizuar këtë skemë korruptive. Kompanitë nënkontraktuese themelohen dhe drejtohen nga persona, që janë të afërm ose persona të besuar të atyre që i drejtojnë këto skema korruptive. Pasi fondet kalojnë në kompanitë nënkontraktore, ato transferohen jashtë vendit ose investohen në pasuri të tjera nën emra fiktiv, por, të cilat shfrytëzohen nga zyrtarët e korruptuar, ose të afërm të tyre.

Skema e pastrimit të parave




ANALIZA KRAHASIMORE E EFEKTIVITETIT

Në këtë pjesë të raportit do të zhvillohet një analizë krahasimore e veprimitarisë së Prokurorisë së Posaçme, duke u fokusuar në qasjen proaktive të institucionit, efektivitetin në hetim dhe gjykim të çështjeve, si dhe volumi i punës në hetimin e pastrimit të produkteve të veprave penale.

MASAT E SIGURIMIT PËR PERSONAT E REGJISTRUAR

Veprat penale të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit	Viti		
	2021	2022	2023
Llojet e masave			
Masë Sigurimi Arrest me Burg	127	189	184
Masë Sigurimi ne Mungesë	0	22	28
Masë Sigurimi Arrest Shtëpie	31	37	51
Masë Sigurimi Detyrim paraqitje	8	15	41
Masë Sigurimi Ndalim dalje jashtë vendit	1	1	1
Masë Sigurimi Pezullim ushtrim detyre	3	4	1
Pa masë sigurimi	134	159	73
Total	304	427	379

Masat e sigurimit përgjatë vitit 2023




Lidhur me politikën penale të ndjekur nga Prokuroria e Posaçme, në lidhje me llojin e kërkesave të masave të sigurimit, rezulton se, institucioni ka ndjekur të njëjtin trend në aplikimin e të gjitha llojeve të këtyre masave. Për sa i përket masës “arrest me burg”, vihet re, një tendencë në rënie, ku në krahasim me vitin 2022, rezulton se, kërkesa për këtë masë për të gjitha veprat penale në total është ulur me 3%. Nga ana tjetër, masa “arrest me burg” zë rreth 49% të totalit të hetimeve në të cilat është kërkuar masë sigurie dhe për ato të cilat nuk është kërkuar masë sigurimi.

EFEKTIVITETIT NË HETIM

Çështje të reja	2021	2022	2023
	Çështje	Çështje	Çështje
Procedime penale të reja të regjistruara	363	257	299
Çështjet/hetime të përfunduara	226	196	193

Procedimet e regjistruara kundrejt procedimeve të përfunduara 2021-2023




Përgjatë periudhës kohore 2021-2023, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar një numër relativisht të lartë të procedimeve penale të reja me një tendencë në rritje. Nga viti 2023 dallohet një rritje në masën 16% në krahasim me vitin paraardhës. Në lidhje me numrin e përfundimit të çështjeve, ka një ulje vetëm në masën prej 2% në krahasim me vitin 2022, e cila mund të konsiderohet e moderuar kur merret parasysh niveli i lartë i sofistikimit të çështjeve, të cilat janë hetuar gjatë vitit 2023.

Volumi i punës në mbylljen e hetimeve

Çështje/hetime të përfunduara	2021	2022	2023
Kërkesa për pushim	37	38	29
Vendim pezullimi	34	19	24
Transferim	107	82	87
Kërkesa për gjykim	48	57	53

Çështjet e përfunduara për vitin 2023



Në lidhje me çështjet/hetimet e përfunduara, Prokuroria e Posaçme, ka një trendencë në zbritje në numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë me kërkesë për pushim, dhe ka tendencë në rritje në numrin e çështjeve të cilat janë pezulluar, transferuar dhe çështjeve të dërguara në gjykatë me kërkesë për gjykim. Duhet cilësuar se, peshën kryesore në numrin e çështjeve/hetimeve të përfunduar e zënë çështjet, të cilat janë çuar për “transferim” në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm me 45% dhe çështjet të cilat janë çuar në gjykatë me 27%, kundrejt totalit. Sa i përket çështjeve të transferuara, përqindja e tyre e lartë lidhet me faktin se, nga prokurorët e posaçëm, në pjesën më të madhe të rasteve, janë kryer hetime ku janë zbuluar autorët e veprave penale përkatëse, por, janë transferuar për kompetence në organet kompetente pasi, vepra penale, apo subjekti i hetuar, nuk ka qenë kompetencë lëndore e kësaj prokurorie.

EFEKTIVITETI NË GJYKIM

Vendimet e dënimit	2021	2022	2023
	çështje	çështje	çështje
Vendim fajësie në GJKKO	75	47	72
Vendim fajësie në GJAKKO	41	37	57
Rekurse të shqyrtuara nga Kolegji i Posaçëm i Gjykatës së Lartë	0	29	41
Vendime pafajësie dhënë nga GJKKO	2	3	8

Vendimet e dënimit



Duhet cilësuar se, volumi i punës në gjykim i Prokurorisë së Posaçme ka qenë mjaft i lartë në lidhje me dhënien e vendimeve të fajësisë. Në mënyrë më konkrete, vendimet e fajësisë në shkallën e parë në GJKKO, kanë pësuar një rritje prej 53% krahasuar me vitin 2022.

Vendimet e fajësisë në GJAKKO, gjithashtu kanë pësuar një rritje prej 54% krahasuar me vitin 2022.


Për sa i përket rekurseve të shqyrtuara nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vërehet një rritje prej 41%.

Për vendimet e pafajësisë nga ana tjetër, rezulton se ka një rritje prej 167% të vendimeve të pafajësisë krahasuar me vitin 2022. Duhet cilësuar se, nga pafajësitë e dhëna nga GJKKO nga 8 çështje në total me 99 persona të gjykuar është vendosur pafajsi e plotë për vetëm 2 çështje me 13 persona të pandehur, ndërsa për 6 çështje të tjera ka vendime fajësie për 72 persona dhe vendim pafajësie për 14 të tjerë.

Vendime Fajësie/Vendime Pafajësie

Çështje	2021	2022	2023
Vendim fajësie në GJKKO	75	47	72
Vendime pafajësie dhënë nga GJKKO	2	3	8

Çështje me vendim fajësie/vendim pafajësie





Volumi i hetimit të korrupsionit

Vepra penale/neni	2022		2023	
Korrupsioni / Veprat e tjera penale (të reja të regjistruara)	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara
Numri	178	160	214	150

Krahasimi i çështjeve/hetimeve të regjistruara kundrejt atyre të përfunduara në kuadër të Korrupsionit

2022 - 2023



Krahasimisht gjatë vitit 2023, për veprat penale të hetuara në kuadër të korrupsionit, për çështjet e regjistruara evidentohet një rritje prej 20% kundrejt vitit 2022.



Ndërsa lidhur me çështjet e përfunduara, në krahasim me vitin 2022, gjatë vitit 2023 ka pasur një ulje të moderuar në masën 6%.

Volumi i hetimit të krimit të organizuar

Vepra penale/neni	2022		2023	
	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara
Krimi Organizuar	79	36	85	43

Krahasimi i çështjeve/hetimeve të regjistruara kundrejt atyre të përfunduara në kuadër të Krimit të Organizuar

2022 - 2023




Krahasimisht gjatë vitit 2023, për veprat penale të hetuara në kuadër të Krimit të Organizuar, për çështjet e regjistruara evidentohet një rritje në masën 8% kundrejt vitit 2022.

Ndërsa lidhur me çështjet e përfunduara, në krahasim me vitin 2022, gjatë vitit 2023 ka pasur një rritje prej 19% gjatë vitit 2023.

Volumi i hetimit të pastrimit të parave

Neni 287 KP	Viti		
	2021	2022	2023
Procedime të regjistruara në kuadër të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"	15	20	35

Procedime të regjistruara në hetimin e pastrimit të parave




Për sa i përket procedimeve të regjistruara në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave, përgjatë viteve 2021 - 2023 ka pasur një rritje të konsiderueshme, ku konkretisht numri i këtyre çështjeve është rritur me 75% në krahasim me vitin 2022.


SEKUESTRIMI DHE KONFISKIMI I PRODUKTEVE TË VEPRAVE PENALE

Akte Ligjore	2021		2022		2023	
	Sekuestrime	Konfiskime	Sekuestrime	Konfiskime	Sekuestrime	Konfiskime
Ligji Anti Mafia	14	4	5	10	8	5
Kodi Penal	5	4	7	20	8	20
Akt Normativ (OFL)	28	54	0	32	0	14
Total	47	62	12	62	16	39

Evidenca e sekuestrimeve dhe konfiskimeve



Kurba rritjes/uljes së masës së sekuestrimeve në kuadër të akteve ligjore 2021-2023




Lidhur me sekuestrimet në kuadër të ligjit Anti-Mafia, gjatë vitit 2023, në krahasim me vitin 2022, vërehet një rritje prej 60% ndërsa në kuadër të sekuestrimeve në bazë të Kodit Penal evidentohet

një rritje prej 14%. Në vijim, gjatë vitit 2022 dhe vitit 2023 nuk ka pasur sekuestrime në kuadër të Aktit Normativ (OFL), ndryshe nga viti 2021 ku janë regjistruar 28 sekuestrime.

Aktet Ligjore	Konfiskime	Konfiskime	Konfiskime
	2021	2022	2023
Ligji Anti Mafia	4	10	5
Kodi Penal	4	20	20
Akt Normativ (OFL)	54	32	14
Total	62	62	39

Kurba rritjes/uljes së masës së konfiskimeve në kuadër të akteve ligjore

2021-2023




Lidhur me konfiskimet në kuadër të ligjit Anti-Mafia, gjatë vitit 2023, në krahasim me vitin 2022, vërehet një ulje prej 50%, ndërsa në kuadër të konfiskimeve në bazë të Kodit Penal nuk evidentohet rritje. Në vijim, gjatë vitit 2023 konfiskimet në kuadër të Aktit Normativ (OFL), kanë pësuar ulje në masën 56% në krahasim me vitin 2022.

Vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara

Akte Ligjore	2023			
	Sekuestrime		Konfiskime	
	Në monedhën Lekë	Në monedhën Euro	Në monedhën Lekë	Në monedhën Euro
Ligji Anti Mafia	275,553,016	-	64,341,850	
Kodi Penal	1,711,258,000	-	5,800,000	18,350,000
Akt Normativ (OFL)	-	-	370,718,221	
Totali	1,986,811,016	-	440,860,071	18,350,000


Konfiskime/Sekuestrime	Vlera në Euro
Konfiskime	22,570,776
Sekuestrime	19,021,647
Total	41,592,423

Raporti i vlerave të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara gjatë vitit 2023



Evidentohet se, në vlerën totale të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, vlerën më të lartë e zënë ato të proceduara sipas procedimit penal (Kodi Penal), dhe konkretisht në masën 84%, duke u ndjekur më pas, nga vlera e pasurive të proceduara sipas Aktit Normativ në masën 9%, dhe nga Ligji Anti Mafia në masën 8%.


Raporti midis masës së konfiskimeve dhe sekuestrimeve



Nënvizohet se, vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara së bashku për vitin 2023, përlloraget në vlerën prej rreth 41 milion Euro. Nga totali, peshën më të madhe prej 54% e zënë pasuritë e konfiskuara, të cilat përlloragiten në vlerën 22.5 milion Euro (440 milionë lekë + 18 milionë Euro), ndërsa pasuritë e sekuestruara zënë 46% në vlerën 1.9 miliard lekë (19 milion euro) të vlerës totale.

QASJA PROAKTIVE


Qasja Proaktive	2021	2022	2023
Procedime penale kryesisht	18	28	67
Pajisje fundore për procedime penale kryesisht	125	176	336
Numri i Kërkesa për Ndhimë Juridike për Jashtë Vendit	51	62	121
Skuadrat e Përbashkëta Hetimore	5	10	10



Duhet cilësuar se, Prokuroria e Posaçme, ka pasur një tendencë rritëse në qasjen proaktive të hetimeve, e cila reflektohet në disa tregues të rëndësishëm si, numri i hetimeve të nisura kryesisht, interceptimi i pajisjeve fundore, numri i kërkesave për ndihme juridike të dërguara agjencive ligjzbatuese jashtë vendit dhe numri i ngritjes së skuadrave të përbashkëta hetimore. Krahasimisht me vitin 2022, ka një rritje të hetimeve të nisura kryesisht prej 139%, ndërkohë që ka një rritje prej 91% të interceptimit të pajisjeve fundore, ka një rritje me 95% të kërkesave për ndihmë juridike për jashtë vendit, ndërkohë që numri i ngritjes së Skuadrave të Përbashkëta Hetimore ka qëndruar i njëjtë për vitin 2023.

Kallëzime dhe referime nga individë dhe institucione


Hetime	2021	2022	2023	Total
Hetime të filluara me kallëzime nga policia e shtetit	68	44	65	177
Hetime të filluara me kallëzime nga institucionet publike	19	20	12	51
Hetime të filluara me kallëzime nga subjekte politike	57	10	23	90
Hetime të filluara me kallëzime nga shtetas	42	28	36	106
Hetime të filluara me kallëzime nga persona juridik	23	15	9	47



Për sa i përket hetimeve të filluara nga kallëzimet e kryera nga institucionet publike dhe të tretët, rezulton se, peshën më të madhe përgjatë vitit 2023 e mbajnë ato të filluara me kallëzime nga Policia e Shtetit në masën 45%. Ndërkohë, numrin më të lartë të kallëzimeve e zënë ato të kryera nga shtetasit në masën 25%, të ndjekur më pas nga subjektet politike, të cilat zënë masën prej 16%.

Hetime	2021	2022	2023
Hetime të filluara me kallëzime nga institucionet publike	19	20	12

Hetime të filluara me kallëzime nga institucionet publike



Duhet theksuar se, numri i kallëzimeve të bëra nga institucionet publike është mjaft i ulët dhe me një tendencë të ndjeshme në rënie me 40% krahasuar me vitin 2022.

ANALIZA E VOLUMIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË POSAÇME PËR VITIN 2023

VOLUMI I PUNËS NË HETIM

Në Prokurorinë e Posaçme për periudhën e vitit 2023 janë hetuar gjithsej 750 procedime penale, nga të cilat 451 procedime penale janë mbartur nga viti 2022, ndërsa 299 procedime penale janë regjistruar gjatë vitit 2023 si procedime penale të reja.

Nga numri total i procedimeve penale të hetuara prej 750, për 42 procedime penale është vendosur bashkimi ityre me procedime të tjera, .Pas bashkimit të procedimeve penale, numri total i çështjeve të hetuara nga Prokuroria e Posaçme për vitin 2023 është gjithsej 708 procedime penale me 575 persona nën hetim.

Nga 299 procedime penale të reja të regjistruara për vitin 2023, 44 procedime penale kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, 67 procedime janë të regjistruara kryesisht. Ndërkohë, janë filluar mbi bazën e referimeve penale të shërbimeve të policisë gjyqësore, të kallëzimeve penale të institucioneve të ndryshme vendase dhe autoriteteve të huaja, enteve private, si dhe të shtetasve rreth 188 procedime penale.

Nga 67 procedime penale të regjistruara kryesisht me 23 persona në hetim, 4 procedime janë bashkuar me procedimet e tjera.

Nga ana tjetër, në vitin 2023 janë regjistruar gjithsej 273 kallëzime/referime penale nga të cilat, për 113 kallëzime/referime penale është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për 9 kallëzime është vendosur dërgimi për kompetencë i kallëzimit penal në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore/Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe për 151 kallëzime/referime penale është vendosur të regjistrohen si procedime penale.

Në lidhje me vendimet e mosfillimit të procedimit penal është paraqitur ankim në gjykatë për 29 raste, nga të cilat për 3 vendime është vendosur lënia në fuqi, për 17 vendime mosfillimi vazhdon gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, si dhe për 9 vendime mosfillimi vazhdon gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Apelit.

Nga 708 procedime penale me 575 persona nën hetim, rezulton se, gjatë vitit 2023 kanë përfunduar hetimet për 193 procedime penale me 364 persona nën hetim/të pandehur, ku për 53 procedime me 296 të pandehur është paraqitur kërkesë për gjykim, për 29 procedime penale me 15 persona në hetim është paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes, 87 procedime penale me 53 persona në hetim janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore/Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe për 24 procedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve. Ndërsa 515 procedime penale me 211 persona në hetim janë mbartur për vitin 2024.

Në lidhje me **kërkesat për gjykim**, rezulton të jenë dërguar në gjykatë 53 kërkesa për gjykim me 296 të pandehur nga të cilat 11 kërkesa për gjykim me 109 të pandehur për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, 38 kërkesa për gjykim me 142 të pandehur për vepra penale të lidhen me korrupsionin, dhe për 4 kërkesa për gjykim me 45 të pandehur për vepra penale të tjera,

Në 29 procedimet penale për të cilët është paraqitur **kërkesë për pushimin** e çështjes, kanë qenë nën hetim 15 persona, nga të cilët 3 kërkesa për pushim me 9 persona nën hetim për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, 26 kërkesa për pushim me 4 persona nën hetim për vepra penale të lidhen me korrupsionin, dhe për 2 persona nën hetim është vendosur pushim hetimi për vepra penale të tjera.

Në 87 **procedimet penale që janë transferuar** në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore/Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm kanë qenë 53 persona nën hetim, 10 procedime penale me 4 persona nën hetim për vepra në fushën e krimit të organizuar, për 62 procedime penale me 10 persona nën hetim për vepra në fushën e korrupsionit, për 15 procedime penale me 39 persona nën hetim për vepra penale të tjera.

Në lidhje me **pezullimin e hetimeve** rezulton se, për 24 procedimet penale është vendosur pezullimi i hetimeve, nga të cilat rezulton se, kemi 19 procedime të pezulluara për veprat penale në kuadrin e krimit të organizuar, 2 procedime të pezulluara për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe kemi 3 procedime të pezulluara për vepra penale të tjera.

Nga numri prej 575 persona nën hetim, 457 prej tyre janë hetuar me **masë sigurimi**, ndërsa 118 persona nën hetim janë hetuar në **gjendje të lirë**.

322 persona nën hetim janë hetuar me **masë sigurimi**, “arrest me burg”, nga të cilët, 266 masa janë ekzekutuar, ndërsa për 56 persona është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg” në mungesë.

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është kërkuar për 61 persona nën hetim, ndërsa 71 persona nën hetim janë hetuar me masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, 2 persona me masën e sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, 1 person me masën e sigurimit “pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”.

Për vitin 2024 **janë mbartur** në hetim 515 procedime penale me 211 persona në hetim.

Nga 515 procedime penale të mbartura për vitin 2024, 158 procedime penale janë të regjistruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar me 146 persona nën hetim, nga të cilët 95 prej tyre hetohen me masën e sigurimit “arrest në burg” dhe 319 procedime penale me 56 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të korrupsionit. Ndërsa, 38 procedime penale me 9 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të tjera.

Nga 211 persona nën hetim në procedimet penale të mbartura, 113 persona nën hetim janë duke u hetuar me masën e sigurimit “arrest në burg”, 29 persona me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, 24 persona me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, 1 person me masën e sigurimit “pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik” dhe 13 persona në gjendje të lirë pa ndonjë masë sigurimi.

Të dhëna statistikore për veprat penale në fushën e ligjit të dekriminalizimit

Prokuroria e Posaçme me datë 03.05.2023 ka regjistruar procedimin penal me Nr. 80 për 1 person nën hetim i akuzuar për veprën penale “*Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve*”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal. Me datë 18.12.2023, çështja është dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, dhe aktualisht vazhdon gjykimi në GJKKO.

Vendimet e përfundimit të gjyqimit për vitin 2023 në fushën e ligjit të dekriminalizimit

Me vendimin Nr. 11 datë 02.02.2023, nga GJKKO, është deklaruar fajtor 1 person për veprën penale të “*Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve*”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal, vendim i cili ka marrë formë të prerë me datë 29.03.2023.

Ish-Zyrtarët e lartë për periudhën 01.01.2023-31.12.2023

- Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 nga Prokuroria e Posaçme janë hetuar (të mbartur + regjistruar) gjithsej 20 procedime penale me 22 persona në hetim/pandehur, ndaj ish zyrtarëve të nivelit të lartë.
- Ndër këto janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim:
 - 5- ish- Kryetarë Bashkie
 - 1- ish- Gjyqtar
 - 1- ish- Ministër Mjedisi
 - 1- ish- Ministër Finance
 - 2- Kryetar Bashkie
 - 1- ish-kandidat për Kryetar Bashkie
 - 1- ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë
- Me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, nga GJKKO gjatë vitit 2023, janë dhënë 6 vendime dënimi me 9 persona të dënuar për ish zyrtarë të nivelit të lartë.

Të dhënat për hetimet pasurore për vitin 2023

- Prokuroria e Posaçme, në vijim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale që rezultojnë nga veprat penale, gjatë vitit 2023 ka arritur të sekuestrojë dhe konfiskojë një portofol të diversifikuar asetesh, si pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare, si dhe portofole kriptovalutash. Më konkretisht:
- **Në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009**, janë paraqitur në gjykatë 8 kërkesa për sekuestrimin e pasurive dhe janë dhënë nga gjykata 9 vendime për sekuestrim pasurie duke sekuestruar përkatësisht: 28 pasuri të luajtshme, 72 pasuri të paluajtshme, 17 subjekte tregtare, nga të cilët 10 subjekte tregtare të konfiskuar plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave nën hetim për 7 subjekte tregtare.
- Pasuritë e sekuestruara sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” vlerësohen rreth 275,553,016 Lekë.
- Po kështu, janë paraqitur në gjykatë 6 kërkesa për konfiskimin e pasurive, nga të cilat 1 kërkesë e vitit 2022 dhe 5 kërkesa të vitit 2023, ndërkohë që janë dhënë nga gjykata 6 vendime për konfiskim të pasurive duke konfiskuar përkatësisht: 17 pasuri të luajtshme, 23 pasuri të paluajtshme, 3 subjekte tregtare, nga të cilët 2 subjekte tregtare të konfiskuar plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave nën hetim për 1 subjekt tregtar.
- Pasuritë e konfiskuara sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” vlerësohen rreth 64,341,850 Lekë.

- **Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020**, janë dhënë nga GJKKO 16 vendime me objekt konfiskimi, duke konfiskuar përkatësisht: 63 pasuri të paluajtshme, 26 pasuri të luajtshme, 1 subjekt tregtar dhe 1 llogari bankare.
- Pasuritë e konfiskuara sipas Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020, “*Për Masat Parandaluese në Kuadër të Forcimit të Luftës Kundër Terrorizmit, Krimin të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe Konsolidimit të Rendit e Sigurisë Publike*” vlerësohen rreth 370,718,221 Lekë.
- **Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, gjatë procesit penal**, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, janë marrë 8 vendime për sekuestrim pasurie. Në total janë sekuestruar rreth 35 pasuri të paluajtshme, 3 subjekte tregtare, nga të cilët 2 subjekte tregtare të sekuestruara plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave nën hetim për 1 subjekt tregtar dhe 16 llogari bankare.
- Pasuritë e sekuestruara sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë vlerësohen rreth 1,711,258,000 Lekë.

Konfiskim i pasurisë në proces penal

Është dhënë konfiskim pasurie në proces penal, në 20 vendime penale.

1. Pasuri të paluajtshme të konfiskuara

- 4 pasuri të paluajtshme

2. Vlera monetare të konfiskuara në Lekë, Euro dhe Dollar.

- 5.800.000 Lekë
- 18.350.000 Euro

3. Pasuri të luajtshme të konfiskuara

- 11 pasuri të luajtshme

VOLUMI I PUNËS NË GJYKIM

Për vitin 2023, nga GJKKO, janë dhënë gjithsej 88 vendime me 277 persona, nga të cilat rezultojnë se: ka përfunduar gjykimi i themelit për 75 çështje penale me 260 persona. Për 4 çështje penale me 4 persona të pandehur është vendosur shpallja e mos kompetencës lëndore dhe janë dërguar për kompetencë në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore.

Për vitin 2023, nga GJKKO, janë dhënë gjithsej 67 vendime dënimi me 233 persona të dënuar. Nga këto, 20 çështje penale me 59 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimin të organizuar, ndërsa 47 çështje penale me 174 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera.

Pafajësitë. Gjatë vitit 2023, nga GJKKO janë deklaruar të pafajshëm 27 persona.

Në lidhje me pafajësitë e dhëna nga GJKKO rezultojnë se: nga 8 çështje me 99 persona të gjykuar është vendosur pafajsi e plotë për 2 çështje me 13 persona të pandehur, ndërsa për 6 çështje të tjera ka vendime fajësie për 72 persona dhe vendim pafajësie për 14 të tjerë.

Për 58 çështje penale themeli me 404 persona të pandehur vazhdon gjykimi, duke u mbartur për t'u gjykuar në vitin 2024.

Prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në **690 seanca gjyqësore** të zhvilluara në këtë shkallë gjykimi nga të cilët kanë përfaqësuar në 352 seanca për veprat penale në kuadër të krimit të organizuar dhe në 338 seanca për vepra penale në kuadër të korrupsionit dhe veprat e tjera.

Në **GJAKKO**, për vitin 2023, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjeve penale të themelit, si dhe në gjykimin e ankimeve ndaj vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për kërkesat e prokurorisë gjatë fazës së hetimeve paraprake. Për vitin 2023, nga GJAKKO, janë dhënë gjithsej 57 vendime dënimi me 133 persona të dënuar. Nga këto, 22 çështje penale me 49 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar, ndërsa 35 çështje penale me 84 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera. Prokurorët e posaçëm **kanë marrë pjesë në 332 seanca gjyqësore** të zhvilluara në këtë shkallë gjykimi.

Përveç çështjeve penale të mësipërme, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë edhe në gjykimin e 11 çështjeve penale me të dëmtuar akuzues, që kanë paraqitur kërkesë drejtpërsëdrejti në gjykatë, me 13 persona të akuzuar.

Pushimet në gjykim—Për 6 çështje me 8 persona me të dëmtuar akuzues është vendosur pushimi i çështjes në gjykim në GJKKO.

Pafajësitë me të dëmtuar akuzues—Për 5 çështje me 5 persona me të dëmtuar akuzues është vendosur pafajësi në GJKKO.

Numri i ankimeve, rekurseve dhe zgjidhja përkatëse

1. Gjatë vitit 2023, janë ushtruar gjithsej **163** ankime ndaj vendimeve të dhëna nga GJKKO.

- Për **133** ankime ka përfunduar gjykimi në GJAKKO.
- Për **30** ankime vazhdon gjykimi në GJAKKO.

1. Gjatë vitit 2023, janë ushtruar gjithsej **92** rekurse ndaj vendimeve penale, nga të cilat janë shqyrtuar **41** rekurse
2. Gjatë vitit 2023, janë ushtruar **15** ankime nga Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme
3. Gjatë vitit 2023, janë ushtruar **4** rekurse nga Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme

Pjesëmarrja në gjykim në Gjykatën e Lartë

Për vitin 2023, në lidhje me pjesëmarrjen në gjykim në Gjykatën e Lartë rezulton që prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kanë marrë pjesë konkretisht:

- 9 raste në Gjykatën e Lartë.

Veprat penale që lidhen me zgjedhjet për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023

Numri i materialeve kallëzuese referuese dhe informacioneve të depozituara pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me krimet zgjedhore është 53, nga të cilat:

- Për 10 materiale është vendosur mos fillim procedimi.
- Në lidhje me 3 materiale dhe informacione është vendosur mospranim i akteve dhe ridërgim materiali pranë Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Për 4 materiale dhe informacione është vendosur dërgimi për kompetencë në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Në lidhje me 36 materiale është vendosur regjistrimi i procedimit penal.

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, janë hetuar (mbartur + regjistruar) gjithsej 50 procedime penale për 17 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me krimet zgjedhore, nga të cilat rezultojnë se:

- 8 procedime janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për gjykim me 16 të pandehur, me masë sigurimi 2 persona (arrest në burg) dhe 2 persona (arrest në shtëpi) dhe 4 persona (detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore).
- 6 procedime janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për pushim.
- 2 procedime janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.
- 1 procedim është pezulluar.
- 1 procedim është bashkuar me procedimet e tjera.

Aktualisht për krimet zgjedhore në hetim janë 32 procedime penale me 1 person nën hetim.

Veprat penale në kuadër të krimit të organizuar për vitin 2023

Gjatë vitit 2023 janë mbartur dhe regjistruar gjithësej 216 procedime penale me 268 persona në hetim për veprat penale në kuadër të krimit të organizuar dhe janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 11 procedime penale me 109 persona të pandehur, për veprat penale që lidhen me krimin e organizuar.

Dënimet e dhëna nga GJKKO për veprat penale të krimit të organizuar për vitin 2023

Gjatë vitit 2023, nga GJKKO, janë dhënë 20 vendime dënimi me 59 persona të dënuar, për veprat penale në fushën e krimit të organizuar

Veprat penale në kuadër të korrupsionit si dhe veprat e tjera penale për vitin 2023

Gjatë vitit 2023 janë mbartur dhe regjistruar gjithësej 534 procedime penale me 307 persona në hetim për veprat penale në kuadër të korrupsionit dhe veprat e tjera penale dhe janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 42 procedime penale me 187 persona të pandehur, për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe veprat e tjera penale.

Dënimet e dhëna nga GJKKO për veprat penale të korrupsionit si dhe veprat e tjera penale për vitin 2023

Gjatë vitit 2023, nga GJKKO janë dhënë 47 vendime dënimi me 174 persona të dënuar, për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe veprat e tjera penale

Veprat penale me qëllime terroriste për vitin 2023

Gjatë vitit **2023**, janë mbartur dhe regjistruar **28** procedime penale me **25** persona në hetim për veprat penale me qëllime terroriste dhe janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim **3** procedime penale me **25** persona të pandehur

Dënimet e dhëna nga GJKKO për veprat penale me qëllime terroriste për vitin 2023

Gjatë vitit 2023, GJKKO ka dënuar **3 (tre)** shtetas me burgim për veprën penale “Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”, të parashikuar nga neni 232/a i K.Penal.

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

Prokuroria e Posaçme në ushtrimin e kompetencave të saj, merr masa dhe mbikqyr ekzekutimin e vendimeve penale.

- Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar 79 vendime gjykate të formës së prerë. Nga këto 22 vendime kanë marrë formë të prerë në GJKKO dhe 57 vendime kanë marrë formë të prerë në GJAKKO.
- Janë dënuar me vendim të formës së prerë **269 të pandehur, nga të cilët:**
 - me burgim, janë dënuar 160 persona.
 - me kusht, kohë prove janë dënuar 91 persona.
 - me orë pune, janë dënuar 10 persona.
 - me gjobë, janë dënuar 2 persona.
- Gjatë vitit 2023, përveç deklaramit fajtor dhe masës së dënimit me burg apo me kohë prove, është dhënë dhe dënimi plotësues “**ndalimi për të ushtruar funksion publik**”, në bazë të nenit 35 të Kodit Penal për **85 persona**.

Gjatë vitit 2023, kërkesat e paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për vendosjen në regjim të posaçëm të të dënuarve, si dhe vendimmarrja përkatëse e Ministrit të Drejtësisë, pasqyrohet si më poshtë:

- Janë paraqitur 26 kërkesa nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vendosjen në regjim të posaçëm për 26 të dënuar.
- Për 4 të dënuar është vendosur refuzimi i kërkesës për vendosje në regjim të posaçëm.
- Për 17 të dënuar vijon procesi i shqyrtimit të kërkesës në Prokurorinë e Posaçme.
- Janë paraqitur 5 kërkesa nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për vendosjen në regjim të posaçëm për 5 të dënuar dhe është konfirmuar vendosja në regjim të posaçëm me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, për 2 prej tyre.
- Është bërë ankim në gjykatë kundër urdhërit të Ministrit të Drejtësisë për vendosje në regjim të posaçëm nga 2 të dënuar.

- Janë nxjerrë 269 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale për 269 të dënuar.
- Janë nxjerrë 230 vendime për miratimin e takimeve të të paraburgosurve me familjarët e tyre, sipas kërkesave të të paraburgosurve apo avokatëve të zgjedhur prej tyre.
- Gjatë vitit 2023, janë 39 të dënuar që kanë përfunduar vuajtjen e dënimit dhe janë nxjerrë vendimet nga prokurori për përfundimin e këtij dënimi. Vendimi i është dërguar Degës Territoriale të Shërbimit të Provës ku ka vendbanimin i dënuari, duke vënë në dijeni dhe Gjykatën.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE HETIMET E PËRBASHKËTA


Spektori është përgjegjës për koordinimin e punës së saj me autoritetet e shteteve të huaja. Spektori shërben si ndërlidhës me autoritetet e huaja në shërbim të ecurisë së hetimeve apo hetimeve të përbashkëta, ekstradimeve, marrëdhënieve me Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën Qendrore të Interpolit, Prokurorin Shqiptar Ndërlidhës në Eurojust, Oficerët Ndërlidhës atashuar pranë Ambasadave të huaja në Tiranë, etj.

Kërkesat për ndihmë juridike nga jashtë vendit

Gjatë vitit 2023, nga ana e Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta të Prokurorisë së Posaçme, janë trajtuar **48** kërkesa për ndihmë të ndërsjelltë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, në bazë të konventave të Këshillit të Europës dhe Konventave të Kombeve të Bashkuara, si dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare dhe dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë. Nga këto janë ekzekutuar **41** kërkesa për ndihmë juridike.

Këto kërkesa janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë lidhur me hetime në kuadër të veprave penale kryesisht në fushën e korrupsionit, trafikut të lëndës narkotike, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, vjedhje, të kryera në formën e bashkëpunimit asaj të grupit të strukturuar kriminal, etj., parashikuar nga nenet 244, 283/a, 287, 143, 143/b, 134, 28, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Ndarja sipas shteteve do të ishte, Belgjika me numrin më të madh të kërkesave **11** kërkesa, Holanda dhe Gjermania me nga **8** kërkesa, Italia **7** kërkesa, Spanja, Greqia, Maqedonia e Veriut me nga **2** kërkesa, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Norvegjia, Austria, Franca, Zvicra, Peruja, Kroacia dhe Kosova me nga **1** kërkesë.



Aktualisht numri total i kërkesave për vitin 2020 – 2023, për të cilat vijon ende procedura për ekzekutimin e tyre është **11** kërkesa, nga këto, **7** kërkesa janë transmetuar nga autoritetet e huaja në vitin 2023 dhe janë në proces ekzekutimi pranë Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta dhe **4** kërkesa të transmetuara nga autoritetet e huaja në vitin 2020 të cilat dhe janë në proces ekzekutimi.


Kërkesat për ndihmë juridike për jashtë vendit

Për nevoja të hetimeve nga Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme në vitin 2023, janë përpiluar **123** kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja, për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si vijon:

Shpërdorimi i detyrës, shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, refuzimi për deklarimin, mos deklarimin, fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, ekspertimi i rremë, korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë, korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, trafikimit të narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, organizata terroriste, pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj, vrasje me paramendim e mbetur ne tentative, vrasje në rrethana të tjera cilësuese , vrasje e funksionarëve publikë, vjedhje, vjedhje me dhunë, vjedhje me armë, falsifikimit të dokumenteve, etj., vepra këto të kryera në forma të veçanta të bashkëpunimit asaj të grupit të organizuar apo të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 248, 258, 260, 257/a, 309, 319, 319/ç, 283/a, 287, 143, 143/b, 234/a, 265/a, 78, 79, 79/a, 134, 139, 140 186, 28, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

Ndarja sipas shteteve do të ishte, Franca **30** kërkesa, Italia **12** kërkesa, Greqia **8** kërkesa, Gjermania dhe Holanda **7** kërkesa, Kroacia **6** kërkesa, Spanja, Belgjika dhe Kosova me nga **5** kërkesa, SHBA me nga **4** kërkesa, Kolumbi, Meksikë, Maqedonia e Veriut me nga **3** kërkesa, Ekuador, Brazil, Zvicër, Bullgari, Austri, me nga **2** kërkesa, Norvegji, Kanada, Rumani, Bosnje Hercegovinë, Monako, Maltë, Angli, Turqi, Lituani, San Marino, Suedi, Mali i Zi, Qipro, Hungari me nga **1** kërkesë.

Nga këto janë ekzekutuar nga autoritetet e huaja **54** kërkesa.



Aktualisht numri total i kërkesave për vitin 2020 – 2023, për të cilat vijon ende procedura për ekzekutimin e tyre nga autoritetet e huaja është **83** kërkesa të ndara më vite, janë si vijon: **69** kërkesa për vitin **2023**, **7** kërkesa për vitin **2022**, **2** kërkesa për vitin **2021** dhe **5** kërkesa për vitin **2020**.

Skuadrat e përbashkëta hetimore

Një tjetër fushë e bashkëpunimit ndërkombëtar, është dhe krijimi i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore.

Nga viti 2020-2023, në funksion të hetimeve të Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme në total janë krijuar **32 Skuadra të Përbashkëta Hetimore**, nga këto **25 Skuadra të Përbashkëta Hetimore** janë aktive, ku **10 prej tyre janë krijuar në vitin 2023**, në funksion të hetimeve për veprat penale të trafikimit të narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave, ndihma për kalim të paligjshëm, vepra të kryera në formën e bashkëpunimit të veçantë të grupit të organizuar dhe strukturuar kriminal, parashikuar nga Kodi Penal në nenet, 283/a, 28, 287, 189, 298, 333/a dhe 334.

Ndarja sipas shteteve për skuadrat e krijuara në vitin 2023 do të ishte, **Italia** me numrin më të madh me **5 Skuadra të Përbashkëta**, **2 me Maqedoninë e Veriut**, **1 me Francën**, **1 me Finlandën**, **1 me Kosovën**.

Në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, gjatë vitit 2023, janë mbajtur një sërë takime me autoritetet e huaja palë në këto skuadra, ku në vendin tonë janë zhvilluar **7** takime dhe jashtë vendit **14** takime, përveç mbledhjeve të përbashkëta mbajtura nëpërmjet video-konferencës.

Përsa i përket aksioneve/operacioneve të përbashkëta realizuar me partnerët ndërkombëtarë si dhe numrin e personave të arrestuar për vitin 2023, në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore janë:

1. Operacioni i përbashkët në kuadër të **Procedimit Penal Nr. 36, i vitit 2019** dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore, me palë SPAK-Itali. Në kuadër të këtij operacioni, janë arrestuar 12 persona;
2. Është realizuar një operacion i përbashkët në kuadër të **Procedimit Penal Nr. 249 i vitit 2020** dhe Skuadrës së Përbashkët Hetimore me palë SPAK-Itali. Në kuadër të këtij operacioni, janë arrestuar 21 persona, 14 persona jashtë vendit dhe 7 persona në Shqipëri.
3. Është realizuar një operacion i përbashkët në kuadër të **Procedimit Penal Nr. 121 të vitit 2021**, dhe Skuadrës së Përbashkët Hetimore me palë SPAK-Itali. Në kuadër të këtij operacioni, janë arrestuar 10 persona;
4. Është realizuar një operacion i përbashkët në kuadër të **Procedimit Penal Nr. 166 të vitit 2021**, dhe Skuadrës së Përbashkët Hetimore me palë SPAK-Itali. Në kuadër të këtij operacioni, janë arrestuar 2 persona;
5. Është realizuar një Operacion i përbashkët “HIGHWAY”, në kuadër të **Procedimit Penal Nr. 49, të vitit 2019** dhe Skuadrës së Përbashkët Hetimore me palë SPAK-Itali. Në kuadër të këtij operacioni, GJKKO, ka caktuar masën e sigurisë personale “Arrest në burg”, për 20 persona dhe masën e sigurisë personale “Arrest në shtëpi” për 1 person. Deri në këtë moment janë ekzekutuar masat e sigurimit për 15 persona dhe vijojnë veprimet për ekzekutimin e masave të sigurimit për personat e tjerë.
6. Është realizuar një Operacion i përbashkët, në kuadër të **Procedimeve Penale Nr. 56 dhe Nr. 77, të vitit 2022** dhe Skuadrës së Përbashkët Hetimore me palë SPAK-Francë. Në kuadër të këtij operacioni, GJKKO, ka caktuar masën e sigurisë personale “Arrest në burg”, për 17 persona. Deri në këtë moment janë ekzekutuar masat e sigurimit për 15 persona dhe vijojnë veprimet për ekzekutimin e masave të sigurimit për 2 personat e tjerë të shpallur në kërkim ndërkombëtar.

Urdhrat për shpalljen në kërkim ndërkombëtar

Në vitin 2023, është bërë Shpallja në Kërkim Ndërkombëtar për 72 persona.

Ekstradimet

Kjo prokurori gjatë vitit 2023, ka transmetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë **39** kërkesa për ekstradim nga jashtë vendit në Shqipëri, kryesisht për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet, 283/a, 297, 333/a, 334, 258 -25, 298/3, 28/5, 319 - 25, 232/a, 189,190, 79/dh, 278/1, 28/4, 109, 278/1, 152, 130/a/1, 139, 80, 245- 25, të Kodit Penal.

TABELA KRAHASUESE PËR VITET 2022-2023

LLOJI I KËRKESAVE	2021	2022	2023
Kërkesa për Ndihmë Juridike nga Jashtë Vendit	77	54	48
Kërkesa për Ndihmë Juridike për Jashtë Vendit	51	62	123
Skuadrat e Përbashkëta Hetimore	5	10	10

Shpalljet në kërkim ndërkombëtar	15	42	72
Kërkesat për ekstradim	17	10	39

Duke iu referuar tabelës së lartpërmendur vërehet një rritje e ndjeshme e volumit të punës së Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme në vitin 2023, e pasqyruar kjo edhe në kërkesat për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve të huaja në kuadër të procedimeve penale, shpalljet e personave në kërkim ndërkombëtar, si rrjedhojë edhe rritjen e kërkesave për ekstradim.

Është rritur ndjeshëm edhe komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe qoftë ato Europiane, Amerikane, gjithashtu edhe me autoritetet homologe të vendeve të Amerikës Jugut. Është rritur ndjeshëm shkëmbimi informacionit edhe nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit si Eurojust, Interpol, Europol etj. Vazhdon gjithashtu intensiv dhe në rritje komunikimi me oficerët ndërlidhës atashuar pranë Ambasadave të Huaja në Tiranë, i cili ndikon në forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Projektet Ndërkombëtare

Edhe gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme është asistuar në punën e saj nga programe të SH.B.A.-së, të cilat synojnë përmirësimin e drejtësisë kriminale të Shqipërisë dhe sektorin e zbatimit të ligjit — Programi Tejoqeanik i Ndhmës dhe i Trajnimit të Zhvillimit të Prokurorisë (OPDAT) dhe Programi Ndërkombëtar i Ndhmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP), përfaqësues të së cilave janë të vendosur dhe fizikisht në ambientet e kësaj prokurorie.

Misioni OPDAT është përfshirë në rishikimin e legjislacionit të drejtësisë kriminale, trajnimin e prokurorëve, gjyqtarëve, oficerëve të policisë, në dhënien e pajisjeve për zbatuesit e ligjit dhe dhënia e ndihmës teknike që synon vendosjen e strukturave më efektive të zbatimit të ligjit. Ky misioni me anë të Këshilltarëve Ligjorë të Përherëshëm, gjatë periudhës që nga krijimi e në vazhdim, ka ofruar ekspertizë dhe asistencë të bazuar në çështje konkrete për prokurorët në veçanti, por edhe më gjerë në sistemin e drejtësisë dhe në ndihmën për marrëdhëniet e kësaj prokurorie ndërkombëtarisht, me synimin për ta ndihmuar në luftën e saj kundër krimit ndërkombëtar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimet për Hetimet Kriminale ICITAP, është një program i cila ka si synim zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të zbatimit të ligjit, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. ICITAP edhe gjatë vitit 2023, ka mbështetur Byronë Kombëtare të Hetimit duke organizuar një sërë trajnimesh të specializuara për përmirësimin e kapaciteteve hetimore, si dhe ka mbështetur të gjithë strukturën e Prokurorisë së Posaçme, me mjete logjistike, pajisje elektronike Software, sisteme informatike etj. Një tjetër projekt, i cili ka operuar dhe ka dhënë ndihmesën, në punën e Prokurorisë së Posaçme **deri më fund të muajit Maj 2023**, ishte projekti në kuadër të marrëveshjes “**IPA 2019/Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor**”, i përfaqësuar nga Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar, Mbretëria e Hollandës. Ky projekt u fokusua në forcimin e kapaciteteve operationale të autoriteteve ligj zbatuese dhe atyre të sigurisë të Ballkanit Perëndimor, në luftën kundër krimit të

organizuar dhe terrorizmit. Mbështetja operationale, konsistoi në ndihmën për strukturat e SPAK që në raste konkrete hetimore, janë përfshirë në skuadra të përbashkëta hetimore (JIT) me vendet e tjera evropiane nëpërmjet koordinimit, këshillimit dhe mbështetjes logjistike. Projekti ka organizuar dhe ka mbështetur disa takime operationale, në Shqipëri dhe jashtë vendit, mes prokurorëve të SPAK dhe homologëve të tyre nga vendet e rajonit, si dhe vendet dhe agjencitë e BE-së etj., gjithashtu ky projekt ka dhënë ndihmën në forcimin e kapaciteteve të autoriteteve ligjzbatuese dhe atyre të sigurisë të Ballkanit Perëndimor, në shkëmbimin e informacionit (Ndërveprimi i Sistemeve të Informacionit).

Projekti EU4FOCAL, i financuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të programi të asistencës IPA 2020, “Lufta kundër Krimin të Organizuar në Shqipëri nëpërmjet Hetimit Penal dhe atij Financiar”, vijon të mbështesë SPAK edhe për vitin 2023, i cili është përfshirë në draftimin e një manuali mbi hetimin e pastrimit të parave dhe konfiskimit të pasurive me prejardhje kriminale. Ky projekt ka kryer një sërë aktivitetesh në mbështetje të këtij qëllimi, duke krijuar një grup pune me prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësues të SPAK dhe ekspertë ndërkombëtar.

Projekti EU4LEA është një projekt asistencë teknike i financuar nga BE me një mundësi për të ofruar pajisje, i projektuar për të mbështetur dhe ndihmuar agjencitë kryesore të zbatimit të ligjit shqiptar në veçanti Policinë e Shtetit Shqiptar, Ministrinë e Brendshme, SPAK (Prokurorinë e Posaçme dhe BKH), Prokurorinë e Përgjithshme, përfshirë ato të Juridiksionit të Përgjithshëm, në arritjen e objektivave të tyre dhe përafrimin e performancës së tyre me standardet më të mira të BE-së. Objektivi i përgjithshëm i projektit EU4LEA është të kontribuojë në fuqizimin e zbatimit të ligjit në Shqipëri. Objektivat specifike të projektit EU4LEA janë: 1) Përmirësimi i performancës të Policisë së Shtetit Shqiptar (PSHSH), SPAK-ut (Prokuroria e Posaçme dhe BKH), Prokurorisë të Përgjithshme dhe agjencive përkatëse në luftën kundër krimin të organizuar/krimin të rëndë, korrupsionit në nivele të larta dhe krimin mjedisor dhe 2) Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Kufirit Kombëtar.

Projekti EU4FAST (Mbështetje për Parandalimin dhe Luftimin e Kontrabandës së Emigrantëve dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor). Qëllim i këtij projekti është përmirësimi i kushteve për parandalimin dhe luftimin e kontrabandës së emigrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor. Ky projekt synon të forcojë aftësinë e autoriteteve ligjzbatuese dhe gjyqësore të Ballkanit Perëndimor për të luftuar kontrabandën e imigrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, aftësinë e aktorëve të zbatimit të ligjit të Ballkanit Perëndimor për të bashkëpunuar me Shtetet Anëtare, dhe aktorët e zbatimit të ligjit jo anëtarë në BE në aktivitetet që lidhen me kontrabandën e imigrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, të forcojë kapacitetin e autoriteteve kufitare të Ballkanit Perëndimor për të parandaluar dhe luftuar kontrabandën dhe trafikimin e qenieve njerëzore në përputhje me standardet e BE-së dhe të drejtat e njeriut.

Projekti WBCJ Western Balkan Criminal Justice (Drejtësia Penale e Ballkanit Perëndimor)

Eurojust për dy dekadat e fundit ka ofruar mbështetje dhe ndihmë operationale për shtetet anëtare të BE-së, me fokus të veçantë në lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor. Projekti i Drejtësisë Penale të Ballkanit Perëndimor (WBCJ) u zhvillua për të shtrirë këtë mbështetje operationale për partnerët e Ballkanit Perëndimor, edhe në rastet kur asnjë vend i BE-së nuk është i përfshirë drejtpërdrejt. Qëllimi i Projektit WBCJ është të forcojë bashkëpunimin brenda Ballkanit

Perëndimor dhe midis rajonit dhe Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, duke përdorur mjete dhe instrumente moderne. Pajisja e partnerëve të Ballkanit Perëndimor me mjetet dhe metodat e punës të bashkëpunimit gjyqësor të BE-së - si takimet e koordinimit, qendrat koordinuese dhe Skuadrat e Përbashkëta Hetimore (SPH) - është thelbësore për rezultatin e suksesshëm të hetimeve ndërkufitare.

Projekti Holandez MATRA “Strengthening the SPO” (forcimi i Prokurorisë së Posaçme), ka si synim kryesor dhënien e rekomandimeve për forcimin e Prokurorisë së Posaçme në aspekte të ndryshme të organizimit të saj dhe funksioneve mbështetëse më të mira, rritjen e uniformitetit të proceseve të punës duke u fokusuar kryesisht në lehtësimin e punës së prokurorëve, nëpërmjet stafit administrativ, hetuesve dhe ndihmësve ligjorë. Në kuadër të së cilit është zhvilluar edhe një vizitë studimore me qëllim shkëmbimin e eksperiencave lidhur me funksionimin e prokurorive homologe dhe agjencive ligjzbatuese në Holandë, duke sugjeruar gjithashtu edhe për ndryshime apo nisma të reja ligjore për këtë qëllim.

Vizita studimore/trajnime/konferenca jashtë shtetit

Për vitin 2023, përveç takimeve koordinuese në kuadër të skuadrave të përbashkëta nga prokurorët janë kryer **22** trajnime / vizita studimore, janë mbajtur **47** Takime / Konferenca / Forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Gjithashtu është bërë **1** takim raportues në kuadër të Moneyval.

Marrëveshjet e bashkëpunimit, memorandum me agjencitë vendase dhe të huaja

Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje ku më datë 29.06.2023, është nënshkruar Marrëveshja për bashkëpunim ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorit Publik Evropian.

Grupe Pune

Prokuroria e Posaçme, bazuar në ligjin nr. 95/2016, datë 06.10.2016, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”, në kushtet e ndryshimeve ligjore të bëra në ligjin nr. 10 193, datë 3.12.2009 “*Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale*”, i ndryshuar, në vitin 2023 ka vijuar punën në grupin e përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme për Hartimin e Udhëzimit të Përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme “*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për formën e kërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale*”.

Problematika

1. Vijon të mbetet problematike statusi i specialistit Ndërlidhës në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, i cili trajtohet si nëpunës civil bazuar në ligjit nr.

95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, edhe pse kjo situatë është në kundërshtim me funksionet që duhet të kryejë Specialisti Ndërlidhës sipas ligjit nr. 95/2016, pasi kërkesat për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale dërguar nga/për autoritetet e huaja, si dhe hetimet e përbashkëta, bazohen në Konventa shumëpalëshe, dypalëshe, Kodin e Procedurës Penale, si dhe ligjin nr. 10.193 datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, të ndryshuar, të cilat kanë si objekt kryerjen e **veprimeve procedurale**, ku në Drejtorinë homologe të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, këto veprime kryhet nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Në situatën aktuale ku Specialistët Ndërlidhës kanë statusin e “nëpunësit civil”, ata nuk mund të kryejnë veprimet procedurale por vetëm veprime administrative dhe ndihmëse. Këto veprime procedurale deri më tani janë të detyruar t’i kryejnë kryesisht Oficerët e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, për të cilët është një volum i shtuar në detyrat funksionale të përditshme të tyre, duke marrë në konsideratë edhe ngarkesën nga puna e shtuar vit pas viti e reflektuar kjo edhe nga raporti vjetor i Prokurorisë së Posaçme.

Duke marrë në konsideratë faktin se kërkesat për ndihmë të ndërsjelltë juridike, dhe skuadrat përbashkëta hetimore, janë në rritje, referuar statistikave vjetore, është e domosdoshme që këto veprime të kryhen nga ndërlidhësit e këtij sektori duke iu dhënë atyre atributet e Oficerit të Policisë Gjyqësore, si për statusin ashtu dhe ndryshimet e pagës e cila duhet të jetë e njëjtë me pagën e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës **Nr. 10 452 Prot., datë 30.11.2022**, i jemi drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, duke i propozuar disa ndryshime dhe shtesa mbi domosdoshmërinë për disa përmirësime ligjore të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, konkretisht ndryshimin e pikën 3, 4 dhe shtimin e pikës 5 të nenit 22, ndryshimin e paragrafit të germës “b”, në pikën 1 të nenit 23, por nuk kemi ende një përgjigje konkrete lidhur me këtë propozim.

2. Struktura e Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta është e përbërë prej tre Specialistë Ndërlidhës, ku aktualisht janë duke kryer funksionet vetëm dy prej tyre, mbetet për t’u plotësuar vendi vakant në strukturën e këtij sektori.

3. Një problematikë e hasur gjatë punës së Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe hetimeve të përbashkëta është edhe mungesa e kompetencës për shqyrtimin e kërkesave të autoriteteve të huaja lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja në Shqipëri në ngarkim të shtetasve shqiptarë për veprat penale për të cilat Prokuroria e Posaçme ka në kompetencë, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, gjithashtu edhe paraqitja e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimet e vendimeve penale të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga një shtet i huaj me arsyetimin si më poshtë:

- Prokuroria e Posaçme nuk mund të shqyrtojë kërkesat e autoriteteve të huaja për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, për veprat penale që ka në kompetencë, pasi ligji për Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë nr. 10 193, datë 3.12.2009 (i ndryshuar), në nenin 53,

- pika “4”, këtë kompetencë ia jep Prokurorit të Rrethit Gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm;
- Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme nuk mund të paraqesë një kërkesë për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi penal të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga një shtet i huaj, në rastet kur ky vendim nuk mund të ekzekutohet brenda territorit shqiptar, ose në rastet kur një shtet i huaj refuzon ekstradimin e një shtetasi të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Prokuroria e Posaçme, për shkak të shtetësisë së tij sipas nenin 6/2 të Konventës Evropiane për Ekstradimin e vitit 1959, pasi këtë kompetencë ligji i lartpërmendur sipas nenit 62, pika “2” ia atribuon Prokurorisë së Përgjithshme.
 - E njëjta situatë është edhe në rastet e ekzekutimit të vendimeve të huaja për transferimin me qëllim vazhdimin e vuajtjes së dënimit për shtetasit shqiptar që janë duke vuajtur dënimin me burgim në një shtet të huaj për kryerjen e veprave penale në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale;
 - Apo për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Posaçme për transferimin me qëllim vazhdimin e vuajtjes së dënimit për shtetasit e huaj që janë duke vuajtur dënimin me burgim në Shqipëri për kryerjen e veprave penale në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, pasi këtë kompetencë ia jep Prokurorisë së Përgjithshme.

Për këtë arsye, sa më lart, propozojmë ndryshimet e Ligjit për Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë nr. 10 193, datë 3.12.2009 (i ndryshuar), konkretisht në **nenin 53** e në vijim, **nenin 60** e në vijim të **Kreut IV “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale”**, **Seksioni I “Ekzekutimi i vendimeve penale të huaja”**, si dhe **nenit 62** e në vijim të **Kreut IV “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale”**, **Seksioni II “Ekzekutimi i Vendimeve Penale Shqiptare Jashtë Shtetit”**, duke i dhënë Gjykatës Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar kompetencën për shqyrtimin e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja për transferimin me qëllim vazhdimin e vuajtjes së dënimit për shtetasit shqiptar që janë duke vuajtur dënimin me burgim në një shtet të huaj për kryerjen e veprave penale të parashikuara sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, si dhe paraqitjen e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi penal të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga një shtet i huaj gjithashtu dhe kërkesat për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Posaçme për transferimin me qëllim vazhdimin e vuajtjes së dënimit për shtetasit e huaj që janë duke vuajtur dënimin me burgim në Shqipëri për kryerjen e veprave penale të parashikuara sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

4. Vazhdon dhe mbetet gjithashtu problematike çështja e mosekstradimit të shtetasve shqiptare të lokalizuar apo arrestuar në Emiratet e Bashkuara Arabe për këtë qëllim.

Kërkesat për ekstradimin e këtyre shtetasve janë të përpiluara nga Prokuroria e Posaçme sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara si në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000, në të cilën si Shqipëria ashtu dhe Emiratet e Bashkuara është palë, por edhe sipas Udhëzimit të Ministrisë të Drejtësisë së Emirateve të Bashkuara. Kemi qënë të gatshëm për të dhënë gjithashtu gjithë informacionin shtesë apo për të plotësuar çdo akt të kërkuar në mënyrë të përsëritur nga këto autoritete, por nuk kemi ende asnjë shtetas të ekstraduar që nga krijimi i SPAK e deri më tani.

BËRTHAMA KOMANDUESE

Gjatë vitit 2023, Bërthama Komanduese në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 186 procedime penale.

Tabela përmbledhëse me poshtë.

2023											
Procedime Penale	Nr. I Targeteve gjithsej	Autorizim Prokurori	Vendime Vleftesimi	Vendime Lejimi	Vendime Zgjatje	Vendime Gjykate gjithsej	Transkripte	Flete	BD-R	DVD	Te Ndahar
186	3335	358	330	265	1074	1669	11746	15702	115	41	207

Për vitin 2023, Bërthama Komanduese Elektronike, ka ekzekutuar në interes të çështjeve penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme:

- 358 Autorizime nga Prokurorët për lejim përgjimi;
- 1669 Vendime të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga të cilat:
 - 265 Vendime lejim përgjimi
 - 330 Vendime vleftesimi
 - 1074 Vendime zgjatje afati përgjimi

Gjatë vitit 2023, për veprat penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme, janë interceptuar 3335 pajisje fundore (*pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim*).

Në vitin 2023, pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, e kryesojnë çështjet të hetuara për veprën penale të korrupsionit (nenet 244, 245, 245/1, 258, 259, 319, dhe 319/ç, 328) me 109 procedime penale/1436 pajisje fundore; më pas janë çështjet penale të hetuara për veprën penale të grupit të strukturuar kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike (283/a/2, 333/a, 334) me 77 procedime penale/1899 pajisje fundore.

Nga këto, disa procedime janë finalizuar me masa të ndryshme sigurimi nga Gjykata për 207 persona.




Me të dhënat e përfituara nga interceptimi, në disa raste kanë dhënë rezultate përtej dyshimit që ekzistonte ndaj subjektit të vendosur nën përgjim. Mbi të dhënat e interceptimit jashtë objektit të hetimit, është mundur regjistrimi i procedimeve penale më vete.

Krahasuar me vitin 2022 (*grafiku i mëposhtëm*) kemi një rritje të treguesve mbi 52% në të gjithë zërat.

Më poshtë gjendet pasqyra përmbledhëse e procedimeve penale për vitin 2023 e krahasuar me vitet e mëparshme për të cilat është kërkuar përgjimi telefonik.

PASQYRË PËRMBLEDHËSE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2020-2021-2022- 2023	2020	2021	2022	2023	Krahasuar me vitin 2022 në %
PROCEDIME PENALE	91	129	122	186	↑ 52%
PAJISJE FUNDORE	1373	1957	2177	3335	↑ 53%
VENDIME GJYKATE	943	1204	1000	1669	↑ 67%
AUTORIZIME TE PROKURORIT	391	411	328	358	↑ 9%

Paraqitja grafike sipas disa zërave krahasuar me vitet e mëparshme



SEKTORI I EKSPERTIZËS

Gjatë vitit 2023, në Sektorin e Ekspertizës janë pranuar 345 vendime ekspertimi për ekzaminim provash digjitale me 623 prova në total dhe konkretisht 407 telefona celularë, 76 kompjutera, 19 DVR dhe 121 prova të tjera digjitale (hard disqe, USB, video-regjistruar, tableta, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Gjatë vitit 2023 nga ekspertët e këtij sektori janë realizuar 261 akte ekspertimi, ku janë ekzaminuar 453 prova digjitale në total dhe konkretisht 321 telefona celularë, 37 kompjutera, 20 DVR dhe 75 prova të tjera digjitale (si hard disqe, USB, regjistruar, tableta, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Për vitin 2023 janë realizuar 5 akte ekspertimi më shumë se viti 2022 si dhe 226 akte më shumë se viti 2021.

Për vitin 2023 janë ekzaminuar 29 prova digjitale më shumë se viti 2022 si dhe 398 prova digjitale më shumë se viti 2021.

Ndryshe nga vitet 2021-2022, ekspertët e këtij sektori janë angazhuar edhe në disa vendngjarje për sekuestrim provash dhe të dhënash kompjuterike, si dhe në vendngjarje dhe ekzaminime në ndihmë të prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjithashtu për vitin 2023 kemi një rritje të numrit të vendimeve të dërguara për ekspertim krahasuar me vitin 2022 dhe 2021, ku për vitin 2023 janë dërguar për ekspertim në këtë sektor 105 vendime ekspertimi dhe 117 prova digjitale më shumë se viti 2022, si dhe 227 vendime ekspertimi dhe 350 prova digjitale më shumë se viti 2021.

DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) pranë Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), ka si qëllim menaxhimin, zhvillimin, planifikimin, mirëmbajtjen dhe ofrimin e mbështetjes për sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) të institucionit, me qëllim krijimin e një ambienti pune efikas, të sigurt dhe që ju vjen në ndihmë prokurorëve, hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe stafit të administratës për kryerjen e punëve të përditshme.

Gjatë vitit 2023 DTI ka kryer detyrat e saj sipas kategorive të mëposhtme:

- a. Mirëmbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës kompjuterike dhe të pajisjeve qendrore të Data Center
- b. Sistemet dhe faqja zyrtare Web
- c. Mirëmbajtja dhe zhvillimi i Rrjetit të Klasifikuar
- d. Mirëmbajtja e Rrjetit telefonik
- e. Sistemet për Sigurinë e Godinës
- f. Aksesin në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave shtetërore
- g. Hartimi i Dokumentacionit

- h. Suporti dhe mbështetja e përdoruesve
- i. Marrja pjesë në komisione dhe grupe pune të ndryshme
- j. Marrja në dorëzim e Godinës së Re
- k. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë
- l. Mbështetja Financiare nga institucionet shtetërore
- m. Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të dosjeve (Case Management)

Mirëmbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës kompjuterike dhe të pajisjeve qendrore të data center

Në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sistemet dhe infrastruktura janë konfiguruar që të garantojnë disponueshmëri më shumë se 99.999%. Gjatë gjithë kohës kryhet mbikëqyrje e Data Center-it qendror të institucionit, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e proceseve dhe funksionimi i pajisjeve sipas kërkesave dhe e parametrave teknike për të garantuar funksionim normal të sistemeve.


Në mbështetje të stafit të DTI ka qenë edhe suporti nga Operatori Ekonomik i kontraktuar, i cili ka dhënë ndihmën e tij në rastet kur ka qenë e nevojshme dhe pamundur zgjidhja e problematikave nga vetë stafi i DTI.

Sistemet dhe faqja zyrtare web

Menaxhimi në nivel qendror i të gjitha sistemeve, pajisjeve dhe përdoruesve është bazuar mbi serverin e Domain Controller i cili garanton dhënien e aksesit sipas niveleve të caktuara të sigurisë. Ky sistem monitorohet në mënyrë të vazhduar në mënyrë që të ofrojë disponueshmëri, integritet dhe pamohueshmëri të shërbimeve për përdoruesit e SPAK.

Sistemi i Postës Elektronike është një sistem shumë i rëndësishëm për SPAK dhe hostohet në serverat pranë Data Center-it qendror. Sistemi i Postës Elektronike është i konfiguruar që të ofrojë disponueshmëri më shumë se 99.999%. Për të garantuar sigurinë e këtij sistemi DTI ka aplikuar masa të forta sigurie nëpërmjet një sistemi specifik për këtë qëllim, një Mail Security Appliance, i cili menaxhohet dhe monitorohet nga stafi i DTI.

Në tre-mujorin e dytë të vitit 2023 është përfunduar krijimi i faqes zyrtare www.spak.gov.al. Kjo faqe është bashkim i dy faqeve të mëparshme (spak.al dhe bkh.al). Në këtë faqe janë hedhur informacionet ekzistuese nga dy faqet e mëparshme si dhe çdo ditë përditësohet me informacione shtesë. Gjithsej, gjatë vitit 2023, janë hedhur 376 njoftime nga të cilat 236 janë njoftime për media.



Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të klasifikuar në Prokurorinë e Posaçme

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ndër detyra e saj ka edhe mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Rrjetit të Klasifikuar të Prokurorisë së Posaçme. DTI gjatë gjithë vitit ka pasur në fokus përditësimet e sigurisë, monitorimin e masave të sigurisë, përditësimin e rregulloreve, përditësimin e planeve të ndryshme të menaxhimit të riskut dhe sigurisë etj. Gjatë gjithë vitit është kryer mbikëqyrja e nevojshme për zbatimin e masave të sigurisë fizike dhe masave për sigurinë e Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit. Gjithashtu herë pas herë janë kryer takime ndërgjegjësimi me stafin në lidhje me zbatimin e masave të sigurisë për sigurinë e Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit dhe është dhënë asistencë e nevojshme në rastet kur është kërkuar.

Mirëmbajtja e rrjetit telefonik

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ndër detyra e saj ka edhe mirëmbajtjen e rrjetit telefonik në SPAK. DTI ka kryer në mënyrë periodike mirëmbajtjen e rrjetit telefonik. Sipas nevojës janë shtuar përdorues të rinj, janë kryer update të pajisjeve dhe upgrade të sistemit. DTI ka kryer herë pas here mbështetjen e përdoruesve në rastet kur ka qenë e nevojshme dhe në rastet kur është kërkuar.

Sistemet për sigurinë e godinës së SPAK

Për sa i përket sigurisë dhe monitorimit të godinës stafi i DTI ka kryer në mënyrë periodike monitorimin e tyre dhe në çdo rast kur ka qenë e nevojshme është kryer mirëmbajtja e tyre. Sistemet të cilat DTI i menaxhon dhe i mirëmban janë si më poshtë:

- Sistemi i monitorimit të kamerave CCTV, ky sistemi shërben për rritjen e sigurisë së godinës dhe monitorimin e tyre nga punonjësit përkatës të DTI brenda godinës dhe punonjësit e sigurisë pranë SPAK për perimetrin e jashtëm të godinës. DTI ka kryer në mënyrë të vazhduar monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit dhe kamerave në mënyrë që të sigurohet qëndrimi i tyre gjatë gjithë kohës online. Janë kryer back-up dhe monitorime sipas rasteve dhe kërkesave.
- Sistemi i Aksesit, ky sistem lejon aksesin e punonjësve në ambientet e zyrave të SPAK nëpërmjet kartës së aksesit. Çdo punonjës është i pajisur me kartën e tij personale me numër unik identifikimi për të menaxhuar aksesin e tyre dhe për ta lejuar sipas zonave të sigurisë në varësi të detyrave funksionale. Gjatë vitit është kryer mirëmbajtja e këtij sistemi dhe konfigurimi i tij për shtimin apo heqjen e përdoruesve, ndryshimin e të drejtave të aksesit sipas zonave të caktuara si dhe është kryer mirëmbajtje fizike e Access Controller-va kur ka qenë e nevojshme. Janë kryer në mënyrë periodike javore backup-et për ruajtjen e logeve të aksesit si dhe janë kryer proceset e update-ve për Access Controllers.
- Sistemi Biometrik i aksesit, ky sistem lejon aksesin e punonjësve në ambientet e zyrave të SPAK nëpërmjet të dhënave biometrike, Ky sistem është vendosur në zonat e sigurisë së lartë, ku përdoren sisteme biometrike me disa nivele të teknologjisë më të fundit. Gjatë vitit është kryer mirëmbajtja e këtij sistemi dhe konfigurimi i tij për shtimin apo heqjen e përdoruesve sipas zonave të caktuara,

- Sistemi anti-zjarr dhe rrjeti me sensorë për detektimin e lëvizjeve për sigurinë e zyrave pas përfundimit të punës. Gjatë vitit është kryer monitorimi i këtij sistemi në bashkëpunim edhe me sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.
- Skanerat me rreze infra për skanimin e çantave për përmbajtje metalike, kimike apo biologjike në hyrje të godinës. Në lidhje me këto pajisje DTI ka kryer mirëmbajtjen e tyre në rastet kur ka qenë e nevojshme.
- Sistemi Perimetral i përbërë nga sensorë dhe barriera me rreze infra për detektimin e shkeljes së perimetrit të institucionit duke sinjalizuar në kohë reale personat përgjegjës për sigurinë e godinës.

Aksesi në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave shtetërore

Sipas ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë akses të drejtëpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e duhur për hetimin e veprave penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Aksesi i drejtëpërdrejtë e ka ndihmuar SPAK në aksesin në kohë reale të informacionit të kërkuar dhe ka shkurtuar kohën e aksesimit të të dhënave duke ulur kostot nga komunikimi shkresor dhe gjithashtu ruan sekretin hetimor

Për kryerjen e komunikimi me institucionet përkatëse SPAK ka lidhjet fizike si më poshtë:

- Lidhje me Fiber Optike (FO) me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku është marrë akses në sistemin TIMS dhe sistemet e tjera që ofron ky institucion si E-gjoha, Raporte-Statistika, Adam, apo sisteme ndërkombëtare për të mundësuar bashkëpunim në kohe reale me partneret ndërkombëtarë.
- Lidhje me FO me Prokurorinë e Përgjithshme për të mundësuar komunikim të drejtëpërdrejtë në rastet e transferimit të dosjeve apo komunikimin elektronik të sistemeve.
- Lidhje me FO me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nëpërmjet të cilës mundësohet akses në bazat e të dhënave shtetërore, pasi pjesa me e madhe e institucioneve janë në GovNet.

Për të kryer komunikimet me institucionet DTI në çdo rast dhe sa herë është e nevojshme kryen konfigurimet përkatëse në mënyrë që të sigurohet vazhdueshmëria dhe siguria e shkëmbimit të të dhënave.

Gjatë vitit 2023 DTI ka mirëmbajtur lidhjet për të gjithë sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të sipër përmendura, gjithashtu ka marrë akses edhe për baza të dhënash të tjera si:

- Sistemi “ASYCUDA” nga Drejtoria e Përgjithme e Doganave;
- Sistemi “ISSH” nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- Sistemi C@ts nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Sistemi i Fiskalizimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

Në çdo rast është kryer komunikimi shkresor përkatës dhe më pas konfigurimet për lehtësimin e aksesit për çdo përdorues në këto 4 sisteme. Aktualisht SPAK ka akses në 17 sisteme informacioni apo baza të dhënash shtetërore.

Gjithashtu është kryer komunikimi shkresor përkatës dhe më pas konfigurimet për lehtësimin e aksesit për Hetuesit Financiar si dhe është bërë e mundur aksesit i tyre në të gjithë sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave në të cilat SPAK ka akses.

Hartimi i dokumentacionit

Gjatë vitit 2023 DTI është angazhuar maksimalisht për hartimin e rregulloreve dhe planeve të ndryshme në lidhje me fushën e IT dhe Sigurisë Kibernetike të cilat kanë shërbyer për rritjen e njohurive për përdoruesit dhe kanë mundësuar normimin e proceseve të caktuara të punës. Në lidhje me këtë detyrë janë hartuar:

- Rregullores e përdorimit të Postës Elektronike dhe Telekomunikacionit
- Strategjia e TIK dhe Sigurisë Kibernetike 2023-2024

Gjithashtu janë në proces edhe rregullore të tjera të cilat do të përfundohen gjatë vitit 2024.

Suporti dhe mbështetja e përdoruesve

DTI ndër detyra e saj ka edhe suportin dhe mbështetjen e përdoruesve të rrjetit kompjuterik të SPAK. Kryesisht janë kryer detyra si:

- mirëmbajtja e pajisjeve elektronike që janë në përdorim,
- mirëmbajtja e printerave, kompjuterëve, skanerëve, fotokopjeve,
- mbështetje për probleme të ndryshme që ka stafi gjatë ditës së punës,
- instalim të aplikacioneve në kompjuter sipas listës së miratuar në Rregulloren e përdorimit të Postës Elektronike dhe Telekomunikacionit dhe konfigurime të sistemeve për secilin punonjës,
- dhe Monitorimi i vazhdueshëm i sigurisë së informacionit

DTI gjatë vitit 2023 ka kryer konfigurimin e rrjetit dhe infrastrukturës së nevojshme për krijimin e posteve të punës dhe sistemimin e Hetuesve Financiarë në këto poste pune. Gjithashtu të gjithë hetuesit u pajisën me pajisjet elektronike të nevojshme për vazhdimin e punës dhe përmbushjen e detyrave të tyre

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë

Një ndihmë e madhe në fushën e IT është ofruar nga partnerët ndërkombëtarë si misionet ICITAP dhe OPDAT. Mund të përmendim ndihmën në pajisje fizike dhe sisteme, ku rolin kryesor e ka ICITAP, mision i cili gjatë vitit 2023 na ka ndihmuar në:

- Dhurimin e pajisjeve kompjuterike Workstation me performancë shumë të lartë për të ndihmuar ekspertët dhe hetuesit në kryerjen e detyrave të tyre.
- Trajnimin e stafit të DTI në fushën e mbrojtjes kibernetike ku mund të përmendim trajnimin e kryer në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Idaho National Laboratory i cili

është zhvilluar në bashkëpunim me Cybersecurity & Infrastructure Security Agency (CISA), trajnimin e kryer në Maqedoninë e Veriut nga Cybersecurity & Infrastructure Security Agency (CISA) edhe trajnime të tjera online.

- Kryerjen e procesit të zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, ky sistem përgjatë vitit 2023 ka qenë në zhvillim dhe është ofruar si ndihmë nga ICITAP. DTI ka pasur një rol të rëndësishëm që nga fillimi i idesë për zhvillimin e këtij sistemi dhe gjithashtu DTI ka krijuar infrastrukturën e nevojshme hardware dhe software për instalimin dhe vënien më pas në përdorim të tij. Është parashikuar që ky sistem të jetë funksional gjatë vitit 2024

Objektivi i përgjithshëm i projektit është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi të menaxhimit të gjitha çështjeve të trajtuara nga SPAK, mundësinë e krijimit të një regjistri elektronik /baze të dhënash, i cili mundëson ndjekje dhe administrim më të mirë të çështjeve, ndarje më të mirë të detyrave dhe përgjegjësi midis Prokurorëve, Hetuesve të BKH, zyrës së regjistrimit, komunikimin me gjykatën dhe analizimin e këtij informacioni për të gjeneruar raporte dhe statistika të sakta dhe në kohë reale. Por mbi të gjitha krijon një bazë të dhënash të domosdoshme për përditshmërinë por edhe vazhdimësinë e punës.

Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve do të mbështesë rrjedhën e punës së Prokurorëve dhe Hetuesve të BKH/OPGJ, zyrës së regjistrave dhe protokollit, duke mundësuar përmirësime të rëndësishme të punës së përditshme dhe mbi të gjitha, duke adresuar ndërveprimin konstant të punës së përditshme të prokurori, Hetuesve të BKH dhe regjistrimit të dokumenteve dhe elementeve të kësaj pune në regjistrat e ndryshëm, përmirësim të këtij ndërveprimi duke shmangur mbivendosjen e punës. Kjo mënyrë ndërveprimi nëpërmjet sistemit, do të garantojë nivelin e nevojshëm të sigurisë dhe sekretit hetimor. Implementimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e punës së përditshme dhe rritjen e transparencës në trajtimin e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Zhvillimi dhe implementimi i Sistemit të Menaxhimit të çështjeve SPAK/BKH, mundëson përveç të tjerave edhe një administrim dhe menaxhim më të mirë të të gjitha burimeve njerëzore dhe logjistike.

Për të analizuar proceset dhe mbledhur informacione të nevojshme për zhvillimin e këtij sistemi është ngritur edhe Grupi i Punës me punonjës nga të gjithë sektorët të cilët do të jenë pjesë e këtij sistemi.

Kërkesat themelore të funksionimit që do të përmbushen nga sistemi duke përfshirë në mënyrë modulare gjithë sektorët janë si më poshtë:

- Menaxhimi elektronik i të gjitha dosjeve që trajtohen në SPAK
 - Moduli i protokollit i cili realizon mbajtjen e regjistrimit të denoncimeve dhe korrespondencës lidhur me çështjet.
 - Vlerësimi, shortimi elektronik për caktimin e prokurorit që do të ndjekë çështjen;
 - Moduli i regjistrimit të trajtimit të çështjes nga Prokurori dhe Hetuesit e BKH/OPGJ.
 - Regjistrimit të trajtimit elementeve të ndryshëm të çështjes nga zyra e regjistrave. (Korrespondencën me gjykatat, letër porositë dhe elementë të tjerë që do të detajohen në vazhdim të punës për zhvillimin e sistemit).
 - Regjistrimi i ekzekutimit të vendimeve

- Administrimit të provave të regjistruara dhe sekuestruara në kuadër të hetimeve
- Rritja e nivelit të ndërveprimit dhe monitorimit të rrjedhës së punës midis prokurorit, zyrës së regjistrit dhe Gjykatës;
- Unifikimi i praktikave të punës së prokurorëve dhe hetuesve të BKH sipas çështjeve që administrohen dhe menaxhohen nga Prokurorët dhe me pas zyra e regjistrit;
- Ndërveprimi, ndjekja në çdo hap të çështjes, përmirësimi i efikasitetit dhe rritja e nivelit të përgjegjshmërisë për sekretin e çështjeve dhe dokumenteve të saj ndërmjet të gjithë aktorëve që do të përdorin sistemin;
- Mundësi të monitorimit, gjenerimit të raporteve dhe statistikave për të bërë më transparente dhe të prekshme rezultatet e punës të SPAK.

Rezultatet e pritshme të zhvillimit dhe implementimit të këtij sistemi do të mundësojë informatizimin proceseve të përmendura më lart për të garantuar një informacion të gjurmueshëm dhe të aksesueshëm në kohë reale nga fillimi i krijimit të dosjes në regjistrat e protokollit deri në arkivimin e dosjes bazuar në legjislacionin përkatës për trajtimin e dokumentit elektronik.

Sistemi ka një ndërtim modular dhe sipas parashikimeve paraprake në fillim të muajit Korrik 2024 do të fillojë faza pilotuese dhe testuese e sistemit, ndërsa brenda vitit pritet të përfundojë komplet sistemi së bashku me modulën e fundit i cili është ai i raporteve dhe statistikave të cilat do të gjenerohen me të dhënat e sistemit deri në atë moment.

Mbështetja financiare nga institucionet shtetërore

SPAK është mbështetur nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) e cila ka dhënë fonde sipas kërkesës së SPAK për blerjen e pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë, pajisjeve elektronike për zhvillimin e hetimeve etj. DTI ka pasur rol kryesor në parashikimin dhe marrjen pjesë në të gjithë procedurat për blerjen e pajisjeve dhe/ose sistemeve elektronike me fondet e përfituara nga AAPSK.

KOMISIONI I POSAÇËM I VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE PASTËRTISË SË FIGURËS GJATË VITIT 2023

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për Prokurorinë dhe GJKKO, i cili krijohet sipas pikës 12 të nenit 57, dhe e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të pikës 6, të nenit 6, dhe nenit 7 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ka në përbërje të tij një gjyqtar nga GJAKKO dhe dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme të zgjedhur me short, ku procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit, si dhe një hetues i BKH-së dhe, një Hetues Financiar nga Seksioni i Hetimit Financiar.

Gjatë vitit 2023 Komisioni ka përfunduar verifikimet e plota të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për 60 (gjashtëdhjetë) kandidatë për personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, GJKKO, si dhe për GJAKKO.

Gjatë këtij viti Komisioni ka filluar dhe ka vazhduar procesin e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës edhe për 13 (trembëdhjetë) kandidatë për Gjyqtarë në GJKKO.

Në këtë proces kanë përfunduar verifikimet dhe për 2 (dy) kancelarët e Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit.

Ky Komision kryen një punë shumë voluminoze, pasi përveç vendimmarrjes për kryerjen e verifikimeve nga ILDKPKI dhe DSIK, vazhdon me analizën e thelluar të raporteve të përcjella nga këto dy institucione, për çdo subjekt verifikimi. Kryen verifikime të drejtpërdrejta në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme, Prokurorinë e Përgjithshme, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, SHISH, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Departamentin e Administratës Publike.

Pas administrimit dhe analizimit të të gjitha të dhënave të grumbulluara Komisioni përpilon dhe i përcjell institucionit të emërtesës raportin e hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës

Në përmbledhje gjatë vitit 2023, Komisioni ka përfunduar raportet e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për **60** subjekte dhe vazhdon verifikimet edhe për **95** subjekte.

KOORDINATORI PËR MARRËDHËNIEN ME MEDIAN DHE E DREJTA E INFORMIMIT

Përgjatë vitit 2023, Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat, mbështetur në kuadrin ligjor dhe udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ka informuar publikun për punën e Prokurorisë së Posaçme, nëpërmjet komunikimit me gazetarë nga të gjitha mediat, si edhe gazetarë të pavarur në Republikën e Shqipërisë, në rajon dhe më gjerë.

Në funksion të arkivimit të kërkesave për informacion hyrës dhe dalës në Prokurorinë e Posaçme, roli i Koordinatorit për Marrëdhënien me Mediat, ka mundur mbajtjen në mënyrë të vazhdueshme dhe të përditësuar të *‘Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve’*, i cili sipas ligjit në fuqi nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, duhet të publikohet dhe përditësohet njëkohësisht në faqen zyrtare të institucionit çdo 1 muaj. Kjo procedurë monitorohet sistematikisht nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sikurse është vepruar edhe për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2023 për SPAK.

Nënvizohet se *‘Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve’* i përditësuar publikohet në faqen zyrtare të SPAK, në menunë *“Programi i Transparencës”/ “Programi i Transparencës SPAK”*.

Duhet theksuar se, në “kërkesat zyrtare për informacion”, të shënuara në *Regjistrin e Koordinatorit*, nuk janë konsideruar pyetjet e ndryshme për komente që vijnë kryesisht nga gazetarët, të cilat janë më të shpeshta dhe më të shumta në numër se sa kërkesat zyrtare dhe lidhen me specifika të çështjeve dhe hetimeve të ndryshme nën kompetencën e Prokurorisë së Posaçme.

Ndaj të gjithave kërkesave zyrtare për informacion, ardhur nga gazetarë por edhe nga subjekte të ndryshme, është dhënë përgjigje e plotë dhe, për secilin rast, **brenda afatit të përcaktuar ligjor**.

Informacioni që i kërkohet Prokurorisë së Posaçme, qoftë nëpërmjet kërkesave me shkrim në rrugë postare, apo nëpërmjet postës elektronike të institucionit/ Koordinatorit për Marrëdhënien me

Mediat, apo nga kërkesa specifike për të marrë intervistë, me incizim apo me shkrim direkt nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ka qenë i lartë edhe përgjatë vitit 2023.

Kërkesat për informacion janë të natyrave të ndryshme duke filluar që nga specifikat e hetimeve për çështje të ndryshme, deri tek pushimet dhe mosfillimet e çështjeve hetimore.

Gjatë vitit 2023, ka rezultuar se me interes kanë qënë kërkesat për informacion lidhur me hetimet në kuadër të veprave penale të krimit të organizuar, si dhe ato për qëllime terroriste, korrupsionin aktiv dhe pasiv të funksionarëve që ushtrojnë funksione publike. Gjithashtu me interes kanë qënë edhe kërkesat për informacion lidhur me sekuestime të ndryshme, krimet zgjedhore, ku mund të veçohen çështjet e njohura në media si: “Inceneratorët”, “Çështja Gërdeci”, “21 Janari”, “Dosja e Sterilizimit”, “Kompleksi Partizani” si dhe çështje që lidhen me procedurat e tenderimeve të ndryshme, afera të institucioneve publike dhe shoqërive të ndryshme tregtare etj.

Kërkesat lidhur me të drejtën e informimit i sjellin më së shumti subjektet për kallëzimet që kanë paraqitur, gazetarë vendas dhe të huaj si edhe nga redaksi, platforma dhe OJF të ndryshme.

Përgjatë vitit 2023 ka rezultuar të ketë konkretisht:

➤ **128 (njëqind e njëzetë e tetë) kërkesa zyrtare për informacion**

Të shpërndara në muaj si vijon:

- 32 kërkesa për informacion gjatë muajit Janar;
- 15 kërkesa për informacion gjatë muajit Shkurt;
- 19 kërkesa për informacion gjatë muajit Mars;
- 10 kërkesa për informacion gjatë muajit Prill;
- 8 kërkesa për informacion gjatë muajit Maj;
- 7 kërkesa për informacion gjatë muajit Qershor;
- 6 kërkesa për informacion gjatë muajit Korrik;
- 9 kërkesa për informacion gjatë muajit Gusht;
- 6 kërkesa për informacion gjatë muajit Shtator.
- 4 kërkesa për informacion gjatë muajit Tetor.
- 6 kërkesa për informacion gjatë muajit Nëntor.
- 6 kërkesa për informacion gjatë muajit Dhjetor.

Gjatë 2023, SPAK ka zhvilluar një sërë konferencash për shtyp në lidhje me forcimin e bashkëpunimeve të SPAK me autoritete gjyqësore të huaja dhe institucione ndërkombëtare lidhur me hetime komplekse në kuadrin e ngritjes së skuadrave të përbashkëta hetimore.

DOKUMENTACIONI I KLASIFIKUAR DHE I PAKLASIFIKUAR

Janë regjistruar në regjistrin hyrës të protokollit 1297 materiale kallëzuese gjithsej, për të cilat janë dhënë zgjidhje duke dërguar për vlerësim 84 materiale, për verifikim 32 në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, DVP, etj. Për 246 është kthyer përgjigje, 466 materiale janë dërguar për kompetencë, 182 janë arkivuar, një pjesë e të cilave si kërkesa të përsëritura dhe pjesa tjetër është në proces procedimi.

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në përmbushje të kompetencave të tij ligjore të parashikuara në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ka nxjerrë 528 urdhra nga të cilët:

- 4 Urdhra të Përbashkëta me Drejtorin e BKH-së;
- 1 vendim
- 2 Udhëzime të Përgjithshme,
- 2 Udhëzime jo detyruese për çështje konkrete
- 2 Rregullore të miratuara;
- 3 marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara me institucionet publike dhe private në vend.

Kancelari në funksion të ushtrimit të kompetencave që ka sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ka nxjerrë 463 urdhëra administrativ, financiar dhe si autoritet kontraktor i deleguar,

Janë regjistruar në Regjistrin e korrespondencës 17559 shkresa së bashku me praktikat hyrëse dhe dalëse.

- Regjistri i Urdhërave të Ekzekutimit U 256 nr. prot.
- Regjistri i Letërporosive L 406 nr. prot.
- Regjistri i Dosjeve D 168 nr. Prot.
- Regjistri i vendimeve V 840 nr. Prot.
- Regjistri i kërkesave të brendshme B 800 Prot.

Informacion për shkresat e ardhura nga institucione dhe individë të ndryshëm gjatë vitit 2023.

Janë regjistruar 1050 kërkesa nga institucione shtetërore, për të cilat janë kthyer 856 përgjigje, 5 janë arkivuar dhe 74 të tjera janë dërguar për dijeni subjekteve të interesuara.

Janë regjistruar 416 kërkesa të ndryshme drejtuar Institucionit nga shtetas, shoqata, gazetarë, etj., për të cilat janë kthyer 216 përgjigje, ndërsa 24 janë arkivuar.

Janë regjistruar 668 kërkesa të ndryshme administrative dhe procedurale, etj., për të cilat janë kthyer 215 përgjigje, ndërsa 3 janë arkivuar.

Numri i dokumentacionit të klasifikuar është 904.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Zhvillimi i burimeve njerëzore, në përputhje me objektivat dhe zbatimin e politikave përkatëse të Prokurorisë së Posaçme, synon të krijojë një mjedis pune të përshtatshëm dhe motivues, që i shërben jo vetëm rritjes profesionale të punonjësve, por dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit.

Plani i punësimeve, sipas organigramës, strukturës së Prokurorisë së Posaçme

Me ligjin nr. 84.2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, Prokurorisë së Posaçme ju vu në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, fondi i pagave, i cili do të mundësonte plotësimin e nevojave të organogramës, strukturës së Prokurorisë së Posaçme, me 133 punonjës në përputhje me Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 06, datë 05.01.2023 “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar.

Struktura dhe organika e Prokurorisë së Posaçme me një total prej 133 punonjësish.

Procesi i punësimeve, për pozicionet e parashikuara në organigramën, strukturën e Prokurorisë së Posaçme

Në mbështetje të ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve Për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të ndryshuar, të ligjit nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të ndryshuar, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” të ndryshuar, etj., të udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike, si dhe të Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 06, datë 05.01.2023 “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar, bazuar në planin e mësipërm të punësimit, vakancave shtesë të krijuara gjatë vitit 2023, është vijuar me shpalljen e procedurave për plotësimin e vendeve vakante, në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme, si dhe në Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe janë zhvilluar procedurat përkatëse, të punësimit, për plotësimin me personel administrativ.

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2023 kanë ushtruar detyrën gjithsej 105 punonjës, nga të cilët 17 (shtatëmbëdhjetë) Prokurorë të emëruar, 1 (një) Prokuror i transferuar, 12 (dymbëdhjetë) Hetues Financiar, 77 (shtatëdhjetë e shtatë) punonjës administrativë dhe 1 (një) punonjës me kontratë.

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2023, janë shpallur dhe zhvilluar procedura të punësimit për 30 pozicione të ndryshme, ku janë punësuar 28 (njëzet e tetë) punonjës, nga të cilët:

- ✓ të emëruar me kontratë pune me status Oficeri të policisë gjyqësore janë 12 (dymbëdhjetë) Hetues Financiar;

- ✓ të emëruar me kontratë pune janë 7 punonjës (1 (një) Këshilltar Ligjor, Kabineti i Drejtuesit dhe 5 (pesë) punonjës të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse (punonjës pastrimi dhe shoferë);
- ✓ të emëruar me procedura sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, janë 10 punonjës, nga të cilët (5 (pesë) punonjës të emëruar me procedurën “pranim në shërbimin civil”, 1 (një) punonjës i emëruar me procedurën “lëvizje paralele” dhe 4 (katër) punonjës të emëruar me procedurën “ngritje në detyrë”);
- ✓ në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, pranë Prokurorisë së Posaçme për vitin 2023 ka ushtruar funksionin 1 (një) punonjës me kontratë pune, me kohëzgjatje 6 orë në ditë, me afat 6 mujor.
- ✓ në proces të zhvillimit të procedurës, por të pa përfunduara 2 (dy) pozicione me status nëpunësi civil, (1 (një) kategoria ekzekutive dhe 1 (një) kategoria e ulët drejtuese)

Gjatë vitit 2023, në Prokurorinë e Posaçme kanë dhënë dorëheqjen për arsye personale 3 (tre) punonjës me kontratë pune. Gjithashtu, 1 (një) punonjës, kategoria ekzekutive, ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil, për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie.

Në mënyrë të përmbledhur numëri i pozicioneve të punësuar në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2023, paraqitet si më poshtë:

Statusi	Kategoria	Numri i të emëruarve për vitin 2023
Nëpunës civil	E mesme drejtuese	2
Nëpunës civil	E ulët drejtuese	3
Nëpunës civil	Ekzekutive	5
OPGJ	Hetues Financiar	12
Me Kod Pune	Kabineti i Drejtuesit	1
Me Kod Pune	Punonjës Administrate	5
Total		28

Në përfundim të vitit 2023, për arsye të lëvizjes së punonjësve ekzistues, si dhe për arsye objektive si rezultat i mungesës së zyrave janë zhvilluar procedura që kanë qenë të domosdoshme, procedurat e mbetura të rekrutimit, për pozicione pjesë e planeve të rekrutimit të vitit 2023, që duhet të zhvillohen gjatë vitit 2024.

Shkalla reale e plotësimit të Drejtorive/Sektorëve të Prokurorisë së Posaçme, në fund të vitit 2023, krahasuar me numrin e punonjësve sipas strukturës dhe organikës, të aprovuar me Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 06, datë 05.01.2023 “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, të ndryshuar, paraqitet si më poshtë:

Drejtorija/Spektori	Organika/Struktura	Aktualisht	Vakancë
Drejtuesi i Prokurorisë/prokuror	1	1	0
Kabineti i drejtuesit	4	3	1
Prokuror	19	16 + 1 transferuar	3-1 transferuar

Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetime të Përbashkëta	3	2	1
Bërthama Komanduese Elektronike	2	2	0
Sektori i Hetimit Financiar	16	12	4
Sektori i Ekspertizës	8	3	5
Sektori i Asistencës për Individët me Status të Posaçëm	2	1	1
Sekretaria Administrative	14	13	1
Sektori i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale	3	2	1
Sektori i Raportimeve pranë Bashkimit Europian	3	0	3
Kancelari	1	1	0
Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar	9	8	1
Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit	7	4	3
Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve	41	36	5
Total	133	104	29

Trajnimet e punonjësve

Që një institucion të realizojë qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në ligj, duhet jo vetëm të disponoj burimet e nevojshme, por edhe t'i përdorë ato me efektivitet. Duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve të Prokurorisë së Posaçme, e cila vjen gjithmonë e në rritje, roli i një personeli administrativ të trajnuar në funksionet mbështetëse është shumë i rëndësishëm për performancën dhe efikasitetin e Prokurorisë së Posaçme. Për këtë arsye, Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2023 me Urdhërin nr. 679, datë 09.10.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, miratoi “*Planin e trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026*”.

Prokurorët dhe Hetuesit Financiar zhvillojnë trajnime, të cilat kryesisht kanë pasur në vëmendje ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe profesionale në aspektin e hetimit dhe ndjekjes penale, të cilat zhvillohen nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe Projektet të ndryshme ndërkombëtare.

Për ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore, lidhur me trajnimet, gjatë vitit 2023, nga Prokuroria e Posaçme kanë ndjekur trajnimet e ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike gjithsej rreth 43 punonjës, nga Komisioni Europian dhe Organizata të tjera Ndërkombëtare rreth 7 (shtatë) punonjës, nga institucione trajnuese private rreth 4 (katër) punonjës. Në total punonjësit e Prokurorisë së Posaçme kanë ndjekur rreth 27 tema të ndryshme trajnimi, nga një numër i përgjithshëm me rreth 58 punonjës.

Gjithsesi gjatë vitit 2023 në bashkëpunim me ASPA, ILDKPKI, AKSIK dhe institucione të tjera, janë kryer on-line një pjesë e mire e trajnimeve të planifikuara.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, kryen dhe përfunduan trajnimin e detyrueshëm 2 (dy) javor, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, *"Prezantimi me Administratën Publike"*, duke kaluar me sukses edhe testin përkatës, 5 (pesë) punonjës, të emëruar nëpunës civilë në periudhë prove.

Të gjithë këta punonjës kanë kryer testin përkatës pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike në përfundim të periudhës së provës.

Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2023 ka konfirmuar në detyrë 2 (dy) nëpunës civil, për të cilët kanë ardhur rezultatet e testit të kryer dhe janë realizuar të gjithë procedurat përkatëse, bazuar në vlerësimin në punë për periudhën 1 (një) vjeçare të provës.

Pajisja me Certifikatën e Sigurisë së Personelit, për punonjësit e Prokurorisë së Posaçme.

Në mbështetje të ligjit nr. 10/2023 *"Për informacionin e klasifikuar"*, të Vendimit nr. 188, datë 04.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *"Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit"*, si dhe të Urdhërit nr. 256, datë 25.04.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme *"Për funksionet që duhet të pajisen me "Certifikatën e Sigurimit të Personelit" për njohje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të Shteteve dhe Organizatave të tjera Ndërkombëtare në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar"*, janë përcaktuar të gjitha funksionet që duhet të pajisen me Certifikatën e Sigurimit të Personelit, si dhe nivelin përkatës.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, referuar akteve ligjore në fuqi, si dhe kërkesave të drejtuara nga Prokuroria e Posaçme, ka proceduar duke pajisur me Certifikatë Sigurie stafin e Prokurorisë së Posaçme.

Spektori i Burimeve Njerëzore ka dhënë kontribut në hartimin dhe draftimin e disa akteve nënligjore si,

- ✓ Hartimi i draft rregullores së brendshme;
- ✓ Hartimi i draft Planit të Trajnimeve miratuar ne Urdhërin nr. 679, datë 09.10.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme;
- ✓ Hartimi i draft rregullave të sjelljes dhe standarteve të etikës në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, miratuar ne Urdhërin nr. 640, datë 25.09.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme;
- ✓ Hartimi i draft strategjisë së Burimeve Njerëzore;
- ✓ Përmirësimi i procedurave të rekrutimit, duke zbatuar ligjin 95/2016, ligjin 97/2016 si dhe legjislacionin e nëpunësit civil.

Veprimtaria e Sektorit në proceset gjyqësore ku Prokuroria e Posaçme ka qënë palë në proces.

Spektori i Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2023 ka ndjekur proceset gjyqësore administrative, në të cilat Prokuroria e Posaçme ka qënë palë në këto procese.

Janë rreth 18 procese gjyqësore për të cilat është realizuar përfaqësimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe 4 procese të cilat janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Administrative.

BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

Plotësimi i Strukturës

Struktura organizative e BKH-së është miratuar me Urdhërin e Përbashkët nr. 2 datë 12.01.2022, të Drejtorit të BKH-se dhe nr.28 datë 12.01.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme "Për Organizimin e Brendshëm të Byrosë Kombëtare të Hetimit". Në këtë akt janë përcaktuar 130 pozicione pune, nga të cilët, 1 pozicion drejtori, 110 hetues total nga të cilët 60 hetues të BKH dhe 50 oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore, gjithashtu 19 punonjës administrativ.

Përgjatë vitit 2023 është përfunduar procesi i rekrutimit të 6 punonjësve të stafit administrativ (këshilltar, 4 specialist dhe 1 drejtues automjeti). Bazuar në strukturën aktuale, viti 2023 është mbyllur me 1 vakancë në kabinetin e Drejtorit të BKH-së, 50 vakanca në pozicionet e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe 7 vakanca në stafin administrativ.

Procesi i rekrutimit të shërbimeve të policisë gjyqësore, është në proces konsultimi mënyra dhe fazat e procesit të rekrutimit me partnerët ndërkombëtar.

Trajnimet e hetuesve të BKH-së

Përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, 60 hetuesit e BKH-së kanë marrë pjesë në 47 trajnime brenda vendit dhe 25 jashtë vendit, organizuar kryesisht nga ICITAP, OPDAT, FBI, ILEA-Budapest, CEPOL, EUROPOL, EU4FOCAL, etj.

Urdhra të përbashkët të miratuar:

Urdhri i Përbashkët nr. 1020/4 datë 28.12.2023, të Drejtorit të BKH-së dhe nr. 978 datë 28.12.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme "Për Organizimin e Brendshëm të Byrosë Kombëtare të Hetimit";

Urdhri i Përbashkët nr. 958/8 datë 18.12.2023, të Drejtorit të BKH-së dhe nr. 935 datë 28.12.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme "Për ritestimin me shkrim dhe më gojë të hetuesve, grupi i parë";

Në proces Miratimi:

Përgjatë vitit 2023 Drejtori i BKH-së dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme janë konsultuar dhe kanë shkëmbyer mendime për dy projekt – aktet si më poshtë:

"Rregulloren e Brendshme të Byrosë Kombëtare të Hetimit" dhe *"Rregulloren për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të Hetimit"*;

Gjithashtu, në Korrik të vitit 2023 është miratuar nga Këshilli i Ministrave Vendimi nr. 438 datë 19.07.2023 "Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kritereve për trajtimin e punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit".

Marrëveshje të nënshkruara:

1. Me DIA (EUROPOL) për anëtarësimin e BKH-së në rrjetin operacional @ON;

2. Me ISSH “Për dhënien e së drejtës së aksesit BKH-së në sistemet elektronike të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”;

3. Me DPD “Për dhënien e së drejtës së aksesit në sistemin elektronik ASYCUDA World”.

Referimet në prokurorinë e posaçme

Në kuadër të veprimtarisë parandaluese bazuar në indiciet ose informacionet e ardhura nga agjencitë e tjera brenda dhe jashtë vendit, BKH ka administruar informacionet dhe ka kryer verifikimet në përputhje me ligjin. Deri në referimin e çështjes në Prokurorinë e Posaçme, informacionet janë siguruar nga të dhënat e bazave të informacionit (sistemet) në të cilat BKH ka akses, si edhe nga shkëmbimet e informacionit me institucionet brenda vendit dhe me partneret e huaj. Me SHISH ka patur 95 shkëmbime informacioni, me DPPSH 7 shkëmbime informacioni, dhe me AIF 21 shkëmbime informacioni dhe institucione të tjera 9 shkëmbime informacioni. Me agjencitë e huaja ligjzbatuese ka patur 139 shkëmbime informacioni.

Kontribut dhe raportime me institucionet e treta

Përgjatë vitit 2023 BKH, si strukturë kontribuuese ka dhënë kontribut në hartimin, miratimin dhe procesin e monitorimit për:

- Progres Raportin Vjetor të Komisionit Evropian;
- Nënkomitetin “Drejtësia Liria dhe Siguria”;
- Raportimet periodike për Kapitullin 23 dhe 24;
- Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 736 datë 13.12.2023;
- Strategjinë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021-2025; Strategjinë Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025;
- Pyetësorin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara mbi korrupsionin e niveleve të larta etj.

TREGUESIT E BUXHETIT PËR VITIN 2023 DHE PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN E ARDHSHËM DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), mbështetet plotësisht në Ligjet dhe udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës. Me qëllim përmbushjen e objektivave prioritare të institucionit, menaxhimi financiar është fokusuar në financimin e shpenzimeve në përputhje dhe me objektivat strategjik të SPAK dhe kryesisht për:

- 1 Krijimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme për Prokurorët, Hetuesit e BKH dhe personelin administrativ, në funksion të arritjes së rezultateve pozitive në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- 2 Përdorimin e teknologjisë më të avancuar në funksion të ekspertizës dhe hetimeve proaktive sipas kompetencës ligjore të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.
- 3 Përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të punës në shërbim të një trajtimi sa më efektiv të rasteve hetimore si dhe të krijimin e kushteve të përshtatshme të punës për punonjësit.

Përformanca e buxhetit në nivelin e programit për vitin 2023

Nëpërmjet këtij raporti evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut (Prokuroria e Posaçme dhe BKH) në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance. Analiza e zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Në zbatim të ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, buxheti i SPAK është planifikuar në vlerën 1,078 milion lekë, dhe me buxhetin vjetor të rishikuar në vlerën 1,077.4 milion lekë, fonde të cilat SPAK i ka administruar për financimin e aktiviteteve në një program me emërtimin “Veprimtaria e SPAK”.

Totali i Shpenzimeve të Institucionit për vitin 2023 (000/lekë)

Titulli	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor	Plani Vjetor i Rishikuar	Shpenzime Faktike	Diferenca	% e realizimit fakt/plan
1	2	3	4	5	6=(4-5)	7=(5/4)
03390	Veprimtaria e SPAK	1,178,000	1,077,438	1,042,742	34,696	97%
Totali i Shpenzimeve të Institucionit		1,178,000	1,077,438	1,042,742	34,696	97%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Me miratimin e detajimit të fondeve buxhetore të shpërndara për Prokurorinë e Posaçme dhe BKH-në, gjatë vitit 2023 është vijuar me marrjen e angazhimeve dhe kryerjen e pagesave bazuar në dokumentacionin justifikues të shpenzimeve, brenda limiteve dhe në afatet e përcaktuara. Realizimi në total i shpenzimeve është rreth 1,042.7 milion lekë ose rreth 97% të buxhetit vjetor të rishikuar.

Sipas programit “Veprimtaria e SPAK”, zërat buxhetor për vitin 2023 paraqiten: (000/lekë)

Art.	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor i Rishikuar	Struktura e shpenzimeve	Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve
1	2	3		4		5	
600	Paga	782,509.0	66%	831,162.0	77%	824,797.0	79%
601	Sigurime Shoqërore	200,374.0	17%	60,174.0	6%	60,004.0	6%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	128,117.0	11%	163,617.0	15%	149,084.0	14%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			484.0	0%	419.0	0%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,111,000.0	94%	1,055,437.0	98%	1,034,304.0	99%
231	Kapitale të Trupëzuara	67,000.0	6%	22,000.0	2%	8,435.0	1%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	67,000.0	6%	22,000.0	2%	8,435.0	1%
Totali (korrente + kapitale)		1,178,000.0	100%	1,077,437.0	100%	1,042,739.0	100%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve. Menaxhimi dhe kontrolli i brendshëm financiar janë fokusuar në ndërtimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar për të adresuar risqet dhe dhënien e një garancie të mjaftueshme më qëllim arritjen e objektivave të institucioneve të SPAK, nëpërmjet:

1. veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
2. pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
3. informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
4. mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Duke u mbështetur në veprimtarinë bazë të institucionit, pjesë përbërës e të cilit janë:

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me kod institucioni në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë 1041001,
2. Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) me kod institucioni në Sistemin informatikë Financiar të Qeverisë 1041002,

Gjatë vitit 2023, ka vijuar puna duke synuar në konsolidimin financiar dhe administrativ të institucionit, me qëllim arritjen e objektivave për realizimin e treguesve buxhetor dhe treguesve të performancës të përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Nëse i referohemi peshës specifike të llogarive ekonomike për zërat, shpenzime: korrente (ku përfshihen shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, mallra dhe shërbime) si dhe ato për investime, mbi totalin e shpenzimeve buxhetore sipas planit fillestar, atij të rishikuar si dhe realizimit faktik, pesha specifike grafikisht paraqiten:




Figure 1 Pesha sipas llogarive ekonomike të planit të buxhetit viti 2023

Në analizë të informacionit të paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafikisht, rezulton se:

- Sipas planit fillestar të miratuar, shpenzimet korrente zënë një peshë specifike 94% në vlerë rreth 782.5 milion lekë, ndërsa shpenzimet për investime zënë një peshë specifike 6% , në vlerë rreth 67 milion lekë.
- Sipas planit të rishikuar, shpenzimet korrente zënë një peshë specifike 98% në vlerë rreth 831.1 milion lekë, ndërsa shpenzimet për investime zënë një peshë specifike 2% , në vlerë rreth 22 milion lekë.
- Sipas realizimit faktik, në totalin e shpenzimeve të realizuara shpenzimet korrente zënë 99% në vlerë 827.7 milion lekë, ndërsa shpenzimet kapitale 1% në vlerë 8.4 milion lekë.

Nëpërmjet këtij raporti, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance, analizë e cila i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës SPAK do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit.

Performanca e realizimit të buxhetit në nivelin e programit për vitin 2023

Realizimi faktik i zërave të buxhetit për vitin 2023 krahasuar me planin e rishikuar (000/lekë)

Art.	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor	Plani Vjetor i Rishikuar	Shpenzime Faktike	Ndryshimi vjetor (Plan-Fakt)	Struktura e realizimit të shpenzimeve ne %
1	2	3	4	5	6=(4-5)	7=(5/4)
600	Paga	782,509.0	831,162.0	824,797.0	6,365.0	99%
601	Sigurime Shoqërore	200,374.0	60,174.0	60,004.0	170.0	100%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	128,117.0	163,617.0	149,084.0	14,533.0	91%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		484.0	419.0	65.0	87%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,111,000.0	1,055,437.0	1,034,304.0	21,133.0	98%
231	Kapitale të Trupëzuara	67,000.0	22,000.0	8,435.0	13,565.0	38%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	67,000.0	22,000.0	8,435.0	13,565.0	38%
Totali (korrente + kapitale)		1,178,000.0	1,077,437.0	1,042,739.0	34,698.0	97%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar




Figure 4 Pesha e realizimit faktik të zërave të buxhetit për vitin 2023 krahasuar me planin e rishikuar

Shpenzimet e personelit

Sa kemi trajtuar dhe më lartë plani i fondeve të akorduara përmes ligjit vjetor të buxhetit të rishikuar, në zërin e shpenzimeve për paga është në vlerën e rreth 824.7 milion lekë ose rreth 79% e totalit të buxhetit të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nga të cilat Prokuroria e Posaçme në shumën 391.9 milion lekë dhe BKH në shumën 432.8 milion lekë.

Bazuar në ndryshimet ligjore në vitin 2023, i referohemi këtu Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35/2022, lidhur me elementin e pagës bazë referuese për magjistratët dhe jo magjistratët, ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, VKM-së Nr. 325/2023, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, si dhe VKM nr. 26/2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të tjera në institucione të administratës publike”, janë llogaritur efektet e shtuara në kërkesat buxhetore lidhur me shpenzimet për paga.

Rrjedhje e shtesave dhe pakësimeve, të reflektuara në buxhetin e miratuar për programin “Veprimtaria e SPAK”, plani i rishikuar për shpenzimet për paga është në shumën 831.1 milion lekë. Në raport me planin buxhetor të rishikuar shpenzimet për paga janë realizuar në vlerën e rreth 824.7 milion lekë ose rreth 99% e planit të rishikuar të miratuar për këtë natyrë të shpenzimeve.

Për vitin 2023, fondi i miratuar me ligjin e buxhetit, rishikuar me aktet normative të dala gjatë vitit ushtrimor, ka qënë i mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e shpenzimeve për paga për personelin aktual sipas strukturave të SPAK. Në zbatim të përcaktimeve ligjore, ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, procesi i rekrutimit të punonjësve në funksione hetuese dhe administrative pranë SPAK, ka një procedure specifike dhe mjaft të detajuar ligjore që synon përzgjedhjen e personave nën një set kriteresh për respektimin e integritetit të institucionit, dhe si rrjedhojë e këtyre proceseve që kanë zgjatur në kohë gjatë vitit 2023, kanë mbetur pa plotësuar pozicionet për 2 Prokurorë, 4 Hetues Financiarë, 5 Ekspertë pranë Prokurorisë së Posaçme, 50 Oficerët e Policisë Gjyqësore në BKH, si edhe pjesë e personelit administrativ në të dy institucionet e SPAK. Ky proces është planifikuar të përmbyset gjatë vitit 2024, duke u kompletuar me të gjitha kapacitetet e nevojshme njerëzore e teknike në funksion të objektivave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Shpenzime për mallra, shërbime dhe të tjera

Aktiviteti operacional dhe hetimor i SPAK gjatë vitit buxhetor 2023, është mbështetur nga buxheti i shtetit në llogarinë e mallrave dhe shërbimeve (Llogaria ekonomike 602) në vlerën e buxhetit të rishikuar prej rreth 163.6 milion lekë. Me ligjin 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, fondi i miratuar fillimisht për zërin e shpenzimeve operative ka qënë në shumën 128.1 milion lekë, ndërkohë që kërkesat e paraqitura SPAK me PBA 2023-2025, për këtë zë buxhetor kanë qënë më të larta.

Gjatë vitit 2023, institucioni nga kjo llogari ka realizuar rreth 149 milion lekë ose ndryshe 91% të planit të rishikuar.

Rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2023, ka ardhur për shkak se institucioni ka operuar në kushtet e rritjes së volumit të procedurave hetimore të zhvilluara si dhe shtesës së stafit për të dy institucionet.

Transferta për buxhete familjare

Gjatë vitit buxhetor 2023, për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është planifikuar si Fond i Veçantë (Llogaria 606) për mbulimin e rasteve të fatkeqësive në shumën 0.48 milion lekë. Për vitin 2023 fondi i përdorur është në vlerën 0.42 milion lekë.

Shpenzime për Investime Kapitale

Në mbështetje të buxhetit për investime të miratuar me ligjin nr 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, prej 67 milion lekë, të detajuara sipas produkteve, fillimisht ishte parashikuar për blerje të produkteve: a) pajisje zyre në vlerën 35 milion lekë, b) blerje pajisje elektronike në shumën 5 milion lekë, c) skaner për kontrollin e automjeteve në shumën 11 milion lekë, d) blerje automjete në shumën 10 milion lekë dhe e) blerje pajisje operationale në shumën 6 milion lekë.

Në vijim, me qëllim mirëmenaxhimin e fondeve buxhetore, për fondet e parashikuara fillimisht për mobilje zyre, për skaner të detektimit e automjeteve dhe të pajisje operationale, u gjykua përdorimi i tyre për realizimin e investimeve në fushën e elektronikës, për blerje pajisje dhe sisteme elektronike si dhe realizimin e investimit për ndërtimin e një muri rrethues për Godinën e re të kaluar në administrim të SPAK sipas VKM-së nr.378, datë 21.06.2023 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë për Prokurorinë e Posaçme dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, shoqërisë “Ujësjellës -Kanalizime Tiranë” sh.a, të pasurisë Nr.8/123, në zonën kadastrale 8330.

Me shkresën 13162 prot., datë 06.10.2023, drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është paraqitur kërkesa për rialokim të fondeve për investimeve, kërkesë e miratuar me shkresën nr.18464 prot., datë 10.10.2023.

Për shkak të vonesave në miratimin e lejes së ndërtimit, projekt i perealizuar për vitin 2023 ka rezultuar dhe ndërtimi i një muri rrethues për godinën e re të kaluar gjatë vitit 2023 në administrim të SPAK.

Gjithashtu gjatë vitit 2023, me qëllim realizimin e Projektit “Blerje të pajisjeve dhe sistemeve elektronike për rritjen e sigurisë kibernetike dhe sistemit teknologjik për suportin e hetuesve në terren”, për Prokurorinë e Posaçme është miratuar një Grant me vlerë 169.2 milion lekë, me burim nga AAPSK, finalizuar midis palëve me lidhjen e Kontratës protokolluar me nr.1189, datë 30.03.2023, pranë Prokurorisë së Posaçme dhe Nr.206 prot., datë 30.03.2023, pranë AAPSK.

Bazuar në fondet e AAPSK dhe fondet buxhetore, Prokuroria e Posaçme në cilësinë e Autoritetit Kontraktor gjatë vitit 2023, inicioi procedurat e prokurimit me objekt:

- a) Blerje sisteme/pajisje të teknikës operative, procedurë e klasifikuar “sekret” në shumën 101 milion lekë (me fondet e AAPSK), procedurë e cila do të realizohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe do të vijoj dhe gjatë vitit 2024.
- b) Blerje sisteme dhe pajisje elektronike në shumën 84.5 milion lekë (me fondet e AAPSK dhe të buxhetit të shtetit). Lidhur me këtë procedurë e ndarë në 5 lote, në pamundësi të përfundimit me sukses të lotit ku ishte parashikuar angazhimi i fondeve buxhetore në shumën 45 milion lekë, Prokuroria e Posaçme mori masat për deklarimin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si teprica në zërin e Investimeve për shumën 45 milion lekë. Me Aktin Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 është miratuar pakësimi i fondit për investime në shumën 45 milion lekë.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm për vitin 2023 sipas zërave paraqitet:

- | | |
|-----------------------|------------------|
| • Blerje automjete | 7.95 milion lekë |
| • Blerje Pajisje zyre | 0.48milion lekë |
| • Totali | 8.43 milion lekë |

Për plotësimin e nevojave të institucionit me mallra dhe shërbime dhe investime gjatë vitit 2023, janë iniciuar 50 procedura prokurimi si dhe janë lidhur 46 kontrata/minikontrata me operatorët ekonomikë.

Ndihma nga Partnerët Ndërkombëtarë

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 56 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si një institucion kushtetues dhe me një objekt të përcaktuar qartë në aktet ligjore, gjatë vitit 2023 ka marrë ndihma nga fondet IPA si dhe ndihma nga Eurojust, të cilat kanë konsistuar në:

- Pajisje elektronike si dhe licenca të programimit
- Shpenzime procedurale në kuadër të skuadrave të përbashkëta hetimore

Efekti financiar i ndihmave nga këto institucione ndërkombëtare për SPAK llogaritet në vlerën e rreth 7.2 milion lekë. Gjithashtu, SPAK në kuadër të efikasitetit të përdorimit të burimeve publike vetëm nga kërkesat për materiale procedurale si dhe të ardhura nga gjatë gjyqësore, ka arkëtuar në buxhetin e shtetit rreth 2.9 milion lekë.

Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026

Në funksion të përmbushjes së Misionit dhe të Objektivave të institucionit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore për përgatitjen e PBA 2024-2026, anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik kanë konkluduar në hartimin e kërkesave buxhetore për politikat ekzistuese dhe politikat e reja të planifikuara në përputhje me objektivat e institucionit për realizimin e misionit e vizionit nëpërmjet produkteve buxhetore.

Me ligjin Nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” buxheti i miratuar për SPAK është në vlerën 1,901 milion lekë i ndarë sipas zërave buxhetorë në:

Shpenzimet e programit “Veprimtaria e SPAK” për vitin 2024

000/lekë

Art.	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor	Struktura e shpenzimeve në %
1	2	3	4
600	Paga	979,000.0	51%
601	Sigurime Shoqërore	123,946.0	7%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	248,117.0	13%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		0%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,351,063.0	71%
231	Kapitale të Trupëzuara	550,000.0	29%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	550,000.0	
Totali (korrente + kapitale)		1,901,063.0	100%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar




Figure 4 Pesha sipas llogarive ekonomike të planit të buxhetit viti 2024

- Shpenzimet për paga dhe sigurime në vlerën e rreth 1,102 milion lekë, ose 51% të buxhetit të miratuar, janë parashikuar sipas strukturës së miratuar për Prokurorinë e Posaçme dhe BKH. Vlen të theksojmë se për personelin Magjistrat, Hetues Financiar, Hetues të BKH-së si dhe Ekspertë, efekte të shtuara në shpenzimet për paga janë dhe orët e gatishmërisë dhe jashtë orarit zyrtar. Natyra e punës dhe veçoritë specifike të ushtrimit të detyrës në hetim sjell domosdoshmërish kërkesën për të ushtruar detyrën mbi kohën normale të punës. Në buxhetin e miratuar në zërin e pagave nuk është parashikuar fond për kryerjen e pagesave mbi kohën shtesë të punës, për kategorinë e subjekteve si më sipër, fakt i trajtuar dhe në relacionin e paraqitur në PBA dhe Komisionin e Ligjeve.
- Shpenzime Operative në vlerën e rreth 248 milion lekë janë parashikuar për mbulimin e kostove të funksionimit dhe administrimit të institucionit. Këto fonde gjatë vitit 2024, SPAK do ti vendos në efikasitet të plotë për të siguruar infrastrukturën e nevojshme me mallra dhe shërbime për arritjen e objektivave procedurale të hetimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sa kemi trajtuar dhe në analizën e treguesve të realizuar për vitin 2023, SPAK për shkak të natyrës së punës disponon teknologji në përdorim brenda ambienteve të cilat duhet të qëndrojnë në funksion të plotë dhe pa ndërprerje dhe si rrjedhim mirëmbajtja e tyre është e domosdoshme për të shmangur riskun e dëmeve të mundshme si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes së tyre. Për vitet në vijim 2024-2026 referuar parashikimeve për vitin 2024 dhe kërkesave të shtuara (rrjedhojë e shtimit të kapaciteteve të sistemeve IT) parashikohet rritje e shpenzimeve të mirëmbajtjes së këtyre sistemeve.
- Shpenzime për investime janë parashikuar në vlerën 550 milion lekë. Në kushtet e emergjencës për përshtatjen e Godinës së re në funksion të nevojave të institucioneve të SPAK, duke përfshirë këtu edhe rekrutimin e vendeve vakante në strukturë, e cila do të rezultojë në më shumë efektivitet në punë, buxheti i miratuar për shpenzime kapitale, do të përdoret për realizimin e investimeve në punime ndërtimi, pajisje elektronike dhe infrastrukturë të IT, blerje pajisje zyre, si dhe pajisje operationale.

Për të realizuar objektivat e Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, të përcaktuara në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në përputhje me metodologjinë e hartimit të PBA-së 2024-2026, SPAK për vitin 2024 ka përcaktuar treguesit e performancës që lidhin qëllimin dhe objektivat e institucionit me realizimin e buxhetit vjetor. Në zbatim të ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, janë marrë masat për pasqyrimin sa më të saktë dhe real të detajimit të planit të shpenzimeve, bazuar në objektivat strategjike të institucionit dhe treguesve të performancës.

Qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menaxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të institucionit në përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, fakt ky i konfirmuar edhe nga kontrolli i ushtruar nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, Ministria e Financave, e cila konkludoi në vlerësimin se sistemi i kontrollit të brendshëm financiar në Prokurorinë e Posaçme është efektiv.